



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË MEMALIAJ”**

**RAPORT**

**(Auditim Financiar)**

**BASHKIA MEMALIAJ**

**TIRANË 2024**

## Përmbajtja

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>3</b>
a. Përshkrim i shkurtër i institucionit .....	3
b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.....	3
c. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:.....	3
d. Metodrat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:.....	4
e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.....	4
<b>KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT .....</b>	<b>6</b>
<b>II. HYRJE .....</b>	<b>7</b>
1. Objektivat dhe qëllimi.....	8
2. Identifikimi i çështjes:.....	8
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar: .....	8
4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH:.....	8
5. Kriteret e vlerësimit: .....	9
6. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:.....	10
<b>III. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.....</b>	<b>10</b>
1. AUDITIM MBI KONTROLLIN E BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK. ....	10
2. AUDITIM MBI PLANIFIKIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT TË BUXHETIT .....	20
3. AUDITIM MBI VLERËSIMIN E RAPORTIMIT FINANCIAR, PËR TË ARRITUR NË OPINIONIN NË SE PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN 2022, JAPIN NJË PARAQITJE TË VËRTETË E TË DREJTË TË POZICIONIT FINANCIAR, PERFORMANCËS FINANCIARE DHE FLUKSIT TË PARASË, BAZUAR NË KUADRIN RREGULLATOR NË FUQI. ....	43
4. AUDITIM MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE MBI ADMINISTRIMIN E PRONËS PUBLIKE (ASETE DHE PYJE E KULLOTA) TË TRASNFERUARA SIPAS VKM. ....	59
5. MBI AUDITIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM .....	61
<b>III. GJETJE DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>76</b>
A. MASA ORGANIZATIVE.....	76
B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.....	83
C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE – TË ARDHURA TË MUNGUARA .....	83
<b>IV. ANEKSE .....</b>	<b>84</b>

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### a. Përshkrim i shkurtër i institucionit

Të dhëna të përgjithshme: Bashkia Memaliaj kufizohet në veri me Bashkinë Mallakastër, në lindje me Bashkinë Këlcyrë, në jug me Bashkinë Tepelenë dhe në perëndim me Bashkinë Himarë dhe Selenicë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Memaliajt. Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 10.657 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 21.476 banorë. Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 372.07 km<sup>2</sup> me një densitet prej 78.90 banorë/km<sup>2</sup>. Në përbërje të kësaj Bashkie ndodhen 6 Njësi Administrative: Memaliaj, Memaliaj Fshat, Lutfinje, Buz, Krahës dhe Qesarat. Infrastruktura: Infrastruktura rrugore e Bashkisë Memaliaj ka njohur një përmirësim relativ gjatë viteve të fundit në përfundimin e ndërtimit të akseve rrugore Tepelenë-Memaliaj dhe Fier - Memaliaj. Bashkia Memaliaj është lidhur me linja të transportit publik me kryeqytetin dhe qytete të afërta. Sipërfaqet e gjelbërta në qytet janë 192625 m<sup>2</sup>; mbulime me ndiçim në zonat urbane dhe rurale vërtet qyteti; shërbim me ujë dhe kanalizime, mbulimi 10%, mbulimi me shërbim pastrimi në masën 30%. Industria: Në territorin e Bashkisë së Memaliajt gjenden 15 rezervuarë në funksion të ujitjes së tokave Bujqësore, gjë që favorizon kultivimin e produkteve bujqësore në këtë zonë. Prej vitesh është evidentuar potenciali energjistik në segmentet e Kalivacit. Bashkia Memaliaj është e pasur me bimësi si në loje ashtu dhe në shtrirje. Në të ndeshen nga brezi i shkurreve që shtrihet deri në lartësinë 600-800 m, brezi i dushkut 800-1200 m, pyjet foragjere, halore dhe të përzier dhe deri në kullotat alpine me lartësi afër 1000m. Bashkia e Memaliajt ka ende burime minerare në formën e rezervave të qymyrgurit me fuqi të lartë kalorifike (por me përqindje të lartë squfuri 3 herë më tepër se normat e BE).

### b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditimi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: *“1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”*. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Memaliaj si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

### c. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësim me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Memaliaj. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

#### **d. Metodatat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:**

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

*Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

*Raportet dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;

*Verifikimi në sistemin elektronik* - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

*Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

#### **e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve**

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se Bashkia Memaliaj për periudhën nën auditimit paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka konstatuar 18 gjetje dhe janë lënë 18 rekomandime. Në vijim paraqiten ato më kryesoret:

- Nivel i lartë i detyrimeve të prapambetura në vlerën 50,984,742 lekë, si pasojë e mos realizimit të të ardhurave.

- Efekt financiar negative/të ardhura të munguara në vlerën 2,525 mijë lekë nga mos arkëtimi i detyrimeve nga taksa dhe tarifa vendore.

- Mos marrja e masave për bllokimin e aktivitetit ndaj subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve në mungesë të autorizimit përkatës.

-Mos pasqyrim i situatës reale në llogaritë kontabël të institucionit si pasojë e

- Gjendja e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor në vlerën 0 lekë, ndërkohë që kjo llogari paraqitet me gjendje referuar analizës së debitorëve, ku debitorët paraqiten në vlera të konsiderueshme, të cilat duhet të ishin paraqitur edhe në këtë llogariri dhe në llog. kundërparti 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*” në pasiv të bilancit të paraqitur gabim në vlerën prej 783,012 lekë.
- Llogaritë në aktiv të bilancit llog. 423, 429 “*Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoha*”, llog.431 “*Tatime e taksa*”, llog.436” *Sigurime shëndetësore*” nuk duhet të paraqiteshin me gjendje, pasi vlerat e pasqyruara nuk janë të drejta të konstatuara, që ka shteti ndaj personelit.
- Vlera e mbetur në fund të vitit 2023 prej prej 3,911,473 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*”, për 20 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% të vlerës së mbetur.
- Dy llogari të aktiveve afatgjata materiale paraqiten me gjendje të pandryshuar në vite të shprehur me kosto historike përkatësisht:llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në vlerën 119,998 lekë dhe llog. 211 “*Pyje, Plantacione*” në vlerën 277,000 lekë, gjendje të cilat nuk janë të analizuar me emërtesa se çfarë përfaqësojnë.
- Gjendja e llog. 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*” si në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 dhe 2023 paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që për zbatimin e kontratës prej

487,378,589 lekë për projektin e investimit me objekt:“Ndërtimi i Ujësjetës Rajonal për fshatrat Vasjar, Iliras, Qësarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj” vazhdojnë punimet. Vlera pjesore e kësaj kontrate e financuar prej 174,224,553 lekë, duhet të ishte pjesë e gjendjes së llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” dhe jo pjesë e gjendjes së llog. “213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”siç ka ndodhur në fakt, pasi ky aktiv nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë.

Rekomandimet më kryesore për përmirësimin e situatës lidhen me sistemimet përkatëse në llogaritë kontabël për mangësitë e konstatuara, masat për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, si dhe ato për arkëtimin e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore si vijon:

- Bashkia Memaliaj, Drejtoria e Financës, të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plane të detajuara për këtë qëllim dhe të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike.
- Drejtoria e Financës në Bashkinë Memaliaj në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2024 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar, që për vlerat e detyrimeve afatshkurtra në lidhje me pagat, tatimin mbi të ardhurat, kontributet shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor të vitit ushtrimor, të paraqitura gabimisht në llogaritë e arkëtueshme analoge në aktiv të bilancit, ti kontabilizojë në mënyrë të saktë në gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe në rakordim me gjendjen në llog.7206 “Financim i prishëm nga buxheti”, në Formatin e Performancës së PF.
- Drejtoria e Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime “dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.
- Kryetari i Bashkisë Memaliaj të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe në llog. 211 “Pyje, Plantacione”dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.
- Drejtoria e Financës në Bashkinë Memaliaj të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerë të plotë, dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave ti kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.
- Sektori Taksave Vendore, Administratorët e NJA-ve dhe Sektori i Bujqësisë, të nisë një kërkesë zyrtare ndaj Këshillit të Qarkut Gjirokastrë dhe në bashkëpunim të marrin masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore dhe të patakshuar, me qëllim planifikimin e saktë dhe arkëtimin e taksës së tokës bujqësore.
- Sektori i Taksave Vendore bashkia Memaliaj në bashkëpunim me Sektorin Ligjor, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve për arkëtimin e vlerës prej **980,000 lekë**, dhe

në rast të mos reagimit prej tyre të nisë procedurat për ndërprerjen e kontratës deri në likuidimin e detyrimeve.

- Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me sektorin Juridik dhe Policinë Bashkiake, të marrin masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në tregtimin e karburanteve të pa licensuar, për dorëzimin e doku,entacionit të nevojshëm për pajisjen me licensë dhe arkëtimin e detyrimit përkatës për licensimin, duke vijuar edhe me bllokimin e aktivitetit në rast të mos përgjigjes brenda një afati të vendosur në njoftim.

## KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT

### **I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:**

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Memaliaj për periudhën ushtrimore 01.01.2023–31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimit shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Memaliaj janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinion të modifikuar, me rezervë**”, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

### **Baza për opinion të modifikuar me rezervë:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA<sup>-të</sup>). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Memaliaj, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700). Opinioni e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është 265 mijë lekë.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese për pasqyrat financiare të vitit 2022 janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përkatitjen e opinionit të modifikuar me rezervë<sup>1</sup>, ku ka rezultuar se anomalitë janë materiale, por jo të përhapura Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

<sup>1</sup>Sipas *Manualit të Auditimit Financiar* të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 246, datë 22.12.2022, kapitulli VI, fq 55: “**Një opinion i kualifikuar/modifikuar me rezervë** duhet të shprehet kur audituesi ka marrë evidenca të mjaftueshme të auditimit dhe konstaton se ka gabime materiale te pasqyrat financiare ose nëse

- Gjendja e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 në vlerën 0 lekë, ndërkohë që kjo llogari paraqitet me gjendje referuar analizës së debitorëve, ku debitorët paraqiten në vlera të konsiderueshme, të cilat duhet të ishin paraqitur edhe në këtë llogari dhe në llog. kundërparti 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*” në pasiv të bilancit të paraqitur gabim në vlerën prej 783,012 lekë.

- Llogaritë në aktiv të bilancit llog. 423, 429 “*Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba*”, llog.431 “*Tatime e taksa*”, llog.436” *Sigurime shëndetësore*” nuk duhet të paraqiteshin me gjendje, pasi vlerat e pasqyruara nuk janë të drejta të konstatuara, që ka shteti ndaj personelit. Shuma e llogarive në vlerën prej 10,431,336 lekë në mbyllje të vitit 2023 duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*”, e cila është paraqitur në mënyrë të pasaktë në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 783,012 lekë, vlerë për të cilën nuk ka shpjegim se çfarë përfaqëson, pasi nuk pasqyron detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, kur vlera e tyre në fakt në fund të vitit 2023 është 61,416,078 lekë dhe në mosrakordim me gjendjen në llog.7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*”, e cila paraqitet e pasaktë në vlerën prej 11,214,348 lekë.

- Vlera e mbetur në fund të vitit 202 prej 3,911,473 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*”, për 20 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% të vlerës së mbetur.

- Dy llogari të aktiveve afatgjata materiale paraqiten me gjendje të pandryshuar në vite të shprehur me kosto historike përkatësisht: llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në vlerën 119,998 lekë dhe llog. 211 “*Pyje, Plantacione*” në vlerën 277,000 lekë, gjendje të cilat nuk janë të analizuar me emërtesa se çfarë përfaqësojnë.

- Gjendja e llog. 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*”, si në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 dhe 2023 paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që për zbatimin e kontratës prej 487,378,589 lekë për projektin e investimit me objekt: “*Ndërtimi i Ujësijellësit Rajonal për fshatrat Vasjar, Iliras, Qësarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj*” vazhdojnë punimet. Vlera pjesore e kësaj kontrate e financuar prej 174,224,553 lekë, duhet të ishte pjesë e gjendjes së llog. 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*” dhe jo pjesë e gjendjen e llog. “213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*” siç ka ndodhur në fakt, pasi ky aktiv nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë.

## II. HYRJE

Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 494/1 Prot, datë 15.04.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 16.04.2024 deri më datë 10.05.2024 në subjektin Bashkia Memaliaj, u krye auditimi financiar për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

---

*audituesi nuk mund të marrë evidenca të përshtatshme për aspektet e auditimit. Opinioni i kualifikuar jepet kur anomali të ose kufizimi e fushëveprimit nuk janë aq material dhe të përhapur sa të kërkojë një opinion të kundërt ose një mohim të opinionit. (ISSAI 1700.7)”.*

1. R. K., Përgjegjëse grupi
2. I. Sh., Audituese
3. E. K., Audituese
4. E. K., Audituese
5. K. G., Auditues

### **1. Objektivat dhe qëllimi**

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

### **2. Identifikimi i çështjes:**

Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të titullarëve dhe stafeve mbështetëse për realizimin e përgjegjësive publike.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, çështjet e vlerësuara i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së këtij institucioni publik, transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Raporti i Auditimit është i strukturuar në disa kapituj ku identifikohet hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit; përfshirë dhe gjetjet e rekomandimet së bashku me anekset.

### **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:**

Titullari i Bashkisë, dhe Nëpunësi Zbatues sipas rastit, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrin ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj. Gjithashtu, stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

### **4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH:**

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar me objekt: dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi



përputhshmërinë e aktivitetit të Bashkisë, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Gjatë kryerjes së auditimit, audituesit e KLSH marrin evidenca të besueshme, të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur gjykimin dhe konkluzionet e dala lidhur me organizimin, veprimtarinë, programin dhe funksionet e subjekteve nën auditim. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojnë.

#### **5. Kriteret e vlerësimit:**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:

Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

Ligji nr. 84/2023 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj.

Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”

Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar;

VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”;

Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;

Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;

UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj.;

Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;

Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”;

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.

Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;

Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësisve që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;

VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;

VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;

Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj.;

Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237, datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;  
Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;  
Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar  
VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;  
VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;  
Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

## **6. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:**

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave dhe dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me stafin, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, intervistave etj., të finalizuara me akt-konstatimet, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Auditimi. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e mbledhura gjatë auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur vlerësimet / përfundimet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tij.

## **III. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT**

### **1. AUDITIM MBI KONTROLLIN E BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK.**

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat vendosen, ruhen dhe përditësohen rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihen në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar riskun e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet veprimtarive efektive, efëiente dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

#### **1. Mjedisi i kontrollit**

Mjedisi i kontrollit është bazë për menaxhimin e fondeve në njësinë publike, ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm.

Ky komponent përbëhet nga:

##### **1.1. Integriteti dhe Vlerat Etike**

Nëpunësit e Bashkisë Memaliaj duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

- Bashkia Memaliaj disponon Kodin e Etikës të miratuar me Vendimin nr. 39, datë 21.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë, në të cilën përfshihen rregullat e etikës për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion.

- Bashkia Memaliaj nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit, veprime këto në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”.

- Në Bashkinë Memaliaj, ankesat dhe kërkesat e ndryshme të paraqitura pranë saj, regjistrohen në Zyrën e Protokollit të institucionit me një ndalesë dhe më pas bëhen raportimet e nevojshme në sektorët përkatës. Në vazhdim të procesit, bëhet kthimi i përgjigjeve sipas afateve të përcaktuara në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

- Bashkia Memaliaj nuk ka kryer procesin e vlerësimit të punonjësve për periudhën në auditim, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë” dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

### **1.2. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.**

Në rregulloren e brendshme të institucionit janë të përcaktuara procedurat për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse të cilat, përcaktojnë rolin, fushëveprimin e nëpunësit autorizues dhe të stafit menaxherial. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion prej institucionit konstatohet se:

- Bashkia Memaliaj ka të përcaktuar dhe kryen sipas procedurës së miratuar në rregulloren e brendshme hartimin, miratimin, ndjekjen dhe raportimin e brendshëm sa i përket realizimit të planeve mujore nga sektorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e Njësive Administrative si dhe Drejtorët e njësive të varësisë për informacion të Titullarit të Bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë në përputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”.

- Në Bashkinë Memaliaj mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm, nuk ka plan menaxhimi për veprime korrigjuese lidhur me mangësitë e evidentuara në këtë drejtim. -Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

- Titullari i institucionit merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditimi i Brendshëm, nëpërmjet veprimtarisë audituese që ai kryen.

- Këshilli bashkiak me kompetencat e tij ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë nëpërmjet vendim-marrjes.

### **1.3. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.**

- Bashkia Memaliaj ka hartuar dhe miratuar deklaratën e misionit dhe dokumentin e PBA-së. Në dokumentet e PBA-ve, nga ana e këtij institucioni është miratuar strategjia me objektivat dhe

prioritetet strategjike, në përputhje me ligjin organik të buxhetit si dhe plan veprimi i menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Mënyra e njohjes së punonjësve me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën elektronike.

#### **1.4. Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.**

Nëpunësit e Bashkisë Memaliaj i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel sektori, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Referuar Kreut III, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, përcaktohet që:

Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë:

- Një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve.
- Kriteria dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent.
- Zhvillimin dhe miratimin e politikave, rregullave dhe procedurave të zbatueshme, që janë në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin, shpërblimin dhe motivimin e stafit.

Në rregulloren e brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Punë nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

#### **1.5. Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.**

Titullari i njësisë publike duhet të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik, (në vijim GMS) me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, dhe luan një rol kyç për sa i takon, integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm dhe sjelljes etike. GMS ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë, të garantojë se komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe menaxhimi efektiv i riskut janë të pranishëm dhe funksionojnë me efektivitet brenda njësisë.

Për vitin 2023 nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, por funksionon me GMS të ngritur me Urdhrin nr.8, datë 27.01.2022, të Kryetarit të Bashkisë për vitin 2022 i përbërë nga 6 punonjës, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, gërma “b”, neni 24, pika 2.

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni u konstatua se, ky grup (GMS) nuk është mbledhur për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, pika 8, gërma “b”, neni 27, pikat 1-2, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, pika 2.2.6, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2.4, nën pikat 1-5. Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi

zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Mënyra e delegimit të detyrave është e përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit.

## **2. Menaxhimi i riskut**

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative e veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes.

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e ngjarjeve të mundshme apo situatave të cilat mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësisë dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për, zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij, analizimin dhe rifreskimin e kontrolleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut të miratuar.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, hapa këto të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin e prioriteteve lidhur me shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.

Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë e më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të sillen institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe kontrollin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve më të mëdha, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

-Bashkia Memaliaj ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila rishikohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave.

- Bashkia Memaliaj nuk ka hartuar listën e proceseve/manualeve e procedurave të punës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

## **3. Aktivitet e kontrollit**

Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, urdhër-shërbimet dhe kryerja e pagesave, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesat.

Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për regjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit.

Likuidimet e transaksioneve nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të cilët janë konfirmuar nga MFE për autorizimin/kryerjen e veprimeve me Degën e Thesarit.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njesisë, apo ndërmjet vetë njesisë dhe institucioneve të jashtme.

Përveç kësaj gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

Titullari i njesisë publike, miraton gjurmën e auditimit për procedura që lidhen me veprimtaritë kryesore të njesisë dhe siguron që, të gjitha operacionet e njesisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm apo autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit duhet të ketë në përbërje të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njesisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, "Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike" përcaktohet se, "Nëpunësi Autorizues i njesisë publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës".

Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të sigurojë se në përgatitjen e "Gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës" do të përfshihen hapat kryesorë të vlerësuar të rëndësishëm për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

- Për vitin 2023, Bashkia Memaliaj nuk ka hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurmën e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre dhe synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 16, pika 2-3 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.3, "Aktivitete e kontrollit".

Titullari i njesisë ka përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi. Procedurat antikorrupsion, përfshijnë:

- Kontrollat parandaluese;
- Një sistem për investigim të brendshëm të paralajmërimeve të hershme për korrupsion, mashtrime dhe parregullsi;
- Një sistem për zbulimin e mashtrimeve dhe parregullsive;
- Një sistem për raportimin e parregullsive të gjetura, i cili duhet të përshkruajë qartësisht linjën e brendshme dhe të jashtme të raportimit, pa rënë ndesh me të drejtën kushtetuese të individit;
- Procedurat e sinjalizimit.

- Në Bashkinë Memaliaj është miratuar Rregullorja për Parandalimin e Konfliktit të Interesit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike me nr.1277 Prot datë 28.07.2022 dhe ka hyre në fuqi me Vendimin Nr.41, datë 28.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë.

- Bashkia Memaliaj nuk ka një procedurë të veçantë lidhur me mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave dhe analizën e tyre, për të bërë të mundur identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime këto në kundërshtim me, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20.

#### **4. Monitorimi**

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura.

Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, monitorimi synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës.

Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të Brendshëm.

Nëpërmjet vetëvlerësimit një përdorues i buxhetit përcakton nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në të cilin rregullat dhe procedurat sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive. Duke plotësuar pyetësozin e vetëvlerësimit çdo nëpunës autorizues për çdo vit përgatit një deklaratë “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në të cilën ai deklaron se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimet dhe objektivat, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës.

Në deklaratë, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar.

Qëllimi i kësaj deklaratë është rritja e llogaridhënies së menaxhimit dhe inkurajimi i përpjekjeve për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Çdo vit, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi te nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.

- Bashkia Memaliaj me shkresën nr 505/1 prot., datë 06.03.2024, ka hartuar dhe dërguar në MFE deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raportin vjetor për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe pyetësozin e vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, për vitin 2023 në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon MFK në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenin 18, pika 1.

- Për vitin 2023 nuk është hartuar dhe dërguar plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin pranë MFE, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar

dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III.

## **5. Informimi dhe komunikimi**

Titullari i njësisë publike miraton dhe vë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

- Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
- Një komunikim efektiv, si vertikal ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.
- Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.
- Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, si dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.

Menaxhimit duhet t'i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përmbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet.

Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përmbushjes së objektivave në nivel aktiviteti dhe në nivel objektivash të përgjithshme për mbarë njësinë publike. Mbështetja e menaxhimit për zhvillimin e sistemeve të nevojshme të informacionit duhet të shfaqet me angazhimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare. Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për përdoruesin.

Shkëmbimi i informacionit në Bashkinë Memaliaj dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. A. M. me detyrë Kryetar i Bashkisë Memaliaj.***

### **1.2. Auditimi mbi “Organizimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm”, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së kësaj njësie auditimi,:**

- *Organizimi dhe ngritja e Strukturës së NJAB, me Vendim të Këshillit të Bashkisë, sipas përcaktimeve në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për Miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.*



- Lista emërore dhe evidenca nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore mbi emërimin e punonjësve, statusin e punonjësve.
- Karta e Auditimit, Kodi i Etikes, Rregullorja e brendshme, të miratuara dhe dërguar në Ministrinë e Financave.
- Planet strategjike dhe vjetore të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023, të miratuara dhe dërguar në Ministrinë e Financave.
- Raportimi vjetor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, të miratuara dhe dërguar në Ministrinë e Financave.
- Programet e auditimeve të miratuara nga Drejtuesi i Njesisë së Auditimit, dërguar subjektit që auditohet.
- Dokumentet e Evadimit të materialeve të Auditit të Brendshëm.
- Dokumentet e Sigurimit të cilësisë në auditimet e kryera.

### **Organizimi dhe funksionimi i strukturës së Njesisë të Auditit të brendshëm**

Struktura e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Memaliaj, funksionon në nivel sektori (sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 69, datë 30.12.2022, vendim i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr.122/1, datë 01.02.2023).

### **Përbërja profesionale dhe kualifikimi i punonjësve të njesisë së auditimit të brendshëm**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe që ndodhet pranë zyrës së burimeve njerëzore në Bashkinë Memaliaj, konstatohet se stafi i NJAB për vitin 2023, kjo njësi auditimi është organizuar në nivel sektori me strukture 1 auditues. Kjo strukturë nuk është miratuar në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 3, gërma “a” dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 1, gërma “b”, ku përcaktohet që: “3. Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njesisë. Në strukturën e njesisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik”. Profili arsimor i punonjësit, rezulton që të jetë i diplomuar në fushën e ekonomisë, i certifikuar, me përvojë pune në fushën e auditimit për 4 vite, si dhe me përvojë profesionale në fushën ku është diplomuar për 31 vite.

Struktura e kësaj njësie auditimi, në formë tabelore për periudhën e audituar për vitin 2023, paraqitet si me poshtë:

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim	Çertifikimi
	<b>Për vitin 2023</b>						
1.	F.K.	Specialist	06.01.2020	Ekonomist	31	4	Ne 2012

Për sa trajtuar më sipër konstatohet se struktura e NJAB Bashkia Memaliaj për vitin 2023 nuk është e plotësuar me numrin minimal të punonjësve gjë e cila ndikon në mos funksionimin me kapacitet të plotë të kësaj njësie.

### **Dokumentacioni bazë mbi te cilën ushtron aktivitetin Njësia e Auditimit të Brendshëm**

Nga vlerësimi i kryer nga grupi i auditimit, për vitin 2023, pasi shqyrtoi evidencat dhe korrespondencën e kryerjes dhe raportimit të veprimtarisë audituese, planifikimin strategjik dhe atë vjetor, raportimin vjetor dhe periodik, konstaton se dokumentacioni baze mbi te cilën ushtron veprimtarinë NJAB, është si me poshtë:

**1.Karta e Auditimit të Brendshëm** e NJAB-së së Bashkisë Memaliaj, është miratuar me Vendimin nr. 147, datë 08.11.2018, e përmirësuar me Vendimin nr.38, datë 23.05.2023, protokolluar me nr. 873/1 datë 23.05.2023.

**2. Plani strategjik si dhe plani vjetor**, për vitin 2023, janë hartuar sipas kërkesave të nenit 18/2, të ligjit organik mbi auditimin dhe të seksionit 3, kreu II të “Manualit për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, si dhe të nenit 14, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” të ndryshuar, të cilat janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj, me shkresën nr. 1775 prot., datë 19.10.2022, si dhe i janë dërguar strukturës përgjegjëse Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 1775/1 prot., datë 19.10.2022.

Plani vjetor i auditimit si një dokument bazë i veprimtarisë audituese, parashtron kritere e procedura të cilat janë parashikuar në dispozita ligjore, si; fushat prioritare, frekuencën e auditimeve, përmirësimet e kapaciteteve audituese, zhvillimin e burimeve njerëzore, bilancin e burimeve dhe nevojave për auditim, koston e auditimit, etj.

Në planin vjetor të auditimit janë përfshirë për auditim sistemet me risk të mesëm dhe të lartë, ku drejtimet kryesore të auditimit, kanë qenë:

- Vlerësimi mbi funksionimin e sistemit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve që janë lënë në auditimet e mëparshme, nga audituesit e brendshëm si në Bashkinë Memaliaj, Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, si dhe tek Klubi Sportiv Memaliaj.

- Vlerësimi i situatës mbi detyrimet e prapambetura, si për Bashkinë, Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, si dhe tek Klubi Sportiv Memaliaj.

- Vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e rregullshmërisë së aktivitetit të kësaj Bashkie, me kuadrin ligjor në fuqi, në drejtim të, aktivitetit ekonomik e financiar të Bashkisë, administrimit të aseteve, etj.

- Vlerësimi i sistemit mbi funksionimin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit” në Bashkinë Memaliaj, pasqyrimi i veprimtarisë së këtij shërbimi të MZSH-së.

- Vlerësimi i rregullshmërisë ligjore bazë dhe mbështetëse si dhe rregullorja që drejton veprimtarinë e subjekteve të audituara.

Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, referuar kërkesave të nenit 14, pika ‘ç’ të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, është hartuar **Raporti Vjetor i veprimtarisë, së bashku me pasqyrat përkatëse dhe pyetësonin e vetëvlerësimit** për auditimin e brendshëm, miratuar nga Titullari dhe dërguar tek Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 410 prot, datë 14.02.2024.

Veprimtaria e AB për periudhën 2023, i është përmbajtur planit vjetor dhe strategjik të saj, në përputhje me standardet procedurat dhe etapat e auditimit të përcaktuara në Manualin e AB dhe Udhëzimin në fuqi, në fushën e AB.

### **Vlerësimi i procedurave dhe zbatimit të standardeve në kryerjen e auditimit të brendshëm**

Nga ana e Njësies së Auditimit të Brendshëm Bashkia Memaliaj, planifikimi i një angazhimi është realizuar duke respektuar kërkesat e Manualit të AB kapitulli IV, pika 4.1.1 “*Planifikimi i një angazhimi*”, ku nga ana e grupit të auditimit janë zhvilluar takime për njohjen paraprake të subjektit që do të auditohet me subjektin, veprime të cilat janë të dokumentuara me shkrim në procesin e mbledhjes së informacionit dhe përgatitjes së programit të angazhimit.

Gjatë kryerjes së angazhimit nga NJAB janë respektuar fazat e planifikimit, si *Autorizimi* për fillimin e auditimit, *Njoftimin paraprak* për fillimin e angazhimit, *takimin fillestar*, *deklaratën e pavarësisë*, vlerësimin e riskut, përcaktimin e drejtimeve të auditimit, duke e shoqëruar me testet përkatëse, përcaktimi i kostos së veprimit, masat për sigurimin e cilësisë, etj.

Janë respektuar kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.6 "*Përgatitja e programit të angazhimit*", ku për të arritur objektivat e angazhimit, janë trajtuar si fusha prioritare duke planifikuar, auditimin mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i brendshëm, vlerësimi i sistemit mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, etj, pra rezulton se janë zbatuar drejt kriteret, lidhur me fushat prioritare për auditimin e subjekteve, pasi ato kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimtarisë në përputhje me risqet e subjekteve.

Vlerësojmë se në mbështetje me Manualin e AB të miratuar me Urdhrin MF nr.100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), përgjithësisht programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës.

### **Vlerësimi i procedurave të parashikuara për raportimin dhe komunikimin e auditimit si: hartimi i projekt-raportit të angazhimit, takimet me palën e audituar, hartimi i raportit final, trajtimi i observacioneve, përgatitja e memorandumit**

Nga NJAB të Bashkisë janë respektuar kërkesat e manualit të AB, lidhur me procedurat e hartimit të dokumenteve të auditimit, siç përcakton manuali i auditimit, pra janë respektuar hapat e një misioni angazhimi që nga procesi i planifikimit (përgatitja) e misionit të angazhimit, puna në terren, pasqyrimi i punës audituese (dokumentimi) i saj.

Për rastet e parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara nga Auditi gjatë ekzaminimit të praktikave dhe dokumentacionit kontabël e administrativ, janë mbajtur dokumentacioni i nevojshëm me personat përgjegjës për fiksimin e shkeljeve të ligjshmërisë dhe të disiplinës financiare.

Kjo strukturë ka plotësuar konform kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, edhe pyetësorin mbi veprimtarinë e saj, duke dhënë opinionin mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në subjektet që ajo auditon, kjo sipas nivelit të riskut.

Në dosjet e auditimit ndodhen konfirmimet e raporteve të bëra nga subjektet e audituara, në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga njësia e auditimit, veprime të cilat janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe të kapitullit VI "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese" të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave me nr.100, datë 25.10.2016, e konkretisht:

- Autorizimi për caktimin e grupit të punës për të kryer angazhimin e auditimit.
- Njoftimi paraprak për fillimin e angazhimit të auditimit.
- Takimi fillestar për fillimin e misionit të auditimit.
- Programi i angazhimit të auditimit.
- Dokumentet që lidhen me kryerjen e angazhimit të auditimit.
- Testet dhe shënimet e mbajtura nga audituesi.
- Takimi i ballafaqimit përfundimtar të misionit të auditimit.
- Projekt Raporti i auditimit.
- Raporti Përfundimtar i auditimit.
- Memo (përmbledhja e shkurtër përfundimtare) e cila i është paraqitur titullarit të Institucionit.
- Monitorimi i brendshëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm nga çdo auditues.

- Kontrolli i vlerësimit të cilësisë për monitorimin e brendshëm për çdo auditim.

### **Vlerësimi i procedurave për rishikimin e brendshëm të cilësisë së punës audituese**

Nga dosjet objekt auditimi për periudhën audituese, grupi i auditimit konstatoi se, procedurat e rishikimit të brendshëm të cilësisë së punës audituese janë ndjekur vazhdimisht, siç është parashikuar në kërkesat e manualit të AB (Kap. IV, Pika 4.8.3).

### **Vlerësimi i dokumentimit të punës audituese**

Nga njësia e AB të Bashkisë Memaliaj, është plotësuar inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit, si dhe dosjet e përhershme për të gjitha subjektet që auditohen nga kjo njësi, ku janë plotësuar me dokumentacionin përkatës, kjo sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapit. VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”, formati 1 “Inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit” si dhe pikës 6.3 “Dosja e përhershme”.

Nga ekzaminimi i dokumentacionit, u vu re se të gjitha dosjet e evaduar janë arkivuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat” dhe në zbatim të tij “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor të Republikës së Shqipërisë”. Dosjet e auditimit vlerësohen të plotësuara sipas kërkesave të manualit, dhe të gatshme për arkivim.

Mbi rezultatet e auditimit për vitin 2023, të dhënat janë dhe në pasqyrat shoqëruese bashkëlidhur materialit.

*Sa më sipër mban përgjegjësi: z. A. M., z. A. Xh. dhe z. F. K.*

## **2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit**

Në zbatim të pikes 2 të Programit të Auditimit, u auditua *planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 993, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjet vjetore për buxhetin e shtetit të vitit 2022, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.*

Dokumentacioni që u shqyrtua për auditimin e kësaj pike të programit të auditimit është si vijon:

- PBA 2023-2025;
- Projekt-buxhetin e miratuar për vitin 2023;
- Vendimet e KB “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë” për vitin 2023;
- Vendime të tjera të KB, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Situacioni i shpenzimeve për vitin 2023 i rakorduar me Degën e Thesarit;
- Situacioni i të ardhurave për vitin 2023 i rakorduar me Degën e Thesarit;
- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Raportimet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë lidhur me detyrimet e prapambetura të Bashkisë;
- Informacion shkresor i përgatitur nga subjekti bazuar në kërkesat e hartuara nga grupi i auditimit.

### **1. Programimi i PBA-së 2023-2025**

Për hartimin e PBA-së 2023-2025 nga Bashkia janë ndjekur dhe zbatuar hapat e më poshtëm:

- VKB nr. 20, datë 29.04.2022, “Për miratimin e parashikimeve Afatmesme të të Ardhurave dhe Tavanet Përgatitore 2023-2025”;
- Relacioni me shkresë nr. 694 prot., datë 21.04.2022;

- VKB nr. 35 datë 03.08.2022, “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”;
- Relacioni me shkresë nr. 1126 prot., datë 07.07.2022
- VKB nr. 65, datë 16.12.2022, “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”.

*Programimi i shpenzimeve për vitin 2023-2025 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.*

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi	83,700	13.8	84,520	21	90,124	20.6
2	Sporti dhe Argëtim	5,680	0.9	5,760	1.4	5,790	1.3
3	Arsimi bazë parashkollor	39,360	6.4	40,162	9.8	40,248	9.2
4	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	8,380	1.3	8,426	2.	8,440	1.9
5	Shërbime Publike Pastrim gjelbërim, etj.	6,780	1.1	6,800	1.7	6,900	1.6
6	Shpenzime të tjera specifike	1,516	0.2	0	0	0	
7	Shërbimet publike vendore	93,366	15.4	93,297	23	93,745	21.4
8	Mbrojtja nga zjarri	13,858	2.3	13,940	3.4	14,290	3.3
9	Administrimi i Pyjeve Kullota	3,380	0.6	3,450	0.8	3,592	0.8
10	Menaxhim i infrastrukturës ujore	3,012	0.5	3,190	0.8	3,574	0.8
11	Rrjeti rrugor rural	9,412	1.6	9,612	2.4	9,820	2.2
12	Kujdesi Social për fëmijë	134,600	22	135,500	33.2	156,500	35.8
13	Menaxhim i infrastrukturës ujësjetillës	200,000	33	0	0	0	
14	Gjendja Civile	3,300	0.5	3,380	0.8	3,400	0.8
15	Fondi Kontigjencës			0			
	<b>TOTALI</b>	<b>606,344</b>		<b>408,037</b>		<b>436,493</b>	

*Ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2023-2025*

Nr	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600) + 601	149,000	24.5	150,510	37	153,286	35
2	Sigurime (601)	0	0	0	0	0	0
3	Shpenzime operative (602) + 604	75,668	12.5	76,620	18.8	77,265	17.7
4	Shpenzime (603)						
5	Shpenzime (604)						
6	Shpenzime (606)	134,600	22	135,500	33	156,500	35.8
7	Shpenzime (609)						
8	Shpenzime për investime (230-231)	247,076	40.7	45,407	11	49,442	11
	<b>TOTALI</b>	<b>606,344</b>		<b>408,037</b>		<b>436,493</b>	

*PBA 2023-2025 tendenca e të ardhurave, në mijë lekë*

Nr	Të ardhurat	2023	2024	2025
1	Nga taksat	14,250	22,230	22,238

2	Jo tatimore	16,750	23,000	23,000
	<b>Totali</b>	<b>31,000</b>	<b>45,230</b>	<b>45,238</b>

Në numër

Nr.	Emërtimi	Viti 2023			
		Plani	Fakti	Status	Kontratë
1	Aparati bashkisë	79	78	23	54
2	Njësia Adminin	12	12	0	12
3	Njësi vartëse	55	55	7	48
4	Tjera	59	59	0	59
	<b>TOTAL</b>	<b>205</b>	<b>204</b>	<b>30</b>	<b>173</b>

## 2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura

Për vitin 2023 në Bashkinë Has buxheti është hartuar kryesisht mbi bazën e 15 programeve, përkatësisht: Planifikim, Menaxhim dhe Administrim, Sporti dhe Argëtimi, Arsimi Bazë Parashkollor, Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm, Shërbime Publike, Shërbime publike Vendore, Mbrojtje nga zjarri, Administrimi i Pyjeve Kullotave, Menaxhimi i Infrastrukturës Ujore, Kujdesi Social për Fëmijët, etj.

Rezulton se buxheti i viteve 2023-2025 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

### Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2023

Planifikimi i të ardhurave 2023		Planifikimi i shpenzimeve 2023	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/ lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	30,000	Art. 600 Paga	125,423
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2023	11,233	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	19,951
<b>Total të ardhurat e veta</b>	<b>41,233</b>	Art.602 Shpenzime operative	62,548
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.	15,585	Art.604 Transferime korrente të brendshme	7,100
Të ardhura të trashëguara nga granti i kushtëzuar (transferua specifike 600, 601, 602 etj.).		606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	2,000
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2023	123,853	Art.230-231 Investime	43,127
Transfertë specifike e çelur për llogari të vitit 2023	85,892	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	6,414
<b>Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit</b>	<b>225,330</b>		
<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>266,563</b>	<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>	<b>266,563</b>

### Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit për vitin 2023

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2023	Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2023
---	--

Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>1+2</b>		<b>3</b>	<b>4</b>	<b>3+4</b>
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	30,000		30,000	Art. 600 Paga	125,423	12,631	138,054
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2023	11,233		11,233	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	19,951	2,339	22,290
<b>Total të ardhurat e veta</b>	<b>41,233</b>		<b>41,233</b>	Art. 602 Shpenzime operative	62,548	15,220	77,768
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	15,585		15,585	Art. 604 Transferime korrente të brendshme	7,100	2,576	9,676
Të ardhura të trashëguara nga transferta specifike				Art. 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	2,000	143,996	145,996
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2023	123,853		123,853	Art. 230-231 Investime	43,127	139,560	182,687
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2023	85,892		85,892	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	6,414	-1,205	5,208
<b>Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit</b>	<b>225,330</b>		<b>225,330</b>				
<b>Totali të ardhurave</b>	<b>266,563</b>	<b>-</b>	<b>266,563</b>	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>266,563</b>	<b>315,117</b>	<b>581,680</b>

### Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2023

Për vitin 2023 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **501,810** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **476,958** mijë lekë, ose në masën **95%**.

Nga këto janë realizuar nga të ardhurat e veta 16,283 mijë lekë dhe vlera e mbuluar nga FZHR është **460,675** mijë lekë, ose **97%**. Nga këto, fondi i pagave (llogaria 600) është realizuar me 100%, sigurime shoqërore dhe shëndetësore (llogaria 601) është realizuar me 100%, shpenzimet operative (llogaria 602) është realizuar me 73%, transferta korrente të brendshme (llogaria 604) është realizuar me 48%, Emergjencia Civile realizuar 100%, transferime tek buxhetet familjare (llogaria 606) është realizuar me 99%, projekte (llogaria 230) është realizuar 100%, fondi i investimeve (llogaria 231) është realizuar me 100% dhe investim nga ujësjellësi është realizuar 100%. Realizimi i buxhetit sipas zërave paraqitet në mënyrë më të detajuar në tabelën në vijim.

### Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2023

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Memaliaj për vitin 2023, në mijë lekë						
Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve Bashkia pa njësitë vartëse	Plani 2023	Fakti 2023	Realizimi në %	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta (fakti)	Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti (fakti)
1	Artikulli - 600 Paga	107,713	105,661	98%		105,661
2	Artikulli – 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	17,207	14,762	86%		14,762
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	50,088	46,573	93%	12,618	33,955
4	Artikulli - 604 Transferta korrente të brendshme	7,100	4,185	59%	2,185	2,000
5	Emergjencia Civile	2,576	2,556	99%		2,556

6	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (PAK)	145,996	143,439	98%	1,480	141,959
7	Artikulli 609 (fond rezervë + kontigjencës)	5,207		0%		
8	Artikulli - 230 Projekte	400	34	9%		34
9	Artikulli - 231 Investime	29,123	23,348	80%		23,348
10	Artikulli – 231 Investim Ujësjetësi	136,400	136,400	100%		136,400
	<b>TOTAL</b>	<b>501,810</b>	<b>476,958</b>	<b>95%</b>	<b>16,283</b>	<b>460,675</b>

VKB nr. 68, datë 16.12.2022, “Për miratimin e buxhetit për vitin 2023”, konfirmuar e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë me shkresë nr. 1223/1, datë 23.12.2022.

Nga bashkia ndarja e plan buxhetit dhe detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së pakushtëzuar sektoriale, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Gjatë këtij viti, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar dhe rialokimeve të kryera nga vetë bashkia, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, me VKB nr. 11, datë 28.02.2023, “Rishqyrtim të VKB nr. 01, datë 26.01.2023, për dhënie ndihmë financiare”, VKB nr. 16, datë 16.03.2023, “Për një ndryshim në zërin buxhetor”, VKB nr. 60, datë 28.09.2023, “Për një ndryshim në VKB nr. 68, datë 16.12.2023, “Për buxhetin e vitit 2023””, VKB nr. 1538/2, datë 04.09.2023, “Për një ndryshim në VKB nr. 68, datë 16.12.2022 “Për buxhetin e vitit 2023””, VKB nr. 111, datë 22.12.2023, “Shtesë plan – buxhet për vitin 2023”

Sipas përcaktimit të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47<sup>2</sup>, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44<sup>3</sup>, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4, pika c.

### **3. Saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit**

Treguesit e buxhetit për vitin 2023, është planifikuar në shumën 501,810 mijë lekë prej të cilit janë realizuar 476,958 mijë lekë ose i shprehur në përqindje plani është realizuar në masën 97%, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 30,176 mijë lekë ose në masën 3% të buxhetit faktik. Nga Drejtoria e Financës është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB, ose të diktuar nga grandet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin në nivel titulli,

<sup>2</sup> Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brendamuajt qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse përndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin evitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor.

<sup>3</sup> Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.



kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore.

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44 dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, Bashkia Memaliaj ka përgatitur vetëm Raportin vjetor të monitorimit të buxhetit për vitin 2023 dhe e ka dërguar me shkresë në MFE nr. 550/1 prot., datë 01.03.2024.

**Nga auditimi konstatohet se,** Bashkia Memaliaj për vitin 2023 ka hartuar dhe dërguar në MFE vetëm Raportin vjetor të monitorimit të buxhetit, ndërsa 2 raportet periodike të monitorimit nuk janë hartuar nga Bashkia Memaliaj për vitin 2023. Kryetari i Bashkisë Memaliaj në asnjë rast nuk i ka paraqitur në këshill raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Kryetari i Bashkisë nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit nuk janë të plota pasi nuk janë plotësuar të gjitha anekset sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48.

#### ***4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve***

Në Bashkisë Memaliaj vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 50,984,742 lekë.

**Nga auditimi konstatohet se,** sipas të dhënave të paraqitura në ankesin nr. II.4.1 mëposhtë, detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2022 janë në vlerën 25,634 mijë lekë, janë krijuara gjatë vitit 2023 detyrime në vlerën 208,510 mijë lekë dhe janë shlyer në vlerën 183,159 mijë lekë. Duke rezultuar **detyrime të prapambetura deri 31.12.2023 në vlerën 50,985 mijë lekë.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", **neni 34, pika 1**, “*Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore...*”, **neni 40, pika 3**, “*Projektbuxheti vjetor përfshin...informacion mbi gjendjen/stokun e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore...detyrimet kontingjente dhe mundësinë e shfaqjes së tyre si detyrime në vitin buxhetor pasardhës*”. Udhëzim i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, **pika 101**, “*Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim*”.

#### **Mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore në Bashkinë Memaliaj**

Nga auditimi rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore në vitin 2023 është në vlerën 182,235 lekë, për të cilën Bashkia Memaliaj nuk ka paguar 2 fatura nga subjekte,

përkatësisht “G.” ShPK për vlerën 150,407 dhe “B.” ShPK me vlerën 31,828 lekë me faturën nr. 672, datë 10.11.2016.

Vështirësia Financiare e Bashkisë Memaliaj

Në UMFE nr.26, datë 27.03.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, trajtohet shkalla e vështirësisë financiare dhe menaxhimi i këtyre vështirësive.

Gjithashtu në ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, datë 27.04.2017, kreu XI vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre, neni 55 Probleme Financiare, pika 1.

Për Bashkinë Memaliaj, totali i shpenzimeve të miratuara nga të ardhurat e veta me VKB për vitin 2023 ka vlerën 581,679,000 lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura më 31.12.2023, ka vlerën 10,654,733 lekë, sipas raportimit në MFE me shkresë nr. 520 prot., datë 27.02.2024. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 1.83%, shifër që e klasifikon Bashkinë Memaliaj në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare, paraqitur si në tabelën mëposhtë:

N.R	Emërtimi	Stokun vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
<b>I</b>	<b>Borxhe (a+b)</b>			
<b>a</b>	<b>Hua afatgjatë</b>			
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
<b>b</b>	<b>Hua afatshkurtër</b>			
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kreditë furnitorëve			
<b>II</b>	<b>Detyrime (a+b+c)</b>	<b>10,654,733</b>		<b>1.83</b>
<b>a</b>	<b>Shpenzime korrente</b>	10,472,498		
a,1	Mallra dhe shërbime	9,882,452		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera	590,046		
<b>b</b>	<b>Shpenzime kapitale</b>			
b,1	Institucione buxhetore			
b,2	Subjekte private			
<b>c</b>	<b>Vendime gjyqësore</b>	<b>182235</b>		
c,1	Marrëdhënie pune	182235		
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
<b>III</b>	<b>Totali (I+II)</b>	<b>10,654,733</b>	<b>581.679.000</b>	<b>1.83</b>

Për sa më lart është mbajtur Akt konstatimi nr. 1 me:

1. Z. A. M., Kryetar i Bashkisë Memaliaj;
2. Z. A. Xh., Drejtor i Drejtorisë së Financës.

**1.6. “Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënie me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor”**  
**Burimi i krijimit të të ardhurave.**

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin financiar në sistemin buxhetor të RSH”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23, datë 30.07.2008 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afat mesëm”, Bashkia Memaliaj me VKB nr. 85, datë 22.12.2022 “Për Miratimin e Buxhetit Afatmesëm 2023 dhe Buxhetin e vitit 2023 ” ka miratuar PBA 2023-2025 dhe buxhetin e vitit 2023.

Të ardhurat e programuara në PBA 2023-2025 mbështeten në nivelin e miratuar për taksat dhe tarifatat vendore të vitit 2023 si dhe realizimin e të ardhurave të vitit 2022, për çdo kategori taksapaguesish dhe njësitë administrative.

**Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave**

Hartimi i PBA 2023-2025 u bazua në ligjin Nr. 139/2015, date 17.12.2015 ”Për Vetëqeverisjen Vendore” , ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin në sistemin buxhetor në RSH”, ligjin Nr. 68/2017, date 27.04.2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.8 datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”, Udhëzimin plotësues nr. 23, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025”

Bazuar në ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “ Për sistemin e Taksave Vendore “ i ndryshuar, dhe aktet e tjera nënligjore sektoriale, Bashkia Memaliaj dhe NJA të saj, gjeneron të ardhura nga subjekte mbi të cilat aplikohen taksat dhe tarifatat vendore, të ndara në 4 kategori: - Biznes i madh dhe i vogël 10 subjekte; 6,618 familje; institucione 6 subjekte; ambulant 2 subjekte;

Numri dhe kategoria e taksapaguesve 2023 taksat dhe tarifatat vendore, si dhe numri i tyre.

Nr	Lloji	2023
1	Biznesi i Madh	10
2	Biznesi i Vogël	121
3	Ambulant (Hapësirat e tregut)	2
4	Institucione	6
5	Familjare	6,618

Kategoritë e mësipërme me përjashtim të institucioneve, ndahen në nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:

-Kategoria e Biznes ndahet në Biznes i Madh dhe Biznes i Vogël.

Kategoria “Familjarë” për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Për vitin 2023 janë planifikuar të ardhura nga burime të veta 30,000 mijë lekë. PBA 2023-2023 në parashikimin buxhetor për të ardhurat nga burimet e veta parashikon rritje të ardhurash në total 2 mijë lekë, krahasuar me faktin e vitit 2022 të realizuar 28,000 mijë lekë duke ruajtur të njëjtin nivel me parashikimin, si në vitin 2022 në shumën 30,000 mijë lekë.

Përgjatë vitit 2023, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar, zbatuar dhe realizuar 1 paketë fiskale.

Parashikimi për të ardhurat nga burimet e veta PBA 2023-2025 ( në mijë lekë)

Kodi	Lloji	Fakti 2022	Plani 2023	Plani 2024	Plani 2025
A.1	Te ardhura nga taksat lokale	8,520	9,200	11,050	11,058
A.2	Te ardhura nga taksat e ndara	2,870	3,000	8,043	8,043
A.3	Te ardhura nga tarifa vendore	8,404	8,500	15,620	15,620
A.4	Te ardhura të tjera	8,206	9,300	10,525	10,525
	TOTAL te ardhura	28,000	30,000	45,238	45,246

Planifikimi i të ardhurave në vitin 2023 në shumën 30,000 mijë lekë, ruan të njëjtin nivel parashikimi me PBA 2022, por të ardhurat tatimore parashikohen në ulje 550 mijë lekë, ndërsa të ardhurat jo tatimore parashikohen në rritje 550 mijë lekë.

Planifikimi i të ardhurave

Përshkrimi	Plan 2022-2024	PBA 2023-2025	Plani 2023/ Plan 2022
Te ardhura tatimore	13,690	14,240	-550
Te ardhura jotatimore	16,310	15,760	+550
TOTAL	30,000	30,000	0

Sipas peshës specifike në buxhet, të ardhurat nga taksa lokale me peshë specifike 30.67% në buxhet parashikohen me rritje 680 mijë lekë, të ardhura nga taksat e ndara me peshë specifike 10.00% në buxhet parashikohen në rritje 130 mijë lekë, të ardhura nga tarifa vendore me peshë specifike 28.33% parashikohen me rritje 96 mijë lekë dhe të ardhura të tjera me peshë specifike 31.00% parashikohen me rritje 1,094 mijë lekë. Gjenerimi të ardhurave mbështet në legjislacionin e fushës dhe tarifave vendore të miratuara me VKB nr. 70, datë 30.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresë nr. 22/1 prot, datë 13.01.2023.

Këshilli Bashkiak me Vendim të nr. 69, datë 30.12.2022 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve të bashkisë Memaliaj për vitin 2023” dhe konfirmuar nga Prefekti Qarkut Gjirokastrë me shkresë nr. 22/1prot, datë 13.01.2023, ka miratuar strukturën dhe nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Memaliaj.

Spektori i Tatimeve Bashkia Memaliaj, është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, dhe e përmbush detyrën e saj në mbështetje të ligjeve dhe të gjitha akteve normative që lidhen me taksat dhe tarifave vendore, me gjithë ndryshimet që ato pësojnë në vijimësi.

Struktura e Taksave dhe Tarifave, Bashkia Memaliaj, si dhe lëvizjet e punonjësve përgjatë vitit 2022 pasqyrohet si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Date fillimi	Emërimet	Largime 2023
1	E. C.	Përgjegjës i Sektorit të Tatimeve Taksave	09.08.2023	I komanduar me vendim 42, datë 09.08.2023	Lirim me Vendim nr. 02.01.2024, e efekt nga 04.01.2024
	E. L.	Specialist Tatimesh qyteti Memaliaj	20.08.2018		Larguar me vendim nr.58, date 13.09.2023 (Dorëheqje)
2	V. Xh.	Specialist Tatimesh qyteti Memaliaj	19.09.2023	I komanduar me vendim 64, datë 14.09.2023	
3	A. G.	Specialist Tatimesh qyteti Memaliaj	23.10.2020		
4	Sh. L.	Specialist Tatimesh Nj.Ad Memaliaj Fshat	20.08.2018		
5	J. Z.	Punonjëse Tatimesh Nj.Adm. Qesarat	02.02.2023		
6	M. Ç.	Punonjëse Tatimesh Nj.Ad Buz	03.09.2007		
7	P. M.	Punonjës Tatimesh Nj.Adm Luftinjë	01.10.2013		
8	M. L.	Punonjës Tatimesh Nj.Ad Krahës	21.02.2022		

Spektori i Tatimeve, Bashkia Memaliaj (deri në 09.08.2023) sipas strukturës organizative duhet të funksionojë me 8 punonjës nga të cilët 1 përgjegjës, 3 specialiste dhe 4 punonjës tatimor. Pozicioni Përgjegjësi i Sektorit të Tatimeve ka qenë vakant nga 01.01.2023 deri 09.08.2023, duke funksionuar me 7 punonjës gjithsej, nga të cilët 3 Specialistë dhe 4 punonjës tatimor, që mbulojnë qytetin e Memaliaj dhe 5 NJA përkatësisht Fshat Memaliaj, Krahës, Qesarat, Buz dhe Luftinjë.

Realizimi i të ardhurave për vitin 2023 është në shumën 27,903 mijë lekë, duke rezultuar me mos realizim në vlerën 2,097 mijë lekë ose realizuar në masën 93.01% krahasuar me planifikim në PBA 2023 në të cilin janë planifikuar 30,000 mijë lekë.

Të ardhurat nga taksat u realizuan në shumën 13,702 mijë lekë, duke rezultuar me mos realizim për 538 mijë lekë ose realizuar në masën 96.22%, krahasuar me planifikimin për 2023 prej 14,240 mijë lekë. Në këtë grupim përfshihen të ardhurat nga taksa mbi pasurinë, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, taksa të tjera vendore, etj.

Të ardhura nga tarifave vendore u realizuan 14,201 mijë lekë duke rezultuar me mos realizim për 1,559 mijë lekë ose realizuar në masën 90.11% krahasuar me planifikimin për 2023 prej 15,760 mijë lekë. Në këtë grup përfshihen të ardhura nga tarifave e shërbimeve publike, tarifa administrative, e të tjera jo tatimore.

Ndikim pozitiv në këtë grup kanë të ardhurat nga detyrime të prapambetura për gjoha, kamatëvonesë, të ardhura në burim, etj, realizuar në vlerën 5,870 mijë lekë, duke rezultuar me tejkalim për 1,420 mijë lekë ose realizuar në masën 131.92%, krahasuar me planifikimin prej 4,450 mijë lekë.

Realizimi i të ardhurave për taksat dhe tarifave vendore, në mënyrë analitike paraqiten në pasqyrën Aneksi nr. 1 "Realizimi i të ardhurat për taksat dhe tarifave vendore 2023":

Referuar realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, u konstatua se për vitin 2023 në total të ardhurat janë realizuar në vlerën 27,903 mijë lekë ose realizuar 93.01% ose rreth 2,097 mijë lekë më pak nga parashikimi i vitit 2023 në vlerën 30,000 mijë lek. Nga taksat dhe tarifatat e mësipërme për vitin 2023 rezultuan të realizuara më pak si vijon:

- Tatimi mbi tokën bujqësore me mosrealizim 2,598 mijë lekë ose -46.40%;
- Taksë mbi pasurinë e paluajtshme (ndërtesa) me mosrealizim 348 mijë lekë ose -11.61%;
- Taksë trualli me mosrealizim 407 mijë lekë ose - 84.84%;
- Taksë tregu me mosrealizim 275 mijë lekë ose -57.22%;
- Taksë tabele me mosrealizim 116 mijë lekë ose -48.28%; etj , ose deklaruar me zero arkëtim të ardhura nga taksa e kalimit të pronësisë.

Të ardhurat jo tatimore me pak të realizuara nga tarifatat dhe qiratë rezultuan:

- Tarifa për kullotat deklaruar me zero arkëtim të ardhura;
- Tarifa për zënie hapësire publike me zero arkëtim të ardhura;
- Tarifë për guroret me zero arkëtim të ardhura;
- Tarifë për dru zjarri me mosrealizim 1,219 mijë lekë ose -79.64%;
- Tarifë qira trualli për antenat me mosrealizim 810 mijë lekë ose -100%;
- Të tjera tarifa (nga shitje mallrash) me mosrealizim 472 mijë lekë ose -85.87%;
- Tarifë për objektet me qira me mosrealizim 364 mijë lekë ose -72.76%;
- Tarifë gjelbërimi me mosrealizim 172 mijë lekë ose -34.47%. etj.

**Konstatimi:** Për vitin 2023 niveli i realizimit të të ardhurave për taksa dhe tarifa vendore në Bashkinë Memaliaj u realizua 27,903 mijë lekë ose në masën 93% krahasuar me parashikimin 30,000 mijë lekë. Mos realizimi të ardhurave rezultoi në shumën 2,097 mijë lekë ose në masën 7%, duke sjellë diferencë ndërmjet treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta.

Mosrealizimi të ardhurave tatimore nga taksave dhe tarifave vendore si pasojë e mosrealizimit të të ardhurave nga: Tatimi mbi tokën bujqësore me mosrealizim 2,598 mijë lekë ose mos realizim 46.40%; taksë mbi pasurinë e paluajtshme (ndërtesa) me mosrealizim 348 mijë lekë ose mosrealizim 11.61%; taksë trualli me mosrealizim 407 mijë lekë ose mosrealizim 84.84%; taksë tregu me mosrealizim 275 mijë lekë ose mosrealizim 57.22%; taksë tabele me mosrealizim 116 mijë lekë ose mosrealizim 48.28% etj , ose deklaruar me zero arkëtim te ardhurat taksa nga taksa e kalimit të pronësisë .

Mosrealizimi te ardhurave jo tatimore është pasojë e mosrealizimit të të ardhurave nga tarifatat dhe dhënia me qira përkatësisht: Tarifa për kullotat me zero arkëtim te ardhura; tarifa për zënie hapësire publike me zero arkëtim te ardhura; tarifa për guroret me zero arkëtim te ardhura; tarifë për dru zjarri me mosrealizim 1,219 mijë lekë ose mosrealizim 79.64%; tarifë qira trualli për antenat me mosrealizim 810 mijë lekë ose mosrealizim 100%; të tjera tarifa (nga shitje mallrash) me mosrealizim 472 mijë lekë ose mosrealizim 85.87%; tarifë për objektet me qira me mosrealizim 364 mijë lekë ose mos realizim 72.76%; tarifë gjelbërimi me mosrealizim 172 mijë lekë ose mosrealizim 34.47%. etj.

### **Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënie me qira të aseteve.**

Spektori e të Ardhurave Vendore, sektoret e tjerë të Bashkisë Memaliaj, Agjentet Fiskalë të kontraktuar për arkëtimin e të ardhurave vendore, në funksion të realizimit të programit të të ardhurave për periudhën Janar-Dhjetor 2023, sipas tarifave të miratuara me VKB nr. 70, datë

30.12.2022 “Mbi miratimin e tarifave dhe Taksave Vendore për vitin 2023 ” kanë gjeneruar të ardhura në shumën 27,903 mijë lekë.

## Te Ardhura nga Taksat.

### Taksa mbi token bujqësore:

Të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2023 do të arkëtohet nga 5 njësite vendore ne te cilat shtrihet sipërfaqja e tokës bujqësore e ndare me ligjin nr.7501, date 19/07/1991 ne baze te regjistrave te krijuar duke u bazuar ne sipërfaqen e tokës bujqësore për çdo tatimpagues si dhe ne vlerën për çdo kategori te shprehur ne ligjin nr. 9632, date 30.10.2006 ”Për Sistemin e Taksave Vendore”, te ndryshuar.

Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore llogaritet si prodhim i sipërfaqes me çmimin sipas kategorisë. Klasifikimi sipas kategorive te tokës bujqësore është bërë nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ky detyrim është vjetor dhe paguhet me një kësht të vetëm deri më 30 shtator 2023.

VKB 70/2022 përcakton se struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Sektori i Financës dhe Tatimeve (Tatim –Taksa ) për Njësinë Administrative Memaliaj , kurse në njësitë e tjera administrative, struktura e ngarkuar është njësia administrative. Sipërfaqja e tokës e ndare me ligjin nr. 7501 date 19/07/1991 ne Njësitë Administrative mbi te cilën llogariten te ardhurat është 4,539 Ha, e detajuar sipas Njësive është si me poshtë.

Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore (në mijë lekë)

Nr	Emërtimi	Nr. fshatrave	Sip. tokës (ha)	Nr. i familjeve
1	Komuna Krahës	10	1,102	988
2	Nj. Adm Luftinjë	15	1,037	1,201
3	Komuna Buz	13	1,043	825
4	Komuna Qesarat	7	681	741
5	Komuna Fshat Mem.	7	676	746
	<b>Shuma</b>	<b>52</b>	<b>4,539</b>	<b>4,501</b>

Sipas të dhënave të Sektorit të Tatimeve, rezulton se NJA disponojnë regjistrat e tokës bujqësore me të dhëna mbi sipërfaqen e ndarë, kategorizimin e saj dhe numrin e familjeve të trajtuara me tokë sipas ligjit 7501/1999, i ndryshuar.

Sipas të dhënave rezulton se numri i familjeve të trajtuara me tokë është 4,501 fermerë me një sipërfaqe të përgjithshme prej 4,539 ha, të cilat të ndara sipas kategorisë së tokës dhe Njësive Administrative paraqiten në tabelat e mëposhtme:

### Planifikimi i taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Memaliaj për vitin 2023

Nr	Kategoritë e tokës	Totali	NJ.A. Krahës	NJ.A. Qesarat	NJ.A. Mem.Fshat	NJ.A. Luftinje	NJ.A. Buz	Vlera/Ha	Plani/Leke
		Sip/Ha	Sip/Ha	Sip/Ha	Sip/Ha	Sip/Ha	Sip/Ha		
1	Kategoria II	0	0	0	0	0	0	0	0
2	Kategoria III	480	25	135	243	55	22	1,400	672,000
3	Kategoria IV	555	42	148	184	156	25	1,350	749,250
4	Kategoria V	723	174	182	135	184	48	1,250	903,750
5	Kategoria VI	621	190	110	84	150	87	1,200	745,200
6	Kategoria VII	1,114	340	56	16	282	420	1,100	1,225,400

7	Kategoria VIII	1,046	331	50	14	210	441	1,100	1,150,600
	Totali	4,539	1102	681	676	1037	1043		5,446,2004

Të ardhurat për vitin 2023 u parashikuan me 5,600 mijë lekë dhe arkëtimi u realizua në shumën 3,002 mijë lekë, duke rezultuar me mos arkëtim për 2,598 mijë lekë ose realizuar 53.60%.

Njësitë Administrative disponojnë regjistrat e tokës me të dhënat e sipërfaqeve dhe kategorinë e tokave, si dhe marrëdhëniet juridike të pronësisë për familjet fermerë. Por regjistrat nuk janë përditësuar për një periudhë të gjatë, duke ndikuar në saktësinë e bazës së taksueshme dhe numrin e fermerëve objekt taksimi. Arkëtimi behet nga arkat e njësive administrative.

VKB 70/2022 në pikën 3.2 përcakton se “Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka. Pas vetëdeklarimit Sektori i Financave dhe Tatimeve (Tatim-Taksa) mund të bëjë verifikimin në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në rast të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do të llogaritet për të gjithë periudhën.”

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur lidhur me realizimin e taksës së tokës rezultoi se sipas të dhënave të sektorit të të ardhurave, numri i familjeve të trajtuara me tokë bujqësore rezultoi 4501 familje, me sipërfaqe të tokës së ndarë 4,539 ha, të cilët duhet të arkëtojnë taksën mbi tokën bujqësore sipas klasifikimit të kategorive.

Detyrimi vjetor sipas kategorizimit të tokës bujqësore rezultoi 5,446 mijë lekë, duhet të paguhet me një kësht të vetëm deri më 30 shtator 2023. Nga Nj.Ad të bashkisë Memaliaj arkëtimet për taksën e tokës bujqësore janë realizuar në vlerën 3,302 mijë lekë, duke rezultuar me mos faturim dhe mos arkëtim për 2,444 mijë lekë.

Nj.Ad nuk kanë përditësuar sipërfaqet e tokës bujqësore dhe numrit të fermerëve, duke ndikuar në mos arkëtimin për 2,444 mijë lekë të kësaj takse e cila përbën të ardhur të munguar, të Bashkisë Memaliaj, veprime në kundërshtim me pika 3.2, VKB 70/2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”; Pika 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; Pika 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Bashkia nuk paraqiti korrespondencë me Këshillin e Qarkut Gjirokastrë, për përditësimin e sipërfaqes së tokës së shpërndarë fermerëve.

**Konstatimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në lidhje me planifikimin dhe realizimin e taksës së tokës bujqësore, rezultoi se të dhënat dërgohen nga Njësitë Administrative sipas regjistrave të tokës me të dhënat mbi statusin e pronësisë për familjet fermere mbi sipërfaqet dhe cilësinë e tokave sipas kategorizimit bërë nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Të dhënat e regjistrat rezultojnë se nuk janë përditësuar për një periudhë tejet të gjatë, mbi 10 vjeçare, situatë e cila ndikon drejtpërdrejt në pasaktësinë e bazës së taksueshme dhe numrin e subjekteve objekt taksimi.

Për marrjen e të dhënave të sakta mbi sipërfaqen e tokës së shpërndarë në disponim të fermerëve dhe të asaj në pronësi të Bashkisë, u kërkua korrespondenca zyrtare e Bashkisë Memaliaj me Këshillin e Qarkut Gjirokastrë, cila nuk ekzistonte.

Mbi bazën e të dhënave të disponueshme të sektorit të taksave vendore, për vitin 2023, taksa e tokës bujqësore, si e ardhur me peshë specifike 18,67% në totalin e të ardhurave vendore, për 4501 familje për 4,539 ha llogaritet 5,446 mijë lekë.

4 Në PBA 2023-2025 u parashikuan 5,600 mijë lekë.



Bashkia Memaliaj për vitin 2023 ka parashikuar 5,600 mijë lekë të ardhura ose 154 mijë lekë më shumë se vlera e llogaritur sipas fondit të tokës së ndarë.

### Taksa mbi ndërtesat:

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

Këshilli Bashkiak me VKB 70/2022, pika 7 ka miratuar nivelet e taksës mbi ndërtesat sipas kategorive dhe nënkategorive për katër njësitë administrative.

Agjent tatimor për vjeljen e taksës mbi ndërtesën për “Popullatë” është Ujësjiellës- Kanalizime Gjirokastër sha, për Memaliaj-Qytet, sipas Marrëveshjes nr.149 prot, datë 24.01.2023 dhe Aneksit nr.1 bashkëlidhur saj.

Faturimi dhe arkëtimi taksës së ndërtesës kryhet nga punonjësit e vetë njësite administrative. Për ndërtesat për banim taksa e ndërtesës është 100 (njëqind) lekë/metër katror sipërfaqe për njësi pronësore. Akt- Marrëveshja në pikën 1 përcakton se: “Personi i autorizuar nga Shoqëria Ujësjiellës kanalizime Gjirokastër Sha merr në dorëzim listat emërore të familjeve nga bashkia Memaliaj”. Në pikën 2 përcaktohet se shuma në vlerë leku e detyrimeve përbën shumën për të cilën ngarkohet UK Gjirokastër sha. ...”

Bashkia Memaliaj për taksën e ndërtesës në bazë të regjistrave të krijuar në bashki dhe njësitë administrative ka planifikuar të ardhura në vlerën 3,000 mijë lekë.

Arkëtimet nga taksa e pasurisë së paluajtshme (ndërtesë dhe truall) u realizuan në vlerën 2,652 mijë lekë, duke rezultuar me mos realizim për 348 mijë lekë ose realizuar 88.39%. Taksa e pasurisë së paluajtshme përbehet nga taksa mbi ndërtesën në shumën 1,569 mijë lekë dhe taksa e truallit në shumën 1,083 mijë lekë, në total 2,652 mijë lekë të arkëtuara nga njësisë administrative dhe Memaliaj Qytet.

Nga auditimi rezultoi se në lidhje me administrimin e taksave/tarifave për kategorinë “Familjarë” në Memaliaj-Qytet nuk rezultuan arkëtime nga taksa e ndërtesës, sipas tarifës së përcaktuar në paketën fiskale 2023, në kundërshtim me ligjin nr.9632 datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar nëni 35 pika 2, Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Akt Marrëveshje nr.149 prot, date 24.01.2023, paragrafi “Detyrime të palëve”.

Nga sektori të ardhurave nuk është mbajtur regjistri i saktë mbi numrin dhe të dhënat familjeve si për Memaliaj- Qytet, dhe për 5 Nj.Ad të Bashkisë Memaliaj.

Për taksën e ndërtesës për ndërtesat për banim, të cilat nuk janë të lidhura me rrjetin e ujësjiellësit, Njësitë Administrative kanë faturuar dhe arkëtuar taksën e ndërtesës 2,272 mijë lekë, verpime konform pikës 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; pikës 2 të VKM nr. 132 date 07.03.2018 ”Për Metodologjinë e përcaktimit të vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa”, dhe pikën 3.1 të VKB 70/2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”.

### Taksa mbi ndërtesat (në mijë lekë)

Tatim ndërtese	Plani '23	Fakti '23
Tatim Ndërtese Popullate nga Ujësjiellës-Kanalizime sha (Memaliaj –Qytet)	-	-
Tatim Ndërtese nga Njësite Administrative (Takse Trualli)	2,381	2,272
Tatim Ndërtese Biznesi Madh	113	35
Tatim Ndërtese Biznesi Vogël	486	325

Tatim Ndërtese nga ndërmarrje dhe institucione	20	20
Tatim Ndërtese	3,000	2,652

**Konstatimi:** Sektori të Ardhurave dhe Sektori Financës në bashkinë Memaliaj lidhur me taksën e ndërtesës për ndërtesat për banim, nuk disponon regjistër të saktë dhe të përditësuar të familjeve me të dhëna për numrin e tyre, për sipërfaqet e banimit për çdo familje, për efekt të përcaktimit të bazës së taksës dhe llogaritjes së shumës së taksës për t'u paguar nga taksapaguesi. Bashkia Memaliaj nuk ka realizuar arkëtime nga taksa e ndërtesës për familje në Memaliaj-Qytet. Bazuar në të dhënat e regjistrit që disponon Sektori i të Ardhurave debitorët “Familjar” që nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Memaliaj në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive janë 2,505 familje debitorë për vlerën 6,680,975 lekë, nga të cilat, për vitin 2023 janë 2477 familje debitorë për vlerën 3,919,371 lekë. Gjendja debitorë e kategorisë “Familjar” për taksat dhe tarifave vendore, në krahasim me fundin e vitit 2022 është rritur me 1,157,767 lekë, për mos marrje të masave shtrënguese për arkëtimin e borxhit tatimor sipas dispozitave të Pika 2 në nenin 89 në Kreu XI të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, të punonjësve të Bashkisë Memaliaj në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme. Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj nuk ka kryer verifikimeve në terren për ndërtesat e tjera, të cilat nuk shërbejnë për qëllime banimi, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës, veprime në kundërshtim VKM nr. 132 date 07.03.2018 ”Per Metodologjinë e përcaktimit të vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa”, neni 2, pika 2.1

### **Taksa mbi truallin,**

Taksa e truallit aplikohet sipas kërkesave të ligjit nr. 9632 date 30.10.2006, “Për Taksat Vendore”, i ndryshuar me ligjin nr.142/2015 date 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632 date 30.10.2006, “Për Taksat Vendore”.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për biznesit është Sektori i Urbanistikës dhe Sektori i të ardhurave dhe Njësitë Administrative. Struktura e vjeljes së taksës mbi truallin për familjarët (Memaliaj-Qytet) është Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër, sipas Akt -Marrëveshjes nr. 149 prot, datë 24.01.2023.

Sipas VKB 70/2023 taksa e truallit (Jo Hapësirë Publike), paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona. Vlera e taksës është 0.14 lekë/m<sup>2</sup>/vit për qëllime banimi nga individët dhe 12 lekë/m<sup>2</sup>/vit për qëllime biznesi.

Të ardhurat për vitin 2023<sup>5</sup> nga taksa e truallit u parashikuan 480 mijë lekë dhe arkëtimi u realizua në shumën 73 mijë lekë, me mos realizim për 407 mijë lekë ose realizuar 15.16%.

### **Taksa e ndikimit në infrastrukturë**

Në zbatim të ligjit 9632 date 30.10.2006, ”Per Taksat Vendore” neni 27 pika 2, si dhe ligjit nr.142/2015 date 17.12.2015, “Per disa ndryshime në ligjin “Per Taksat Vendore” neni 14, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë, përcaktohet sipas natyrës së investimit dhe për vitin 2023 sipas VKB 70/2022 Bashkia Memaliaj ka ruajtur të njëjtat nivele si në vitin 2022.

Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Sektori i Zhvillimit Urban dhe Kadastrës pranë Bashkisë Memaliaj.

<sup>5</sup> Taksa e truallit në shumën 1,083 mijë lekë është raportuar si e ardhur në taksën e pasurisë së paluajtshme (ndërtesa).

Realizimi të ardhurve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë lejet për ndërtimet e reja dhe legalizimet u planifikua 840 mijë lekë dhe u realizua rreth 3,027 mijë lekë ose 2,187 mijë lekë më shumë se parashikimi buxhetor ose realizuar 360.41%.

Mbështetur në realizimin e viteve paraardhëse, ndërtimeve dhe bashkëpunimit me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, bashkia ka planifikuar rreth 840 mijë lekë të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja dhe nga legalizimi i ndërtimeve informale në bazë të zbatimit të procedurave të legalizimit.

### **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.**

Për vitin 2023 Sektori i Zhvillimit Urban dhe Kadastrës për shërbimet e ofruara nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve kur zhvilluesi është individ ose biznes ka aplikuar tarifa shërbimi të miratuara në VKB 70/2022 “Për miratimin e paketës fiskale 2023”.

Për vitin 2023 Bashkia Memaliaj ka dhënë 10 leje ndërtimi për të cilat vlera e arkëtuar ishte 2,993 mijë lekë pasqyruar në Anex nr. 2 “Arkëtime nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtime të reja”.

### **Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale, objekt legalizimi.**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori të Ardhurave, i cili planifikon dhe llogarit taksën e ndikimit në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje, konstatohet se ASHK Tepelenë për vitin 2023 ka dërguar zyrtarisht me shkresë nr.80, dt 16.01.2023, nr. 423, dt 01.03.2023; nr.497, dt 15.03.2023; nr.957, dt 09.06.2023;961, dt 09.06.2023; listat e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK Tepelenë.

Konkretisht për periudhën deri më 31.12.2023, ka rezultuar se sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës nuk është bërë pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas listës progresive nga 4 persona me vlerë 124,814 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Memaliaj, në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar.

### **Lista e subjekteve deklarues për ndërtimet e legalizuara**

Nr	ASHK-Tepelene	Bashkia Memaliaj	Njoftim Bashkia Tepelene	Subjekti	Vlera	Arkëtuar	Pa Arkëtuar
1	210, dt 24.02.23	423, dt 01.03.23	1100, dt 29.06.23	A. Xh.P	9,947	ma 222, dt 13.09.23	
2	244, dt 06.03.23	497, dt 15.03.23	629, dt 05.04.23	R.L.Ç	35,941	ma 95, dt 24.04.23	
3			630, dt 05.04.23	M.V.Z	6,718	ma 89, dt 14.04.23	
4	676, dt 02.06.23	957, dt 09.06.23	957/2, dt 13.06.23	Xh.F.K	13,209	ma 135, dt 22.06.23	
5			957/1, dt 13.06.23	H.A.K	17,612		17,612
6	696, dt 06.06.23	961, dt 09.06.23	961/2, dt 13.06.23	N.H.R	52,443	ma 136, dt 22.06.23	
7			961/1, dt 13.06.23	Z.H.H	30,527	ma 139, dt 22.06.23	
8	35, dt 10.01.23	80, dt 16.01.23	139, dt 20.01.23	N.F.Z	23,482		23,482
9			137, dt 20.01.23	M.N.H & D.F.H	57,613		57,613
10			136, dt 20.01.23	A.Nj.H	26,108		26,108
					273,599		124,814

**Konstatimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori të Ardhurave, i cili planifikon dhe llogarit taksën e ndikimit në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje,

konstatohet se nga ASHK Tepelenë për vitin 2023 janë dërguar zyrtarisht me shkresë nr.80, dt 16.01.2023, nr. 423, dt 01.03.2023; nr.497, dt 15.03.2023; nr.957, dt 09.06.2023;961, dt 09.06.2023; listat e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ASHK Tepelenë. Konkretisht për periudhën deri më 31.12.2023, ka rezultuar se sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës nuk është bërë pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas listës progresive nga 4 persona me vlerë 124,814 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Memaliaj, në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksë e ndikimit në infrastrukturë, pika 3/c. Nga Sektori të Ardhurave në fund të periudhës viti 2023 listat e debitorëve nuk janë dërguar në Sektorin e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 124,814 lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “dh”.

#### **Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura:**

Kjo taksë, në zbatim të Ligjit nr.9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, arkëtohet nga strukturat e DPSHTRR Gjirokastër dhe të ardhurat nga kjo taksë derdhen në favor të Bashkisë nga ku ajo përfiton 25 % të shumës së arkëtuar.

Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2023, u parashikuan në vlerën 3,000 mijë lekë dhe u realizuan në vlerën 4,439 mijë lekë, me tejkalim për 1,439 mijë lekë ose realizim 147.98%.

#### **Taksa të kalimit të pronësisë**

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Agjent tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tepelenë e cila përfiton 3% të shumës së arkëtuar.

**Konstatimi:** Nga auditimi rezultoi se Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tepelenë nuk ka transferuar në buxhetin e bashkisë Memaliaj të ardhura nga taksë e kalimit të pronësisë. Sektori të Ardhurave nuk ka rakorduar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Tepelenë për mbajtjen dhe arkëtimin e taksës së kalimit të pronësisë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9632/2002 “Për sistemin e taksave”, i ndryshuar.

#### **Të tjera taksë dhe tatime.**

Në zërin të tjera të ardhura nga taksë dhe tatime përfshihen të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe taksë biznesi në zbatim të Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar.

Të ardhurat për vitin 2023 nga tatimi i thjeshtuar u parashikuan 660 mijë lekë dhe arkëtimi u realizua në shumën 384 mijë lekë, me mos realizim për 276 mijë lekë ose realizuar 58.18%.

#### **Të tjera taksë dhe tatime (në mijë lekë)**

Lloji i Taksës, Tarifës	Plani '23	Fakti'23	Ndryshimi	Realizimi në %
Tatim i thj.mbi fitimin	180	109	-71	60.56%
Taksë Biznesi	-	70	70	
Taksë tregu	480	205	-275	42.71%
Total	660	384	-276	58.18%

## Të Ardhurat nga Tarifat

### Të ardhurat nga qiratë e tokave bujqësore

Të ardhurat nga qiratë e tokave bujqësore janë detyrime që burojnë nga shfrytëzimi i tokave bujqësore të cilat janë kontraktuar për dhënie me qira, konform ligjit nr. 8312 date 26.03.1998 “Për tokat bujqësore te pandara”, i ndryshuar; VKM nr.531 date 21.08.1998, “Për tokat bujqësore te pandara”; Udhëzimi nr. 1 date 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira te tokave bujqësore te pandara”. Çmimi minimal i qirasë për tokat bujqësore është sipas përcaktimeve të pikës 10, të Udhëzimit nr. 1 date 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira te tokave bujqësore te pandara”. Për qiratë e tokave pyjore tarifat janë të përcaktuara sipas VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për tarifatat në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1064, date 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”.

Struktura/at përgjegjëse për ndjekjen dhe realizimin e qirasë së tokës bujqësore është Sektori të Ardhurave dhe për tokën pyjore është Sektori bujqësisë, blegtorisë, pyjeve, ujitjes dhe kullimit. Sipas të dhënave të regjistrimit të tokës bujqësore të pandarë dhe dhënë me qira për 99 vjet, rezultoi se numri i familjeve të trajtuara me tokë bujqësore me qira është 4,501 fermerë me sipërfaqen e tokës se ndarë 4,539 ha të trajtuara sipas ligjit 7501/1991. Sipërfaqja e tokës së dhënë me qira është 318.06 ha .

Nr	Emërtimi	Nr. fshatrave	Sipërfaqja e tokës së ndarë	Sipërfaqja e tokës me qira	Nr. i familjeve trajtuar me tokë
1	Komuna Krahës	10	1,102	60.57	988
2	Nj. Adm Luftinjë	15	1,037	54.37	1,201
3	Komuna Buz	13	1,043	52.84	825
4	Komuna Qesarat	7	681	131.36	741
5	Komuna Fshat Mem.	7	676	18.92	746
	<b>Shuma</b>	<b>52</b>	<b>4,539</b>	<b>318.06</b>	<b>4,501</b>

Në vitin buxhetor 2023, Bashkia Memaliaj nga qiraja e tokës bujqësore planifikoi të ardhura gjithsej 1,596 mijë lekë, të cilat u realizuan 2,361 mijë lekë, duke rezultuar me mbi realizim për 765 mijë lekë ose realizuar 147.94%. Nga auditimi mbi likuidimin e detyrimeve nga dhënia me qira e toka bujqësore, për periudhën viti 2023, rezultoi se Sektori të Ardhurave për periudhën objekt auditimi administron 250 kontrata qiraje për dhënie me qira toka bujqësore të pandara për sipërfaqe 318.06 ha, në vlerën 1,714,621 lekë, me afate 99 vjeçare, të lidhura gjatë viteve 2012-2013 nga Nj/Administrative Krahës, Luftinjë, Buz, Qesarat, Fshat-Memaliaj.

### Sipërfaqen e tokës bujqësore dhëne me qira (progresive)

Nr	Emërtimi	nr. kontratave	Sipërfaqja me qira	Detyrimi për 2023	Arkëtuar 2023	Pa arkëtuar
1	Komuna Krahës	68	60.57	297,434	56,46	(240,974)
2	Nj. Adm Luftinjë	58	54.37	334,707	165,666	(169,041)
3	Komuna Buz	23	52.84	259,245	43,116	(216,129)
4	Komuna Qesarat	90	131.36	657,338	528,680	(128,658)
5	Komuna Fshat-Mem.	11	18.92	165,897	51,177	(114,720)
	<b>Shuma</b>	<b>250</b>	<b>318.06</b>	<b>1,714,621</b>	<b>845,099</b>	<b>(869,522)</b>

**Konstatimi:** Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira e tokave bujqësore të pandara për kontratat e vitit 2023 e para, u konstatua se 129 fermer nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, në vlerën 869,522 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj. Nga Sektori të Ardhurave bashkia Memaliaj, nuk janë marrë masa për zbatimin e kushteve të kontratës për arkëtimin e detyrimeve, nuk është dërguar informacion Drejtorisë Juridike me qëllim ndjekjen e rrugëve ligjore për arkëtimin e detyrimeve deri në zgjidhjen e kontratave me subjektet, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12, germa “g” dhe VKB-ve për miratimin e paketave fiskale.

### **Ta ardhura nga tarifa vendore për dhënien me qira për fondit pyjore dhe kulloror.**

Bashkisë Memaliaj bazuar në VKM nr.433, datë 08.06.2023 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive”, neni 31, shtojca 29, i janë transferuar sipërfaqet pyjore dhe kullorore, sipas listës së inventarit, që transferohen në pronësi të bashkive, bashkëlidhur këtij vendimi, e cila përmban listën e inventarit që fillon me numrin rendor 1 (një) deri 643 (gjashtëqind e dyzet e tre).

Sipas listës së inventarit përcaktuar në VKM 433/2016 në bashkisë Memaliaj janë transferuar kullota gjithsej 7,027.7 ha, nga e cila kullota verore 2,205.3 ha, kullota dimërore 5,002.4 ha, pyje 9,900 ha dhe toka jo produktive 3,049 ha.

Bashkia Memaliaj ka nënshkruar kontratë nr. 2683 prot, datë 26.12.2023 me shoqërinë “V. E.” për dhënien në përdorim të fondit pyjor kulloror me gjatësi lineare 1.26 km, në pronësi dhe administrim të bashkisë Memaliaj, për ndërtimin rrugëve ndihmëse, linjave gjatësore dhe tubacione për ndërtimin e HEC-ve “V. 1&2&3”, për qira vjetore në total 272,360 lekë, pagesë që do të kryhet brenda 30 ditëve.

#### **Të ardhura nga tarifa e kullotës së bagëtive (mijë lekë)**

	Sipërfaqja/ha	Kontrata 1-vjeçare	Sipërfaqja e kontraktuar	Sipërfaqja pa shfrytëzuar	Te ardhura
Kullota verore	2,205.3	11	1,767.20 m2	438.10	305
Kullota dimërore	5,002.4	4	149.00 m2	4,853.40	54
Kullota gjithsej	7,207.7	15	1,916.20 m2	5,291.50	359
Pyje	9,900.0	1	1.26 km		
Toka jo produktive	3,049 .0				
	27,364.0				

Sektori i Pyjeve dhe Kullotave për përdorimin e fondit pyjor dhe kulloror për kullotjeve se bagëtive ka nënshkruar me subjekte me status fermerë gjithsej 15 kontrata me afat 6 mujor, nga të cilat kullota verore 11 kontrata dhe për kullota dimërore 4 kontrata, duke gjeneruara të ardhura sipas tarifave të miratuara në VKB 70/2022 “Për miratimin e paktës fiskale të bashkisë Memaliaj për vitin 2023”. Pagesat e taksës kryhen në arkën e bashkisë dhe sipas mandat- arkëtimeve rezultuan se janë prerë gjithsej 11 mandat arkëtime për vlerën 359 mijë lekë. Sektori i financës arkëtimin nga tarifa e kullotës së bagëtive nuk e ka klasifikuar në kodin 7109100 “Tarifa për kullotat”, por 7109200 “Tarife qira tokë bujqësore”.

### **Tarifë për dru zjarri**

Në vitin buxhetor 2023, Bashkia Memaliaj nga tarifa për dru zjarri planifikoi të ardhura gjithsej 1,530 mijë lekë, të cilën e realizoi 312 mijë lekë, duke rezultuar me mosrealizim për 1,219 mijë lekë ose realizuar 20.36%.

### **Ta ardhura nga tarifa qira trualli për antenat**

Në vitin buxhetor 2023, Bashkia Memaliaj planifikoi të ardhura nga tarifa qira trualli për antenat gjithsej 1,530 mijë lekë, të cilat nuk u realizuan, duke rezultuar me mosrealizim 100%.

Nga auditimi i dokumentacionit të kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Memaliaj/ish Komunitat me palët e treta, rezultoi se janë lidhur 3 kontrata qiraje me 3 subjekte për antenat në fondin pyjor/kullor në pronësi të saj për një vlerë qiraje vjetore prej 980,000 lekë. Bashkia ka rivendosur në afat kontratën e qirasë nr. 12/3 prot., datë 14.01.2015 me subjektin Vodafon Albania, me shkresën nr..647/1 prot, datë 27.03.2024. Referuar kushteve të kontratës/ve nenit 4, pika 4.2, pagesa e qirasë do të jetë vjetore dhe do të bëhet brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës për llogari të institucionit. Nëse nga subjektet refuzohet pagesa po në zbatim të nenit 10, pika 10.1, nga bashkia zgjidhet kontrata për mos përmbushje të kushteve kontraktuale.

Nga auditimit pagesave të detyrimeve kontraktore rezultoi se subjektet nuk kanë likuiduar detyrimin vjetor për qiranë e truallit për vendosjen e antenave në shumën 980,000 lekë, e cila konsiderohet e ardhura të munguar për buxhetin e Bashkisë Memaliaj. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nga Sektori i Bujqësisë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe Sektori Juridik, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Memaliaj, mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e qirave, etj).

Kontrata	Pika	Detyrimi 2023	Pagesa	Pa arkëtuar
V. 2015/12	Gllave	340,000	0	340,000
V. 2015/12	Zhulaj	340,000	0	340,000
L. Shpk 2010/05	Gllave	300,000	0	300,000
Total		980,000		980,000

### **Tarifat e Pastrimit:**

Arkëtimi tarifës për “Abonentë familjarë” realizohet nga Ujësjetës Kanalizime Gjyrokastër sha në bazë të Akt Marrëveshjes nr.149 prot, datë 24.01.2023, për bashkinë Memaliaj dhe për Nj,Ad Fshat-Memaliaj, Krahës, Qesarat, Luftinjë dhe Buz arkëtimet realizohen nga vetë njësitë administratave. Për Institucionet, subjektet e biznesit të madh dhe subjektet e biznesit të vogël, që janë në territorin e bashkisë, faturimi dhe arkëtimi bëhet nga Sektori të Ardhurave në Bashkinë Memaliaj. Sektori të Ardhurave ka mbajtur akt rakordime mujore me Agjentin Tatimor. Të ardhurat nga tarifa e pastrimit për vitin 2023 u planifikuan 2,600 mijë lekë dhe u realizuan 3,542 mijë lekë, duke rezultuar me tejkalim për 942 mijë lekë ose realizuar 136.23%.

(në mijë lekë)

Tarifë Pastrimi	Subjekte	Plani 2023	Fakti 2023	Realizuar (%)
Tarifë Pastrimi nga Ndërmarrje dhe Institucione	9	143	83	58.04%
Tarifë Pastrimi Biznesi i Madh	10	736	479	65.08%
Tarifë Pastrimi Biznesi i Vogël.	121	1,440	836	58.06%
Tarifë Pastrimi nga Popullata –5 Nj Ad	6,682	281	2,144	762.99%

Shuma	6,822	2,600	3,542	136.23%
-------	-------	-------	-------	---------

### Tarifë Gjellbërimi:

Agjenti Tatimor për abonentë “Familjarë” Memaliaj (Qytet) për faturimin dhe arkëtimin është Ujësjiellës Kanalizim Gjirokastër SHA, sipas Marrëveshjes nr. 149 prot, date 24.01.2023. Sektori të Ardhurave ngarkohet me faturimin dhe vjeljen e detyrimeve, për subjekte të biznesit të vogël dhe të madh, ndërmarrje dhe institucione si dhe për taksapagues familjarë pa kontratë me UK. Për abonentët “familjare” Bashkia Memaliaj dhe 5 njësitë administrative nuk faturojnë tarifën e gjellbërimit. Për vitin 2023 tarifa e gjellbërimit u realizua 139 mijë lekë kundrejt detyrimit vjetor 243 mijë lekë. Me mosrealizim u paraqitën të katër grupet e subjekteve të tarifuar, biznes i vogël për 83 mijë lekë, biznes i madh për 45 mijë lekë, ndërmarrje dhe institucione për 30 mijë lekë, Memaliaj-Qytet 62 mijë lekë mungese të ardhura nga tarifa e gjellbërimit, në total në shumën 104 mijë lekë ose realizuar 57.30%, si më poshtë:

(në mije lekë)

Stansi Biznesit	Emertimi	Numër Subjekte	Detyrim	Pagese	Pa Paguar
Bv	Memaliaj	66	145	83	(62)
Bv	F.memaliaj	12	-	-	-
Bv	Qesarat	14	-	-	-
Bv	Luftinj	7	-	-	-
Bv	Krahes	18	-	-	-
Bv	Buz	4	-	-	-
Bv	Totali	121	145	83	(62)
Bm		10	57	45	(12)
Instit		8	41	11	(30)
		139	243	139	(104)

### Tarife Vendore Ndrëçimi

Në VKB nr. 70, datë 30.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023” janë miratuar tarifa vendore e ndrëçimit sipas ndarjes popullatës, biznes i vogël, biznes i madh, institucione dhe ndërmarrje shtetërore. Për abonentët “Popullate” në Njësinë Administrative Memaliaj, tarifa e ndrëçimit përfshihet në faturën mujore të lëshuar nga agjenti Ujësjiellësi Kanalizime. Sektori të Ardhurave ngarkohet me faturimin dhe vjeljen e detyrimeve, për subjektet e biznesit të vogël dhe të madh, ndërmarrje dhe institucione si dhe për taksapagues familjarë pa kontratë me UK. Detyrimi vjetor për tarifën e ndrëçimit ishte 1,231 mije lekë, dhe u realizua 238 mijë lekë, duke rezultuar me mos realizim për 993 mijë lekë ose realizuar 19.33%. Sipas llojeve të subjekteve arkëtimet më të ulëta rezultojnë në kategoritë “Biznes i vogël” për mosrealizim për 942 mijë lekë. Në Nj.Ad Luftinje dhe Nj.Ad Buz tarifa e ndrëçimit nuk faturohet.

(ne mije leke)

Statusi	Emertimi	Subjekte	Detyrim	Pagese	Pa Paguar
BV	Memaliaj	66	260	144	(116)
BV	F.memaliaj	12	800	8	(792)
BV	Qesarat	14	16	10	(6)
BV	Luftinj	7	-	-	-
BV	Krahes	18	44	16	(28)
BV	Buz	4	-	-	-
BV	Totali	121	1,120	178	(942)



BM	10	69	48	(21)
INSTIT	8	42	12	(30)
	139	1,231	238	(993)

**Konstatimi:** Tarifa e pastrimit nga ndërmarrjet dhe institucionet u realizua 83 mijë lekë ose 58.04%, nga subjektet e biznesit të madh u realizua 479 mijë lekë ose 65.08%, nga subjektet e biznesit të vogël u realizua 836 mijë lekë ose 58.06 %. Niveli i mos arkëtimit në këto kategori është 140 mijë lekë ose afërsisht 40% e detyrimit vjetor. Tarifa e gjelbërimit u realizua 139 mije lekë kundrejt detyrimit vjetor 243 mijë lekë. Me mosrealizim u paraqiten të katër grupet e subjekteve të tarifuar, me vlerë totale mungese të ardhura në shumën 104 mije leke ose realizuar 57.30%. Në Nj.A Fshat- Memaliaj, Qesarat, Luftinje, Krahes, Buz tarifa e gjelbërimit nuk faturohet. Detyrimi vjetor për tarifën e ndriçimit ishte 1,231 mije lekë, dhe u realizua 238 mijë lekë, duke rezultuar me mos realizim për 993 mijë lekë ose realizuar 19.33%. Sipas llojeve të subjekteve arkëtimet më të ulëta rezultojnë në kategoritë “Biznes i vogël” për mosrealizim për 942 mijë lekë. Në Nj.Ad Luftinje dhe Nj.Ad Buz tarifa e ndriçimit nuk faturohet.

#### **Tarifa për Zënien e Hapësirës Publike:**

Në zbatim të ligjit 9632 datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” , neni 32, është përcaktuar në masën 60 leke/m<sup>2</sup>/muaj për vitin 2023, me te drejtën e korrektimit te këtij niveli per njësite administrative periferike. Pagesës së kësaj tarife i nënshtrohen të gjitha subjektet që administrojnë hapësirë publike për interesat e biznesit të tyre në të gjithë shtrirjen territoriale të bashkisë Memaliaj sipas tarifave për zënien e hapësirës publike miratuar.

Bashkia Memaliaj, Sektori të Ardhurave nuk faturon dhe arkëton tarifën e zënies së hapësirës publike, në kundërshtim me Ligjin nr.9632 date 28.07.2008 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, i ndryshuar, neni 35, pika 1, germa “c” dhe VKB nr.70/2022 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023”.

#### **Të ardhura nga tarifa e lëshimit të licensave për karburantet**

Në këtë kategori përshihen të ardhura nga tarifa e lëshimit të licensave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Memaliaj. Aplikimi i tarifës për lëshimin e licensave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë bazohen në kërkesat e ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar; VKM nr.970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017; VKM nr.212, datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”; VKB Nr.70/2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”.

Struktura e ngarkuar për dhënien e kësaj licence dhe vjeljen e detyrimit është Zyra e Shërbimeve. Struktura e ngarkuar për penalitetet dhe për masat shtrënguese për detyrimin e pajisjes me licencë dhe pagesës me force është Policia Bashkiake.

Realizimi të ardhurave nga shitja mallra dhe shërbimeve u realizua rreth 550 mijë lekë ose 472 mijë lekë më pak se parashikimi buxhetor 550 mijë lekë në PBA 2023 ose realizuar 14.13%.

Sipas të dhënave 4 subjekte ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, pasqyruar si më poshtë vijon:

Nr.	Subjekti	Adresa ku ushtron aktivitet sipas QKB	Afati i Autorizimit		Detyrimi 31.12.2022	Detyrimi i krijuar 2023	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi				
1	G. shpk	Rr.Nacionale Tepelenë Memaliaj, pranë Urës	04.05.2020	04.05.2025			0	0
2	K. shpk	Rr.Nacionale, ish fabrika e fosforit Memaliaj	15.04.2022	15.04.2027			0	0
3	R.shpk	Rr.Nacionale Tepelenë Levan Qesarat	-	-	1,000,000	200,000	0	1,200,000
4	L. shpk	Rr.Nacionale Tepelenë Levan Krahës	-	-	1,000,000	200,000	0	1,200,000
<b>SHUMA</b>					<b>2,000,000</b>	<b>400,000</b>	<b>0</b>	<b>2.400,000</b>

Nga auditimi për ushtrimin e aktivitetit të tregëtimit të karburanteve për vitin 2023, rezultoi se 2 subjekte përkatësisht "R. shpk" dhe "L. shpk" nuk janë njoftuar nga Sektori të Ardhurave dhe nuk kanë aplikuar për rilicencim, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, germa b.

**Konstatim:** Nga mos aplikimi për rilicencim për 2 subjektet "R. shpk" dhe "L. shpk", janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë në vlerën 400 mijë lekë për vitin 2023, në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 22, pika 3, germa "dh"; VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, germa b.

### **Të Ardhura nga Debitorë**

Për vitin 2023 të ardhurat nga arkëtimi detyrimeve të prapambetura për taksa dhe tarifa vendore është planifikuar në shumën 4,450 mijë lekë dhe realizuar në shumën 5,870 mijë lekë, duke rezultuar me tejkalim 1,420 mijë lekë ose realizuar 131.92%.

Referuar të dhënave, detyrimet e prapambetura janë gjoba sistemi 152 mijë lekë, sponsorizime 200 mijë lekë, kamatëvonesa 146 mijë lekë, tarifa ushqimi nga kopshtet 609 mijë lekë, të tjera tatime mbi të ardhurat e mbajtura në burim 4,563 mijë lekë, tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi 10 mijë lekë, të tjera tarifa 190 mijë lekë.

### **Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2023.**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datë 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore në vlerën gjithsej 39,991 mijë lekë, janë debitorë të biznesit të vogël dhe biznesit të madh në vlerën 1,891 mijë lekë dhe familje për taksë toke 10,204 mijë lekë, taksë ndërtesë+truall në vlerë 3,347 mijë lekë, qira për tokë bujqësore në vlerën 4,441 mijë lekë, objekte me qira në vlerën 280 mijë lekë dhe te tjerë debitorë në vlerën 19,829 mijë lekë në mënyrë të përmbledhur në Anex nr. 3 pasqyra e "Debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2023"

Nga të dhënat rezulton se debitorët më 31.12.2023 paraqiten në vlerën 39,991 mijë lekë, ose me një rritje prej 1,771 mijë leke krahasuar me fundvitin 2022 në të cilin debitorët ishin 38,220 mijë lekë.

Për vitin 2023 rezultuan:

- Debitorë të biznesit të vogël dhe të madh në vlerën 1,891 mijë lekë. Krahasuar me vitin 2022 kanë pësuar rënie në vlerën 2,289 mijë lekë.
- Debitorë të taksës së tokës bujqësore në vlerën 10,203 mijë lekë krahasuar me fundvitin 2022 që kanë qenë në vlerë 7,552 mijë lekë, kanë pësuar rritje në vlerën 2,652 mijë lekë.
- Debitorë për taksën e ndërtesës dhe taksës së truallit në 31.12.2023 rezultuan debitorë në vlerën 4,441 mijë lekë, me rritje të taksës së ndërtesës në shumën 2,031 mijë lekë, krahasuar me fundvitin 2022 në të cilin gjendja e debitorëve në vlerën 1,313 mijë lekë;
- Debitorë për qira toke bujqësore rezultuan në 31.12.2023 rezultuan në vlerën 3,347 mijë lekë, me rritje të taksës së ndërtesës 2,853 mijë lekë, krahasuar me fundvitin 2022 në të cilin gjendja e debitorëve ishte 1,588 mijë lekë;
- Debitorë të ndryshëm në 31.12.2023 rezultuan 19,829 mijë lekë, me ulje të borxhit tatimor për taksa dhe tarifa vendore 2,853 mijë lekë, krahasuar me fundvitin 2022 në të cilin gjendja e debitorëve ishte 22,824 lekë;

**Konstatimi:** Nga auditimi dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga Sektori Taksave Vendore bashkia Memaliaj, u konstatua se debitorët në fund të periudhës 2023 janë gjithsej në vlerën 39,991 mijë lekë, krahasuar me fundvitin 2022 në të cilin debitorët ishin 38,220 mijë lekë. Në fund të vitit 2023 ndryshimi i gjendjes debitorë për taksa dhe tarifa vendore krahasuar me fillimin e vitit është shtuar me 1,771 mijë lekë. Nga auditimi nuk u konstatua asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimin të debitorëve. Rritja e gjendjes debitorë ka ardhur si pasojë e mos marrjes së masave shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve të papaguara për taksa dhe tarifave vendore, në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

*Për sa më lart ngarkohet me përgjegjësi z. E. C. ish përgjegjës Sektorit të taksave dhe tarifave vendore, bashkia Memaliaj.*

**Observacionet e subjektit:** Me shkresë nr. 864/1, datë 11.06.2024, protokolluar në KLSH me nr. 494/4, datë 13.06.2024, Bashkia Memaliaj ka dërguar saktësime lidhur me vlerën e debitorëve nga taksat dhe tarifave vendore, e cila në akt verifikim është paraqitur në vlerën 39,991 mijë lekë për shkak se janë përfshirë edhe subjektet debitorë jashtë kësaj kategorie, ndërkohë që vlera faktike vetëm për debitorët tatimorë është 20,272 mijë lekë.

**Qendrimi i grupit të auditimit:** Pas rishqyrtimit të të dhënave të dërguara, grupi i auditimit bën korigjimin e duhur në Raportin përfundimtar.

### **3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

*Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.*

Bashkia Memaliaj për vitin 2023 ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, duke plotësuar Formatin nr.9 të PF, ku përfshihet informacionit kontabël, përveç PF të Aparatit Bashkia Memaliaj

dhe informacioni kontabël i PF i njësisë vartëse shpenzuese Drejtorisë së Shërbimeve Komunale, e cila është me bilanc më vete dhe fondet i akordohen nga Bashkia.

#### Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Tepelene për vitin ushtrimor 2023 me shkresë përcjellëse nr.prot.543 datë 29.02.2024. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Memaliaj dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Përgjegjësi iFinancës. Pra në këtë rast nuk ka delegime të këtyre detyrave.

#### Rakordomi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt-rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

#### Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

#### Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave dhe partitarët për llogaritë kreditore e debitorë etj.

Konkluzion: Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera , duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël.Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël.Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”pika 2.2 “Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik”, ku ndër të tjera theksohet se: “...- Libra kontabiliteti, ditarë kontabiliteti, si dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet.- Dokumente të tjera kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme”Kreu III, pika 3.2 “Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njësisë të qeverisjes së përgjithshme” në të cilën përcaktohet: Mbyllja e llogarive vjetore nga ana e njësisë të qeverisjes së përgjithshme është një proces i domosdoshëm, i cili duhet të bëhet përpara përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, duke ndjekur rradhën kronologjike si më poshtë vijon: Nën-pika 43. Fillimisht, njësitë e qeverisjes së përgjithshme (në varësi të mënyrës së mbajtjes së kontabilitetit) përgatisin dokumentin përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, gjatë periudhës ushtrimore vjetore. Nën-pika 44. Këto njësi, në fillim të vitit ushtrimor, duhet të saktësojnë pozicionin e çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe të realizojnë transaksionin e transferimit të tepricës së llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12 “Rezultat i mbartur”. Nën-pika45. Pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, hartuesi i pasqyrave financiare duhet të realizojë veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, për periudhën ushtrimore që raportohet.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna per shkaku e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vlerës, personat qe kane urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhënat te nevojshme qe i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu :Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar të viteve 2022 dhe 2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Sektori i Financës. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, në disa raste nuk janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivitpër vitin 2022 është 981.098.969lekë dhe për vitin 2023 në vlerën 1.068967.498 lekë, i paraqitur në aneks dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

**AKTIVE AFATSHKURTRA.**

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” sipas bilancit në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 46,503,100 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në shumën 67,577,140 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica ne fillim të vitit ushtrimor” në vlerën 64,050,954 lekë dhe rubrikën VI “Teprica e likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor” në vlerën 67,577,140 lekë të Formatit nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte”. Gjendja kësaj llogarie sintetike përbëhet nga:

Gjendjet e llogarive 520 “Disonibilitete në Thesar” në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 52.437.297 lekë, llog. 532 “Vlera të tjera (mjete në ruajtje)” në vlerën 14,528,983 lekë dhe llog.50 “Letra me vlerë” në vlerën 610.860 lekë, e cila përfaqëson vlerën e letrave me vlerë gjendje ne arke, ku përfshihen biletat e tregjeve, biletat e parkimit, certifikata pyjore e transporti, etj. Gjendja e letrave me vlere ne 31.12.2023 është 610.860 lekë si me poshte:

	Nr. blloqesh	Nr.fletesh/bllok	Cmimi/flete	Vlera ne leke
Totali				610.860
Pulla		400	200	80.000
Bileta parkimi	12	100	50	60.000
Certifikat pyjore,transp	13b + 6 fije*	30	300	118800
bileta tregjesh	70 +41 fije	100	50	352060

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të bilancit të vitit 2022 në vlerën 29.637.190 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2023 në vlerën 6,648,638 lekë, ku diferenca e tyre në ulje për vitin ushtrimor prej 22,988,552 lekë është gjendja e llogarisë 63 “Ndryshimi I gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- Gjendja e llogarisë 31“Materiale” paraqitet në vlerën 0 lekë si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023, kur në fakt janë në vlerën 0 lekë .

- Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët” paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 29,637,190 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 në vlerën 6,648,638 lekë me një diferencë në zbritje për vitin ushtrimor prej 22,988,552 lekë, e cila përfaqëson pakësim të inventarit të magazinës për vitin 2023.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të bilancit të vitit 2022 në vlerën 48,440,377 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2023 në vlerën 51,205,842 lekë, ku kemi shtim, duke e krahasuar me vitin paraardhës si rezultat i shtimit të kreditorëve të ujesjellsit në shumën 40,330,009 lekë.

**Konkluzion:** Gjendja e llogarisë 411 “ Klientë dhe llogari të ngjashme” paraqitet në mbyllje të 2022 në vlerën 38,220,128 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 39,991,494 lekë, duke u debituar për vlerën e faturave të palikujduara në 31.12.2023 në kredi të llog. 401-408 “Furnitorë e llog. të lidhura me to”, në (pasiv të bilancit) veprim ky i gabuar, pasi për vlerën e furnitorëve (në aktiv të bilancit) debitohet llog. 4342“Operacione me shtetin (të drejta) në aktiv të bilancit. Llogaria 411 “ Klientë dhe llogari të ngjashme” është llogari që debitohet në kredi të llogarive 71 analizat përkatëse për të ardhurat nga shitja. Kjo vlerë i përket gjendjes debitorë të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në fund vitin 2023 sipas analizës së partitarit të kësaj llogarie në kredi të llog.4341“Operacione me shtetin(detyrime)” në pasiv të bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”i ndryshuar, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”pika 15 nënpika b, pika 4.2, pika 3.3.

-Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, si në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 0 lekë. Në fakt gjendja e kësaj llogarije paraqitet në gjendjen e llogarisë “411 “ Klientë dhe llogari të ngjashme” e cila paraqitet në mbyllje të 2023 në vlerën 39,386,128 lekë, duke u debituar për këtë vlerë në kredi të llog. 401-408 “ Furnitorë e llogari të lidhur me to”, veprim i gabuar kontabël. Por nga testimi dhe verifikimi i debitorëve rezultoi se analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e pësuara në vitin ushtrimor krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e pësuara në vitin ushtrimor krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në Aneks:

Referuar analizës së debitorëve të paraqitur në Aneksin në këtë llogari nuk janë evidentuar në mënyrë të saktë debitorët për taksat dhe tarifën vendore në vlerën 20,272,801 lekë, pasi nuk rakordon me vlerat debitorëve të Sektorit të Taksave, ku sipas të dhënave të tyre vlera deri në fund të vitit 2023 është në vlerën 20,162,801 lekë. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar edhe gjendja e debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të lëna nga Auditimi i Prefekturës në vitet e para 2016 dhe KLSH në vite në vlerën 19,718,693 lekë, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”.

Në aktiv të Bilancit në klasën 3 të llogarive të arkëtueshme janë paraqitur me gjendje debitorë:

- në mbyllje të vitit 2023 në aktiv llog.423,429 “Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba” në vlerën 8,481,276 lekë në kundërparti të llog.42 “Detyrime ndaj personelit” në pasiv, llog.431 “Tatime e taksa” në vlerën 459,023 lekë në aktiv në kundërparti të llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa” në pasiv dhe llog.436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 1,491.037 lekë në aktiv në kundërparti të llog. 435 “Detyrime për sig. shoqërore” në pasiv.

Llogaritë në aktiv të bilancit llog. 423, 429 “Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba”, llog.431 “Tatime e taksa”, llog.436” Sigurime shëndetësore” nuk duhet të paraqiteshin me gjendje, pasi vlerat e pasqyruara nuk janë të drejta të konstatuara, që ka shteti ndaj personelit, për paradhënie të pa derdhura nga personeli i Bashkisë apo tatime e kontribute të pa ndalura nga Bashkia punonjësve, por janë detyrime që ka Bashkia ndaj punonjësve për pagat e dhjetorit të vitit ushtrimor si dhe detyrimet për tatimin e të ardhurave dhe kontributet e sigurimeve të ndalura të pa derdhura. Shuma e llogarive në vlerën prej 10,431,336 lekë në mbyllje të vitit 2023 duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, e cila është paraqitur në mënyrë të pasaktë në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 783,012 lekë, vlerë për të cilën nuk ka shpjegim se çfarë përfaqëson. Gjendja e llog.4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” duhet të pasqyronte detyrimet afatshkurtra, duke u debituar në kredi të llogarive kundërparti në pasiv të Bilancit, pasi kjo llogari përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr.llog	Emertimi i llogarise	Viti ushtrimor 2023
467	Furnitore e llogari te lidhura me to	50,984,742
42	Detyrime ndaj personelit	8,481,276
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	459,023
435	Sigurime Shoqerore	1,491,037
		61,416,078

Pra gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” duhet të ishte paraqitur në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 61,416,078 lekë, gjithmonë nëse vlerat e llogarive të detyrimeve në pasiv të bilancit janë të sakta dhe reale. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 32 në të cilën përcaktohet se: Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre, ndërsa si të ardhura të njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogaritë financiare, duke mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti”), të cilat evidentojnë të drejta të njëjive të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”

Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8 “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin” në të cilën përcaktohet se:

Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo



kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabël në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:

a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi: - Debitohen llogaritë respektive të klasës 6, “Shpenzime sipas natyrës”; - Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42, 43, 40 e të tjera).

b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi: - Debitohet llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”; - Kreditohet llogaria 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti”.

c) Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës bëhet veprimi: - Debitohen llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4); - Kreditohet llogaria 520, “Disponibilitete në thesar”.

d) Paralel me veprimin e mësipërm artikullohet veprimi tjetër: - Debitohet llogaria 476, “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”; - Kreditohet llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”.

Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga :

Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 50,984,742 lekë, e cila kuadron me gjendjen e llog. kundërparti 467 “Kriditorë të ndryshëm” në pasivt ë bilancit.

## II. AKTIVET AFATGJATA

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatgjata” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet ( gjendjen e llog 23I “Investime”) në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 830,884,483 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 892,551,136 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,577,376,889 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,442,771,241 lekë, që janë të pasqyruara sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”(vlerën neto)ne aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,911,473 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 3,945,960 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,911,473 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 3,945,960 lekë. Shtesa prej 34.487 lekë përfaqëson vlerën e shtuar për mbikqyrje, dhe kolaudim për investimin me objekt: Rikonstruksion i rrugeve tosk Martallos”. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar si vijon:

### INVENTARI I LLOGARISE 202 "STUDIME DHE KERKIME " ME 31.12.2023

NR	EMERTIME	Gjendja 31.12.2022	Gjendja 31.12.2023	NR	EMERTIME	Gjendja 31.12.2022	Shtesa	Pakësim 2023	GJ.ME, 31.12.2023
1	Studim gjeologjik per varrezat qytet	96.000	96.000	12	Mbykqyrje punime shkollat	10.560			10.560
2	projekti rruga kallemb	390.000	390.000	13	Oponenc teknike luftine	125.450			125.450
3	Projekt ujesjellsi Ceril	398.000	398.000	14	Studim projektin kopeshti femijeve	69.600			69.600
4	Projekt rruge Memaliaj Fshat	424.000	424.000	15	Studim Prjektim rruga Leshnje	60.000			60.000
5	Projekt Miric - cerile	390.000	390.000	16	Studim projektin rruga F.Memaliaj	59.000			59.000
6	Studime kerkime Qesarat	374.000	374.000	17	Studim projektim Varreza Q.Memali	49.000			49.000
7	Studime Kerkime Krahes	619.600	619.600	18	Stu. Projek. Rikonst Rrugenv Njesit	250.000			250.000
8	Stu. Projek. Rikonst Rrugenv Njesit	57.600	57.600	19	Stu. Projek. Rikonst Rrugenv Njesit	50.000			50.000
9	Stu. Projek. Rikonst Rrugenv Njesit	50.000	50.000	20	Studim projektin reabilitim i mbetje	421.700			421.700
10	Mbykqyrje	23.760	23.760	21	Mbykqyrje Rruge Njesive tosk mart	0	30217		30.217

11	Mbyqyrje Rruge Njesive	43.200	43.200	22	Kolaudim Rruge Tosk-Martaloz	32900	4.270		4.270
	Shuma :					3.911.473	34.487		3.945.960

Konkluzion: Vlera e mbetur në fund të vitit 2023 prej 3,911,473 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 20 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizim. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36 i cili përcakton se: “Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%”

Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik “Pika2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: “Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit, si dhe vlerësimin e mëpasshëm:

a) Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicionit financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:

- Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;

- Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivitetit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera qëi shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivitetit (kosto projektimi, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivitetit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).

Aktivitet afatgjata jo materiale përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si: programet kompjuterike, markat, patentat, licencat, të drejtat e përdoruesit etj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM-së ashtu edhe të AAGJ/JM-së. Në këto raste, ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Shembull, një program kompjuterik (soft) përfshihet në AAGJM, nëse është pjesë përbërëse e pajisjeve kompjuterike, në të kundërt (pra, kur nuk është pjesë), trajtohet si AAGJ/JM” Kreu II. “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Pika 16/b.d të cilat përcaktojnë: “Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit, ndiqet procedura e mëposhtme:

b) Për shpenzimet e njohura të investimeve bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e investimeve (të grupit 23); dhe

- Kreditohet llogaria përkatëse e detyrimeve (klasa 4).

d) Në rastin e kapitalizimit të aktiveve afatgjata, të përfituara nëpërmjet shpenzimeve të investimeve (të regjistruar sipas pikës “b” më sipër), bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e grupit 20 ose 21 të aktiveve afatgjata; dhe - Kreditohet llogaria përkatëse e investimeve (grupi 23).

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitet 2022-2023.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit)“Aktivet afatgjata materiale” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 889.221.665 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023. 858.350.955 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,391,265,261 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,400,756,318 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- Gjendja ellog. 210“Toka, Troje, Terrene” (me vlerë neto) paraqitet e njëjtë si në mbyllje të vitit 2022dhe në mbyllje të vitit 2023në vlerën prej 119,998 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në vlerë të njëjtë si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën prej 119.998 lekë. Kjo gjendje nuk është e analizuar,pasi kjo vlerë nuk është e shpjeguar dhe e analizuar me emërtese se çfarë përfaqëson. Kjo vlerë është trashëguar nga ish-Komunat.

- Gjendja ellog. 211“Pyje, Plantacione” (me vlerë neto) paraqitet e njëjtë si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën prej 277,000 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet e njëjtë si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën prej 277,000 lekë. Kjo gjendje nuk është e analizuar, pasi kjo vlerë nuk është e shpjeguar dhe e analizuar me emërtese se çfarë përfaqëson. Kjo vlerë është trashëguar nga ish-Komunat.

Konkluzion: Nga auditimi i PF konstatohet se dy llogari të aktiveve afatgjata materiale paraqiten me gjendje të pandryshuar në vite të shprehur me kosto historike përkatësisht: llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 119,998 lekë dhe llog. 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 277,000 lekë, gjendje të cilat nuk janë të analizuar me emërtesa se çfarë përfaqësojnë. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

- Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksiione” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 336,970,869 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 319,562,526 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 487,893,848 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 494,880,197, ku diferenca në rritje është shtesë me pagesë në vlerën prej 6,986,349 lekë, e cila përfaqëson blerjen e aktivit “Rikonstruksiion dhe permirsim i banesave te komunitetit”. Analiza e kësaj llogarie paraqitet në Aneks.

- Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 443,266,649 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 542,276,780 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ( kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 855,748,512 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 997,546,069 lekë. Diferenca në rritje prej 141,797,557 lekë përfaqëson shtesën me pagesë që i përket blerjes së aktiveve: “Rikonstruksiion rruge te brendshme” në vlerën 5,397,557 lekë dhe “Ndërtimi i Ujesjellsit Rajonal Memaliaj”në vlerën 134,999,999 lekë, si dhe Mbikqyrjepunimesh në vlerën 1,400,000 lekë, e cila ka kaluar si vlerë e shtuar këtij aktiviti. Analiza e gjendjes kontabël së kësaj llogarie nga viti 2022 në vitin 2023 paraqiten në Aneks.

- Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në shumën 6,531,436 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën 5,340,098 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 14,836,688 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 15,664,860 lekë, për të cilat ka inventar fizik. Analiza e gjendjes kontabël së kësaj llogarie si dhe ndryshimet nga viti 2022 në vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabël i llog. 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"

Nr.	PERSHKRIMI	Vlera 01.01.2023	Shtesa 2023	pakësime 2023	Shuma 31.12.2023
1	Instalime ndricim publik.rrjet elektrik	4,519,553	0	0	4,519,553
2	Instalime Makineri Vegla Pune	83,828	0	83.828	0
3	Instalime Makineri Vegla Pune	1,263,085	0	0	1,263,085
4	Instalime Makineri Vegla Pune	4,161,470	0	0	4,161,470
5	Instalime Makineri Vegla Pune	1,833,938	0	0	1,833,938
6	Paisje kompjutera+ projektor	1.512.000	0	864.000	648.000
	Paisje kompjutera	21.6.000			216.000
	Vendosje kamera + intalime	1.246.814			1.246.814
	Kontenier per grumbullim mbeturinash		1.776.000		1.776.000
	<b>S H U M A : B. MEMALIAJ</b>	<b>14.836.688</b>	<b>1.776.000</b>	<b>947.828</b>	<b>15.664.860</b>

- Gjendja e llogarisë 215 "Mjete Transporti" në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 13,903,247 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 6,774,529 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/A "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 21,735,890 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 18,954,350 lekë.

Shtesat pagesë në vlerën 9,180,000 lekë për blerjen e 3 automjeteve: 1 kamion automjet kompaktor vetëshkarkues ne shumen 5.400.000 lekë, 1 automjet SUV 4\*4 ne vleren 1,860,000 lekë, 1 makinë hidra per prerjen e druve ne vleren 1,920,000 i ardhur nga Shoqëria "L."shpk, për të cilat është ndjekur procedurë e plotë për hyrjen e këtij aktivi në Bashki.

Pakësimet janë në vlerën 11,961,540 leke e cila përfaqëson transferimn e 2 minieskavatorëve në Ndërmarrjen e Shërbimeve Memaliaj të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Inventari kontabël i llogarisë 215 "Mjete transporti "me datë 31.12.2023

Nr.	PERSHKRIMI	Sasia	Vlera 31.12.2022	Shtesa 2023	Paksime 2023	Shuma 31.12.2023
1	Mjete Transporti	1	200,000	0	0	200,000
2	Mjete Transporti	1	180,000	0	0	180,000
3	Mjete Transporti	1	955,000	0	0	955,000
4	Mjete Transporti	1	1,182,750	0	0	1,182,750
5	Mjete Transporti	1	795,000	0	0	795,000
	<b>S H U M A : A. MEMALIAJ</b>		<b>3,312,750</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>3,312,750</b>
6	Mjeti Xhip	1	2,373,600	0	0	2,373,600
7	Mjete zjarrfikes	1	3,588,000	0	0	3,588,000
8	Mjete Eskavator Tip 5 ton	1	7.726.711	0	7.726.711	0
	Autmjet chevrolet Captiva e kuqe a	1	500.000			500.000
9	Mjete Eskavator Tip 1.9ton	1	4.234.829		4.234.829	0
10	Autmjet SUV4*4klas Captiva e kuqe	1	0	1.860.000		1.860.000

11	Mjete automjet kompaktor per mbet.	1		5.400.000		5.400.000
	Mjete hidro per prerjen e druve			1.920.000		1.920.000
S H U M A : B. MEMALIAJ			18.423.140			15.641.600
S H U M A : A + B .			21.735.890	9.180.000	11.961.540	18.954.350

- Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik” në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 27,209,379 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 30,760,663 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën kontabël 47,959,392 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 56,952,552 lekë. Në këto gjendje përfshihen shtesa me pagesë në vlerën prej 2,265,960 lekë që përket blerjes së këndit të lojrave dhe shtesa pa pagese (donacion) në vlerën prej 6,727,200 leke që i përket arredimit të Pallatit të Kulturës të financuar nga Projekti IADSA,

Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet nga viti 2022 në vitin 2023 paraqiten në Formatin nr.7/A, dhe 7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ( kosto historike)” dhe vlerë neto të PF si më poshtë:

E M E R T I M I	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit	Teprica ne Fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
c	1	2	3	4	5	6	8	9	10
I. AAGJ/JO MATERIALE	5,613,004	0	5,613,004	32,900	0	2,156,131	3,489,773	0	3,489,773
Prime te emisionit e rimbursi te huave			0				0	0	0
Studime dhe kerkime	5,613,004		5,613,004	32,900		2,156,131	3,489,773	0	3,489,773
Koncesio, patent,licenca e tj ngjash			0				0	0	0
II. AAGJ/ MATERIALE	1,400,756,318	511,534,653	889,221,665	31,489,004	51,647,374	10,712,340	1,421,532,982	563,182,027	858,350,955
Toka,troje, Terene	119,998		119,998				119,998	0	119,998
Pyje, Kullota Plantacione	277,000		277,000				277,000	0	277,000
Ndertime e Konstruksione	471,453,735	115,384,194	356,069,541	16,440,113	17,803,477		487,893,848	133,187,671	354,706,177
Rruge,rrjete,vepra ujore	849,733,629	365,019,444	484,714,185	4,055,731	24,235,709		853,789,360	389,255,153	464,534,207
Instalim teknik,makine,paisje,vegl pun	12,725,874	5,818,653	6,907,221		1,381,444		12,725,874	7,200,097	5,525,777
Mjete transporti	18,486,690	4,562,349	13,924,341	2,000,000	2,784,868	10,712,340	9,774,350	7,347,217	2,427,133
Rezerva shtetore			0				0	0	0
Kafshe pune e prodhimi			0				0	0	0
Inventar ekonomik	47,959,392	20,750,013	27,209,379	8,993,160	5,441,876		56,952,552	26,191,889	30,760,663
Aktive te Qend.te trupezuara demtua			0				0	0	0
T O T A L I ( I + II )	1,406,369,322	511,534,653	894,834,669	31,521,904	51,647,374	12,868,471	1,425,022,755	563,182,027	861,840,728

Nga Dega e Thesarit Tepelenë nuk është kërkuar regjistri aktiveve për regjistrimin në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ). Pra nuk ka një data basë me të dhënat aktiv për aktiv vetëm për Bashkinë Memaliaj, pra duke mos u kryer procesi i informatizimit të tyre.

Konkluzion: Për vitin 2023 nga auditimi i procedurës së evidentimit dhe kontabilizimit të aktiveve rezultoi se çdo aktiv ishte i regjistruar dhe i kontabilizuar sipas dispozitave ligjore, por njësia nuk dispononte një regjistër analitik aktivesh sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpashme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30.

### *Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023 Bashkia Memaliaj*

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2022 dhe 2023 për Bashkinë Memaliaj dhe Njësite Administrative .

Per vitin 2023 Titullari ka nxjerrë urdhrin me nr. 85 date 07.09.2023 “Per inventarizimin dhe vleresimin aktiveve te Bashkisë Memaliaj per vitin 2023” si dhe urdhrin per per kryerjen e inventarizimit dhe vleresimit per Njësitë Administrative si dhe drejtoritë e zyrat përkatëse. Këto komisione janë të përbërë nga 5 anëtarë, të cilët kanë kryer inventarizimin dhe vleresimin e Aparatit të Bashkisë, Qendrës, Kulturore, 4 shkolla të mesme, 5 shkolla 9-vjecare. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit dhe vleresimit rezultoi se komisionet e inventarizimit dhe vleresimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Memaliaj dhe për Njësitë Administrative. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material (Drejtuesit e institucioneve, magazinieri dhe punonjësit) brenda muajit dhjetor 2021. Për inventarin ekonomik dhe të imët të marrë në përdorim janë hapur kartelat personale për punonjësit përgjegjës material. Gjithashtu është bërë inventari i magazinës. Sipas fletëve të inventarit rezulton se nuk janë konstatuar diferenca ndërmjet gjendjes fizike dhe kontabël për çdo artikull. Ne asnjë rast të inventarëve të institucioneve apo të Aparatit nga komisioni i inventarizimit nuk janë mbajtur procesverbale apo raporte përmbledhëse për zhvillimin e procedurës dhe rezultatit e inventarizimit. Kështu nuk është evidentuar data e mbarimit të inventarizimit, por nga verifikimi i fletëve të inventarit rezulton se vlerat e aktiveve për llog.218 “Inventar ekonomik”, llog.31 “materiale”, llog.2015 “mjete transporti “shumat rakordojnë me vlerat e pasqyruara në bilancin e vitit 2021 në llogaritë përkatëse.

Pra mos dokumentimi i procedurës nëpërmjet procesverbaleve përkatëse dhe i rezultatit të inventarizimit në përmjet hartimit të raportit të inventarizimit nga Komisioni Inventarizimit është në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pika 856

Testi substancial i amortizimit

Referuar Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje te periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit. Nga testimet e kryera mbi përqindjet e aplikuara të normës së amortizimit mbi totalitetin e vlerave të mbetura sipas llogarive të klasës 21, përveq rastit të grupaktiveve joa materiale

---

6“Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për :

Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes se aktiveve ne ngarkim/perdorim te personelit te njesise publike dhe pasqyrimin e te dhenave te inventarizimit ne proceverbalin perkates, i cili ruhet gjate periudhes se inventarizimit..

Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.

Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes se tyre, gjëndjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.”

rezulton se, janë respektuar normat ligjore të amortizimit të përcaktuara në UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”pika 36.

Konkluzion: Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 dhe 2023 paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që kontrata prej 487,378,589 lekë për projektin e investimit me objekt:“Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal për fshatrat Vasjar, Iliras, Qësarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj” për të cilin vazhdojnë punimet dhe është financuar në vlerën pjesore prej 174,224,553 lekë. Në fund të vitit ka mbërritur fatura me vlerë 1,105,457 lekë e cila është figuron e pa likuaduar në datë 31.12.2023.Pra ky aktiv “Ujësjellsi i 9 fshatrave është i pa kapitalizuar e si rrjedhojë, duhet të kontabilizohet në llog.231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” dhe me përfundimin e kontratës të kalohej në vlerë të plotë në gjendjen e llog. “213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”,dhe jo në vlerë pjesore. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 2 Klasa 2 si dhe kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32.  
Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore është në total 75,705,673 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet e pasaktë si në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 39,386,128 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 38,220,128 lekë, vlera këto që i përkasin debitorëve në aktiv të bilancit, duke u pozicionuar gabim në pasiv. Gjendja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”në fakt si në mbyllje të vitit 2023 dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 0, duke mos u evidentuar faturat e palikujduara që u përkasin dhjetorit të vitit ushtrimor.

- Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit” paraqitet në vlerën 8,481,276 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2022 për pagat që do të paguhen në Janar të vitit pasardhës 2023.

- Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat” paraqitet në vlerën kontabël 459,023 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2021 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit pasardhës 2022.

- Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore” paraqitet në vlerën 1,491,037 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës.

- Gjendja e llogarisë 464 “Detyrimet për tu paguar për blerjen e letrave me vlere” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 610,860 lekë,e cilat rakordon me gjendjen e llogarisë kundërparti në aktiv të bilancit 532 ”Vlera të tjera”

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin( detyrime)” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 783,012 lekë , e cila është barabartë me gjendjen e llog. 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, vlerë e cila në fakt nuk dihet se çfarë përfaqëson. Llogaria 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën

e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme. Gjendja në këtë llogari është e pasaktë, pasi detyrimet ndaj shtetit/bashkisë nga debitorët në mbyllje të vitit 2023 janë në vlerën 39,991,494 lekë. Këto veprime janë kundërshtim me MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” ,Pika 3.3.

- Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarije në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 7,197,838 lekë dhe në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 7,382,788 lekë. Për këtë gjendje ka analizë dhe raportim në degën e Thesarit Tepelene, duke bërë akt-rakordim analitik, sipas investimeve të kryera, e cila paraqitet në Aneks:

Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve. Analiza e kësaj llogarie paraqitet në Aneks.

Në analizë: Formati nr. 2 “Pasqyra e performancës financiare” paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara PF për vitin ushtrimor 2023 dhe vitin paraardhës, sipas zërave më poshtë:

Analiza e llogarive të të ardhurave në bilancin 2023 në total 392,389,923 lekë si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Tepelene paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet “paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 11,154,162 lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike 7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 179,163 lekë e cila përfshin taksën mbi Biznesin e vogël , e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë 7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 3,074,514 lekë e cila përfshin taksën mbi ndërtesën dhe truallin, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë 7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie “pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 7,900,485 lekë e cila përfshin taksën e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin.etj.

- Gjendja e llogarisë 71 “Të ardhurat jo tatimore” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 7,546,798 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë 7109 “Të ardhura të tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 2,497,389 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b.Gjendja e llogarisë 711 “Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 5,049,409 lekë, e cila përfshin tarifën e, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.



- Gjendja e llogarisë 7200 “Të ardhurat nga Buxheti per NJQP (Qendrore)” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 350,700,411 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit, dhe përfaqëson grantin e akorduar nga pushteti qendror për Bashkinë Memaliaj.

- Gjendja e llogarisë 7204 “Të ardhura nga Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nationale” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 9,001,881 lekë, i cila përfaqëson të ardhurat nga fondet e akorduara si dhtesë në transfertën e pakushtëzuar për këtë njësi vendore si rezultata i rishikimit të buxhetit të shtetit me akt normativ. Pra kjo e ardhur është klasifikuar gabim pasi i përket llogarisë 7201 “Nga buxheti për NJQP (vendore), kjo sipas akt-rakordimit me Thesarin.

- Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën prej 11,214,348 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen në vlerën 783,012 lekë të llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në bilancit, vlerë kjo e pa saktë, pasi nuk psqyron detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, kur vlera e tyre në fakt në fund të vitit 2023 është 61,416,078 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8 “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin” në të cilën përcaktohet se:

Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabël në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:

a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi: - Debitohen llogaritë respektive të klasës 6, “Shpenzime sipas natyrës”; - Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42, 43, 40 e të tjera).

b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi: - Debitohet llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”; - Kreditohet llogaria 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti”.

c) Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës bëhet veprimi: - Debitohen llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4); - Kreditohet llogaria 520, “Disponibilitete në thesar”. Pra gjendja e logarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, duhet të përfshijë vlerën e detyrimeve të dhjetorit të palikujduar për shpenzime personeli për paga (600), për kontribute sig.shoqërore e shëndetësore e tatimore, vlerën e faturave të palikujduara për llog.602 “ mallra e shërbime”.

- Gjendja e llogarisë 7207 “Të ardhurat nga sponsorizime të brendshme (nga të tretë)” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 200,000 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit, dhe përfaqëson donacion nga PNUDI për financimin e projekteve sociale.

Analiza e shpenzimeve të bilancit në vitin 20203në vlerën 284,149,590 lekë:

- Gjendja e llogarisë 600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli' për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 106,864,145 lekë, e cila rakordon me akt-rakordimit me thesarin,
- Gjendja e llogarisë 601 'Kontribute për sigurime' për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 15,045,689 lekë, e cila nuk rakordon me akt-rakordimit me thesarin,
- Gjendja e llogarisë 602 'Blerje mallra e shërbime' paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 44,867,526 lekë, e cila nuk rakordon me akt-rakordimit me thesarin,
- Gjendja e llogarisë së fondeve 604 "Transferime korrente te brendshme" paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 6,740,303 lekë, e cila rakordon me akt-rakordimin me thesarin.
- Gjendja e llogarisë së fondeve 606 "Transferime per Buxhetet familjare e Individë" paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 143,446,441 lekë,

Per vitin 2023 totali i te ardhurave ne vlere është 392,389,923 lekë dhe totali shpenzimeve është 339,952,626 lekë. Diferenca e tyre ne vlerën 52,437,297 lekë, e cila rakordon me gjendjen e llog.85 "Rezultatit e ushtrimit"

Gjithashtu gjendja e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2021 është në vlerën - 1,777,558 lekë.

Nga testi kontrollit për vitin 2023 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve. Gjendja e arkës nuk e kalon limitet e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kreut III pika 34 dhe 35 geramat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 "Për limitin e arkës".

*Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë*

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- Mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në administrimin dhe qarkullimin e vlerave materiale, veprimet me magazinën dhe administrimi i karburantit.

- Veprimet nëpërmjet magazinës

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga nen/Kryetari.

- Nuk janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre si: viti i krijimit, shtesat dhe pakësimet për to, pra nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

*Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. Ad. Xh. me detyrë Drejtor i Financës dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe të hartuesit të pasqyrave financiare.*

**4. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (asete dhe pyje e kullota) të transferuara sipas VKM.**

Në zbatim të pikes 4 të programit të auditimit: “*Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Asete dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM*” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Inventarët e aseteve të kaluara me VKM Bashkisë dhe NJA nga Pushteti Qendror.
2. Listat e aseteve të kaluara në pronësi të Bashkisë së bashku me certifikatat hipotekore, si dhe lista e aseteve për të cilat janë përgatitur dokumentet tekniko-ligjore të depozituar në ASHK për pajisjen e Bashkisë me certifikatë hipotekore pronësie për këto asete.

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:***

- Asetet e kaluara nga pushteti qendror pranë Bashkisë Memaliaj paraqiten, sipas VKM-ve
- Për **Bashkinë Memaliaj** (Bashkia Qendër) është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Memaliaj, me VKM nr. 974 datë 30.09.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Memaliaj të Qarkut të Gjirokastrës”, sipas lidhjes nr.1 me 45 (dyzetepesë) fletë dhe përmbajtje 263 prona.

- Për **ish Komunën Qesarat** është miratuar lista e inventarit paraprak me VKM nr.417, datë 09.06.2005 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Qesarat, Qarku Gjirokastrë” Lista e inventarit me 55 (pesëdhjetëepesë) fletë përfundon me numrin rendor 353. Ne vijim është miratuar lista përfundimtare e inventarit me VKM nr. 341, datë 12.05.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Qesarat, Qarku Gjirokastrë”

- Për **ish Komunën Krahës** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 657, datë 21.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Krahës, të qarkut të Gjirokastrës. Lista e inventarit me 2 (dy) fletë përfundon me numrin rendor 28.

- Për **ish Komunën Buz** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 663, datë 28.09.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Buz të Qarkut të Gjirokastrës. Lista e inventarit me 93 (nëntëdhjetëetë) fletë, përfundon me numër rendor 667.

- Për **ish Komunën Luftinjë**, është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 790, datë 16.11.2006 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Luftinjë, të Qarkut të Gjirokastrës. Lista e inventarit me 122 (njëqinde njëzetedy) fletë, përfundon me numër rendor 865.

- Për **ish Komunën Fshat Memaliaj** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 1239, datë 10.09.2008 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Memaliaj Fshat, të qarkut të Gjirokastrës. Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Memaliaj Fshat, të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.5, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Fushë-Memaliaj, të qarkut të Gjirokastrës”.

Nga auditimi rezulton se referuar inventarit të aseteve, Bashkia Memaliaj zotëron në total 3293 asete, nga të cilat për 2,028 raste është miratuar lista përfundimtare, ndërkohë pjesa e mbetur janë në fazë paraprake. Nga Lista e aseteve të miratuara në mënyrë përfundimtare, rezulton se Bashkia Memaliaj ka bërë kërkesë për regjistrim pranë ZVRPP Tepelenë me shkresë nr. 468, datë 10.05.2016, vetëm për pasuritë nr. 5/288, 5/289, 5/285, 5/384 të cilat i korrespondojnë transferimeve sipas VKM nr. 974, datë 30.09.2009 cituar më lart dhe që i përkasin fushës së shëndetësisë si më poshtë:

<i>Emërtimi i pronës</i>	<i>Nr. pas</i>	<i>Nr. dok. hipotekor</i>	<i>Dt. regjistrimit</i>	<i>ZK</i>	<i>Adresa</i>	<i>Sip. truall m<sup>2</sup></i>	<i>Sip. ndertes</i>	<i>Pasqyruar ne bilanc</i>
<i>Qendra shendetesore Memaliaj</i>	5/288 5/289 5/285:384	H.13	06.06.2016	2646	Lagja nr 1	793.8	569.6	Jo
<i>Sheshi funksional i Qendres Shendetesore</i>	5/305	H. 08	06.06.2016	2646	Lagja nr 1	1079	-	Jo

Për asetet e mbetura, Bashkia Memaliaj nuk kryen inventarizim periodik të tyre, duke mos patur informacion as për gjendjen e tyre, nëse janë ende ekzistente, të zaptuara, privatizuara, etj. Ndërkohë nuk rezulton të jenë marrë masa as për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor të tyre për të vijuar me procesin e aplikimit dhe regjistrimit të tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nenin 18, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, pikën 18, 22, me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, invenatizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike”nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike” dhe VKM-së nr.669, datë 07.08.2013 ”Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)”.

**Sa i takon Pyjeve dhe Kullotave**, në bazë të VKM nr. 433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, Bashkisë memaliaj i atakojnë asetet sipas shtojces nr.29 bashkelidhur ketij vendimi, që fillojnë me nr. rendor 1 (një) deri në 643 (gjashtëqind e dyzet e tre).

Për sa më lart Bashkisë Memaliaj i janë kaluar në pronësi në total 18,527.24 ha pyje e kullota, nga të cilat 8,794.79 ha pyje, 8,703.6 ha kullota, 1,027.35 ha inproduktive dhe 1.5 ha dierr.

Nga auditimi rezulton se nga Sektori i Zhvillimit Urban dhe Kadastrës nuk janë marrë masa për regjistrimin në DVASHK Tepelenë, për këto sipërfaqe, në kundërshtim me nenet 5, 6 dhe 15 pika 2, të ligjit nr.9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar dhe me Manualin e Mbarështrimit të Pyjeve.

## **5. Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.**

Në zbatim të drejtimit nr. 5 “Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm” të programit të auditimit nr. 494/1 prot, datë 15.04.2024, nga auditimi rezultoi se:

### **I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.**

- Bashkia Memaliaj **ka miratuar** planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresë nr.1088/20 prot date 13.11.2023, **iashtë afatit 20 ditor** nga marrja e shkresës, në përputhje me nenin 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon planin e veprimeve, duke përcaktuar pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.

### **II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

- Bashkia Memaliaj në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, **nuk ka përgatitur** planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, **në shkëlqje të afatit 6 mujor**, në përputhje me pikën 2, të nenit 30 të

Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” .

**III.** Nga auditimi u konstatua **mungesë e gjurmës së raportimit** në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve, dërguar nga KLSH me shkresë nr. 428/10 prot, datë 09.10.2023, siç përcaktohet ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5.

Titullari i bashkisë ka miratuar Plan Veprimi mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresë nr. 428/10 prot date 09.10.2023, për periudhën e audituar 01.01.2023-31.12.2023, duke marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, duke përcaktuar afate dhe personat përgjegjës.

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, dërguar nga KLSH me shkresë nr. 428/10 prot, datë 09.10.2023, rezultoi se janë rekomanduar gjithsej **39 masa**, të cilat janë pranuar **plotësisht** ose në masën 100%.

Nga auditimi rezultoi se nga **39** masat e rekomanduara dhe të pranura janë zbatuar plotësisht **8** prej tyre ose **20.51 %**, në proces zbatimi **5** masa ose **12.82%** dhe pa zbatuar rezultuan **26** masa ose **66.67 %**.

Niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve për gjithsej **39 rekomandime** për përmirësimin e situatës, dërguar nga KLSH me shkresë nr.428/10 prot, datë 09.10.2023 është si më poshtë:

➤ Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **21 masa** organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, **8** janë zbatuar plotësisht, **1** masë në proces zbatimit dhe **12 nuk janë zbatuar**.

➤ Masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara), janë lënë **15 rekomandime në vlerën 38,801 mijë lekë**, të pranura plotësisht, nga të cilat, **4 rekomandime** në proces zbatimi dhe **11 rekomandime nuk janë zbatuar**.

➤ Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, janë lënë **2 rekomandime në vlerën 13,248 mijë lekë**, të cilat janë pranuar plotësisht, dhe të 2 masat nuk janë zbatuar.

➤ **1 masë** disiplinore, e cila **nuk është zbatuar**;

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit dërguar me shkresën nr. 872/8 prot., datë 30.12.2021, dhe protokolluar në Bashkinë Memaliaj me nr. 16 prot., datë 05.01.2022, janë ri-rekomanduar gjithsej **24 rekomandime**, të cilat janë pranuar **plotësisht** ose në masën 100%.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranura rezultoi se nga **24** masat e rekomanduara dhe të pranura janë zbatuar plotësisht **6** prej tyre ose **25.00 %**, në proces zbatimi **1** masë ose **4.17%** dhe pa zbatuar rezultuan **17** masa ose **70.83 %**

Niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve rezultoi si më poshtë:

➤ Për përmirësimin e gjendjes janë ri rekomanduar **17 masa organizative** dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, **6** janë zbatuar plotësisht dhe **11 nuk janë zbatuar**.

➤ Masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara), janë lënë **6 rekomandime** në shumen **57,310 mijë lekë**, të pranura plotësisht, nga të cilat, **1** masë në proces zbatimi, dhe **5** rekomandime nuk janë zbatuar.

➤ **1 rekomandim** për raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke respektuar njëkohësit edhe afatin e raportimit rezultoi i **pa zbatuar** nga bashkia Memaliaj, pasi ajo nuk ka marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH, duke mos respektuar afatin 6 mujor të raportimit, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1.1 Rekomandim:** Nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e strategjisë të risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Përgjigja e institucionit nuk përputhet me rekomandimin e lënë.

Në kushtet e mungesës së dokumentacionit mbi programet e trajnimit për zhvillimin profesional të stafit, mungesës plan-veprimi për MFK, mungesës për nxjerrjen e urdhërit për përmirësimin e Rregullores së brendshme të bashkisë, mungesës së “Hartës së proceseve të punës”, mungesa e menaxhimit dhe monitorimit të riskut, mungesa e përpjekjeve për ngritjen e sistemit informatik për të ardhurat rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

**Statusi: Pazbatuar**

**1.2 Rekomandim:** Nga Bashkia Memaliaj, Sektori i Burimeve Njerëzore të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Kodit të Punës.

**Deri në Dhjetor 2023**

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Institucioni nuk ka hartuar rregullore të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

**Statusi: Pazbatuar**

**3.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Memaliaj dhe Sektori Financës, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrijë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Memaliaj.

- Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

- Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;

- Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat çënojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;

- Gjithashtu për çdo vit të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Memaliaj.

**Në vijimësi**

**Komenti i grupit të auditimit:**

Bashkia Memaliaj nuk paraqiti dokumentacion për të argumentuar informacionin e dhënë. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pa zbatuar***.

**Statusi: Pa zbatuar**

**7.1 Rekomandim:** Sektori i Financës të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare, duke ndjekur fazat në mënyrë logjike, që nga mbajtja e dokumenteve përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, ta cilat duhet të jenë të balancuara dhe në përputhje me funksionin e tyre. Në fund të kryejë saktë veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke evidentuar dhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat të kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**Komenti i grupit të auditimit:**

Sektori i Financës nuk paraqiti te dhëna mbi përmirësimet e mbajtjes së kontabilitetit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***,

**Statusi: Pa zbatuar**

**8.1 Rekomandim:** Sektori i Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerën 38,220,128 lekë në aktivin e Bilancit të fundvitit 2022, me artikujt kontabël në debi të llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhur me to” në kredi të llog. 411 “Klientë të ndryshëm” si dhe në debi të llog.468 “Debitorë të ndryshëm” në kredi të llog. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim**

**Komenti i grupit të auditimit:**

Sektori i Financës nuk paraqiti te dhëna mbi sistemimit kontabël për vlerën 38,220,128 lekë në aktivin e Bilancit të fundvitit 2022.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***,

**Statusi: Pa zbatuar**

**9.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.



## Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Raporti KLSH ka konstatuar se gjendja e kësaj llogarie paraqitet në gjendjen e llogarisë 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme”, e cila paraqitet në mbyllje të 2021 në vlerën 34,655,100 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 38,220,128 lekë, duke u debituar për këtë vlerë në kredi të llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhur me to”, veprim i gabuar kontabël.

Spektori i Financës nuk paraqiti te dhëna mbi sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve sipas rekoamnimit të KLSH.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pazbatuar*,

**Statusi: Pa zbatuar**

**10.1 Rekomandim:** Spektori i Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerat e detyrimeve afatshkurtra në lidhje me pagat, tatimin mbi të ardhurat, kontributet shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor të vitit ushtrimor, të paraqitura gabimisht në llogaritë e arkëtueshme analoge në aktiv të bilancit, duke i përfshirë dhe saktësuar në gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në fund vitit 2022 dhe në rakordim me gjendjen në llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, e cila paraqitet e pasaktë në vlerën prej 0 lekë, në Formatin e Performancës së PF. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

## Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Spektori i Financës nuk paraqiti te dhëna mbi sistemimin kontabël për vlerat e detyrimeve afatshkurtra në lidhje me pagat, tatimin mbi të ardhurat, kontributet shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor të vitit ushtrimor, të paraqitura gabimisht në llogaritë e arkëtueshme analoge në aktiv të bilancit, duke i përfshirë dhe saktësuar në gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në fund vitit 2022 dhe në rakordim me gjendjen në llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, e cila paraqitet e pasaktë në vlerën prej 0 lekë, në Formatin e Performancës së PF, sipas rekomandimit të KLSH.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pazbatuar*,

**Statusi: Pa zbatuar**

**11.1 Rekomandim:** Spektori i Financës dhe Taksave Vendore në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime “dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

## Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Sektori i Financës nuk paraqiti te dhëna mbi sistemimin në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime “dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***,

**Statusi: Pa zbatuar**

**12.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Memaliaj të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” dhe në llog. 211 “*Pyje, Plantacione*” dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim**

**Komenti i grupit të auditimit:**

Kryetari i Bashkisë Memaliaj nuk ka ngritur grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” dhe në llog. 211 “*Pyje, Plantacione*”

Sektorit të Financës nuk paraqiti dokumentacion financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF, e në rast pasaktësish të kryehn sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***,

**Statusi: Pa zbatuar**

**13.1 Rekomandim:** Sektori i Financës dhe Tatim-Taksave në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimet kontabël për vlerat e të drejtave të konstatuara në lidhje me detyrimet që kanë të tretët ndaj shtetit si debitorët, të cilat nuk janë paraqitur në llogaritë e detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit, duke i përfshirë dhe saktësuar në gjendjen e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

*Deri me datë 31.03.2024*

**Komenti i grupit të auditimit:**

Sektori i Financës dhe Tatim-Taksave në Bashkinë Memaliaj nuk paraqitit sistemimet kontabël për vlerat e të drejtave të konstatuara në lidhje me detyrimet që kanë të tretët ndaj shtetit si debitorët, të cilat nuk janë paraqitur në llogaritë e detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit, duke i përfshirë dhe saktësuar në gjendjen e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***,

**Statusi: Pa zbatuar**

**14.1 Rekomandim:** Sektori i Financës dhe Taksave Vendore në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimet kontabël për vlerat e detyrimeve që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës llog.7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*”. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

*Deri me datë 31.03.2024*

**Komenti i grupit të auditimit:**

Sektori i Financës dhe Taksave Vendore në Bashkinë Memaliaj nuk paraqiti sistemimet kontabël për vlerat e detyrimeve që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës llog.7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*”.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***,

**Statusi: Pa zbatuar**

**18.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Memaliaj, të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e strukturës së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit në nivel Inspektorati (Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit) jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

-Rekrutimin në stafin e IMTV të punonjësve me formimin profesional të fushës, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti i grupit të auditimit:**

Bashkia Memaliaj nuk paraqiti informacion mbi zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**B.1. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.**

**1.1 Rekomandim:** Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **Ju rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

Masa organizative:

**1.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Memaliaj, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen e stafit me ligjin për MFK dhe manualin përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, caktimin e koordinatorit të riskut, të hartojë dhe të miratojë gjurmët e auditimi, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, ngritjen e njësisë së sinjalizimit për forcimin e aktiviteteve të kontrollit të bashkisë.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Bashkia Memaliaj nuk paraqiti informacion mbi zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**1.2. Rekomandim:** GMS të marrë masa për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor për aktivitetet dhe çështjet që duhet të analizojë si dhe grafikun e takimeve që do realizojë, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie për të arritur objektivat institucionale në shërbim të komunitetit.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Bashkia Memaliaj nuk paraqiti informacion mbi zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**2.1. Rekomandim:** Titullari i Bashkisë të marrë masa që të plotësojë strukturën e Auditit të Brendshëm me 3 punonjës sipas kriterëve ligjore. Njësia e Auditit të Brendshëm të kryejë një planifikim të auditimeve, duke marrë në konsideratë frekuencën deri në 1 vit në kryerjen e auditimeve, të realizojë auditime në fusha me risk të lartë dhe të thelluara, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. dhe të përfshijë në programet e angazhimit si drejtim vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Bashkia Memaliaj nuk paraqiti informacion mbi zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**3.1. Rekomandim:** Bashkia Memaliaj të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përfshijë kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe futjen e institucionit në vështirësi financiare.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Bashkia Memaliaj nuk paraqiti informacion mbi zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**4.1. Rekomandim:** Strukturat drejtuese të Bashkisë Memaliaj, për çdo vit buxhetor të marrë masa të ngrejë Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe me Grupet e Menaxhimit të Programeve (EMP) dhe në bashkëpunim me to, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që PBA krahas treguesve financiarë të përcaktojnë qëllimet e politikave të programeve, objektivat, prioritetet. Gjithashtu programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara, duke u bazuar në kërkesat e sektorëve dhe dëgjesa me publikun dhe palët e interesit.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Bashkia Memaliaj nuk paraqiti dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**5.1. Rekomandim:** Sektori i Financës të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare, duke ndjekur fazat në mënyrë logjike, që nga mbajtja e dokumenteve përmbledhës të

transaksioneve dhe veprimeve, që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, ta cilat duhet të jeni të balancuara dhe në përputhje me funksionin e tyre. Në fund të kryejë saktë veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke evidentuar dhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat të kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion nga bashkia Memaliaj.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pa zbatuar***.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**6.1. Rekomandim:** Sektori i Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerën 39,386,128 lekë në aktivin e Bilancit të fundvitit 2022, me artikujt kontabël në debi të llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhur me to” në kredi të llog. 411 “Klientë të ndryshëm” si dhe në debi të llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në kredi të llog. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion nga bashkia Memaliaj.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pa zbatuar***.

**Statusi: Pa zbatuar**

**7.1. Rekomandim:** Sektori i Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve. Këto veprime të kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion nga bashkia Memaliaj.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pa zbatuar***.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**9.1. Rekomandim:** Sektori i Financës dhe Tatim-Taksave në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse..

**Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion nga bashkia Memaliaj.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pa zbatuar***.

**Statusi: Pa zbatuar**

**13.1. Rekomandim:** Në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, **rikërkohet** marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të pa zbatuara dhe pjesërisht të zbatuara dhe inkurajojmë zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi. Kryetari i Bashkisë Memaliaj të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 872/8 prot., datë 30.12.2021, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion nga bashkia Memaliaj.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**14.1. Rekomandim:** Sektori i Tatimeve, Bashkia Memaliaj në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa për evidentimin e të gjithë subjekteve që zhvillojnë aktivitet, si dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje, të paregjistruar në QKB, dhe të ndjekë procedurat ligjore për detyrimin e tyre për licencim. Bashkia Memaliaj të bashkëpunojë me QKB dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, për përcaktimin e statusit të këtyre bizneseve dhe për ato biznese që kanë aktivitet të hapur të merret informacion zyrtar, mbi xhiron e subjekteve për të evidentuar nivelin e të ardhurave nga subjektet fizik/ juridik dhe mbi bazën e të ardhurave të realizuara në fund të periudhave ushtrimore të bëhet aplikimi i taksave e tarifave vendore në zbatim të Vendimeve të KB.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion nga bashkia Memaliaj.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pa zbatuar***.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara):**

**1.1. Rekomandim:** Sektori i Financës dhe i Tatimeve, Bashkia Memaliaj të marrë masa për hartimin e një regjistri të plotë e të saktë për të gjithë Bashkinë në mënyrë që të evidentohen të gjithë subjektet që zhvillojnë aktivitet, me të gjitha të dhënat për bazën e tatueshme, dhe të aplikojnë për secilin në mënyrë të saktë taksat dhe tarifave vendore që kanë detyrim ligjor, sipas paketës fiskale të miratuar. Të kryhet faturimi dhe njoftim vlerësimi i të gjithë bizneseve që kanë detyrime si dhe të kryhet evidentimi dhe kontabilizimi i pagesave të kryera dhe nxjerrja e saktë e debitorëve në fund të çdo viti ushtrimor. Për debitorët, të ndërmarrë të gjitha masat shtrënguese në rast mos pagesash, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore të akumuluar për 4 vitet 2018-2021 në vlerën 31,410,740 lekë.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion nga bashkia Memaliaj.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**2.1. Rekomandim:** Sektori i Financës dhe Tatim-Taksave në bashkëpunim me NJA të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore, dhe të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 5,239,500 lekë. Gjithashtu Bashkia Memaliaj të bashkëpunojë me UK sha Memaliaj duke lidhur Akt-marrëveshje për agjent tatimor për mbledhjen e taksës së ndërtesës dhe pastrim-gjelbërim-ndriçimit nga tatimpaguesit familjarë dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve të aplikohet masë administrative ndaj agjentit tatimor.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion nga bashkia Memaliaj.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**3.1. Rekomandim:** Strukturat Drejtuese, të ngrerë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrimit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marrë nga institucionet përgjegjëse (NJA/sectorët e bujqësisë, ZVRPP dhe Qarku Gjirokastrë), të nxjerrin njoftim detyrimet për familjet fermere të lëna jashtë skemës së pagesës së taksës së tokës bujqësore. Për debitorët, të nxirren njoftim-vlerësimet për detyrimet për gjithë kohën e papaguar për familjet fermerë dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative e ligjore në strukturat e tjera kompetente, sipas rastit.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion nga bashkia Memaliaj.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**4.1. Rekomandim:** Bashkia Memaliaj nëpërmjet bashkëpunimit institucional ti kërkojë ALUIZNI-t Drejtoria Tepelenë, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat pranë Bashkisë Memaliaj të taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Sektori i Financës dhe Tatimeve të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e listuar si debitorë bazuar në legjislacionin tatimor në tabelat e paraqitura në anekse.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion nga bashkia Memaliaj.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**6.1. Rekomandim:** Strukturat Drejtuese të Bashkisë Memaliaj nëpërmjet Sektorit të Bujqësisë, Sektorit Juridik dhe Integritimit në BE, Sektorit Urbanistik dhe Menaxhimit të Aseteve, Sektorit të Financës dhe Tatim-Taksave të marrin masa dhe të ndjekin të gjitha kontraktoret nga procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve qiradhënësit në vlerën 4,364,486 lekë dhe në rastet e mos pagesave të parashtrojë në KB, ku të marrë miratimin e tij për zgjidhjen e kontratave, që nuk janë efektive dhe kthimin e parcelave Bashkisë Memaliaj me inventar.

**Menjëherë**

**Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion nga bashkia Memaliaj.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**19.2 Rekomandim:** Nga Bashkia Memaliaj të merren masat e duhura për raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke respektuar njëkohësit edhe afatin e raportimit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pazbatuar*.

**Statusi: Pa Zbatuar**

## **C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).**

**1.1 Rekomandimi:** Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të bashkisë, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët.

Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerë **8,182,649** lekë.

**Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pazbatuar*.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**2.1 Rekomandim:** Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë 5,064,995 lekë, nga qiratë e tokës Bujqësore.

**Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**Komenti i grupit të auditimit:**

Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Memaliaj me palët e treta, në respektimin e detyrimeve ligjore për përlllogaritjen dhe pagesën e qirasë (për vitin 2023), përlllogaritjen e kamat-vonesave, si dhe marrjen e masave për arkëtimin e këtyre detyrimeve, u konstatua se në vitin 2023, gjendja debitorëve sipas listës së debitorëve në fillim të vitit 2023 është 5,064,995 lekë, shtuar për 869,522 lekë, pakësuar 845,099 lekë duke rezultuar në 31.12.2023 me gjendje debitorë 5,089,418 lekë. Bashkia dhe NJA nuk kanë ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë nga qiratë e tokës bujqësore.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pazbatuar*.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**2.2 Rekomandim:** Drejtoria Juridike të marrë masa, për ndryshimin e përmbajtjes së kontratave të qirasë për tokat bujqësore, duke reflektuar ndryshimin në kamatëvonesa dhe indeksimin e çmimit të qirasë çdo 5 vite.

**Menjëherë**

**Komenti i grupit të auditimit:**



Bashkia Memaliaj nuk ka reflektuar ndryshimin në kamatëvonesa dhe indeksimin e çmimit të qirasë çdo 5 vite.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

**Statusi: Pa Zbatuar**

**5.1 Rekomandim:** Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektori i Zhvillimit Urban dhe Kadastrës Bashkia Memaliaj, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 536,448 lekë, sipas listës që disponon Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj.

**Menjëherë**

**Komenti i grupit të auditimit:**

Nuk ka informacion për arkëtimin taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pa zbatuar***.

**Statusi: Pa zbatuar.**

**6.2 Rekomandim:** Sektori e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin Ligjor Bashkia Memaliaj, të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 2,400,000 lekë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti i grupit të auditimit:**

Nga Sektori të ardhurave nuk ka arkëtime nga riliçencimit dhe likuidimi të tarifës së licencimit të tregtimit të karburantit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pa zbatuar***.

**Statusi: Pa zbatuar.**

**7.1 Rekomandim:** Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit Publik dhe Sektori i Zhvillimit Urban dhe Kadastrës, të bashkërendojnë punën për evidentimin e subjekteve fizik/juridik që nuk janë të regjistruara në regjistrin tregtarë të kësaj njësie vendore, për pajisjen me Nipt sekondar dhe maturimin e detyrimeve për taksa e tarifa vendore. Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të pamaturuar në vlerën 180,000 lekë ndaj 5 subjekteve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti i grupit të auditimit:**

Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, nuk ka marrë masa për të ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të pamaturuar në vlerën 180,000 lekë ndaj 5 subjekteve

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pa zbatuar***.

**Statusi: Pa zbatuar.**

**9.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Memaliaj të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për përfshirjen e taksave dhe tarifave vendore që aplikohen në NJA-ve, në faturën e ujit të pijshëm, duke përdorur si agjent tatimor “UK Memaliaj” Sha, për arkëtimin e tyre.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti i grupit të auditimit:**

Me akt marrëveshjen nr.149 prot, datë 24.01.20223 lidhur ndërmjet bashkisë Memaliaj dhe UKGjirokaster sha, nuk është mundësuar shërbimi për arkëtimin e taksave dhe taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Ky shërbim ofrohet për tarifën e ndriçimit në njësite administrative Qytet-Memaliaj, Fshatin Vasjar, dhe Fshatin Izvor. Tarifa e pastrimit është ofruar për fshatin Memaliaj. Njësitë e tjera nuk mbulohen kjo akt marrëveshje.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

**Statusi: Pa zbatuar.**

**9.2 Rekomandim:** Sektori i Taksave Vendore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore nga taksat familjare prej 6,680,975 lekë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe pa ***zbatuar***.

**Statusi: Pa zbatuar.**

**9.3 Rekomandim:** Sektori i Taksave Vendore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore nga agjenti tatimor “UK Memaliaj” Sha, prej 1,125,309 lekë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe pa ***zbatuar***.

**Statusi: Pa zbatuar.**

**10.1 Rekomandim:** Sektori Taksave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve dhe Sektorin e Bujqësisë, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore dhe të pataksuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe pa ***zbatuar***.

**Statusi: Pa zbatuar.**

**11.1 Rekomandim:** Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 6,731,799 lekë nga taksa e tokës bujqësore.

**Menjëherë**

**Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe pa ***zbatuar***.

**Statusi: Pa zbatuar.**

## **D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1.1 Rekomandim:** AK në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kritereve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme. Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Memaliaj dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

**Menjëherë**

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe pa ***zbatuar***.

**Statusi: Pa zbatuar.**

**2.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Memaliaj, nëpërmjet Sektorit të Zhvillimit Urban dhe Kadastrës, të marrë masa që në të ardhmen, të aplikojë dhe të miratojë lejet e ndërtimit, në zbatim të përcaktimeve ligjore për kryerjen e punimeve të ndërtimit.

Të kërkohet nga mbikëqyrësit e punimeve të ndërtimit, kontrolli i mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, në mënyrë që të mos ndryshojnë në thelb kushtet kryesore të projektit, të përmirësohen treguesit e veprës, duke i bërë ato sa më eficiente, për t'i shërbyer komunitetit në kohë.

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Pa informacion

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe pa ***zbatuar***.

**Statusi: Pa zbatuar.**

## **E. MASA DISIPLINORE**

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Memaliaj t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.**

**Statusi: Pa zbatuar**

Për sa më lart mban përgjegjësi:

1. Z. A.M., me detyrë Kryetar i bashkisë Memaliaj dhe në cilësinë e NA.

2. Z. A. Xh., me detyrë Drejtor i Financës, në cilesinë e NZ dhe koordinatorit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve.

### III. GJETJE DHE REKOMANDIME

#### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se Bashkia Memaliaj:

Nuk ka ngritur një sistem efektiv për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim. Nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Nuk ka kryer procesin e vlerësimit të punonjësve për periudhën në auditim. Në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të cilëve rregullohen me kodin e punës, u konstatua se nuk janë hartuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre në punë. Nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave. Ndryshimet në strukturën organizative të miratuara me VKB, nuk kanë Organigramën korresponduese të strukturës si dhe këto ndryshime nuk janë pasqyruar në Rregulloren e brendshme. Nuk ka hartuar listën e proceseve/manualeve e procedurave të punës. Nuk është ngritur GMS për vitin 2023. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe ankesave, për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.1 në faqet 9-19 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe aktet në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Memaliaj, ka funksionuar me një auditues i cili është njëkohësisht dhe përgjegjës, pra nuk është plotësuar sipas strukturës së miratuar me 3 punonjës një përgjegjës dhe 2 specialistë, veprim në mospërputhje me neni 10, 11 të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pika 3, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin publik”.. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.1 në faqet 9-19 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Memaliaj dhe sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të organizohet dhe të funksionojë, sipas strukturës së miratuar me 3 punonjës.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se Bashkia Memaliaj për vitin 2023 ka hartuar dhe dërguar në MFE vetëm Raportin vjetor të monitorimit të buxhetit, për pasojë gjatë vitit nga Kryetari i Bashkisë nuk janë paraqitur në KB raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit, në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes

Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.2 në faqet 19-43 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Memaliaj, Drejtoria e Financës, të marrë masa që gjatë vitit buxhetor të hartohen tre raporte katër mujor për monitorimin e zbatimit të buxhetit, të cilat të dërgohen gjithashtu në MFE. Kryetari i Bashkisë të miratojë rregulla specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

**Në vijimësi**

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se, vlera e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore nga fatura të palikuiduara në datën 31.12.2023 është në vlerën 182,235 lekë. Vlera e detyrimeve të prapambetura në total për fatura të pa likuiduara nga investimet deri 31.12.2023 rezulton në vlerën 50,984,742 lekë, nga të cilat sipas raportimeve në MFE, 10,654,733 lekë janë detyrime të Bashkisë dhe 40,330,009 lekë janë detyrime nga Ministria e Linjës. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, neni 40, pika 3; Udhëzimi nr. 1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit", pika 5 dhe pika 8. Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 101. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.2 në faqet 19-43 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

**4.1.Rekomandimi:** Bashkia Memaliaj, Drejtoria e Financës, të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plane të detajuara për këtë qëllim dhe të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se referuar inventarit të aseteve, Bashkia Memaliaj zotëron në total 3293 asete të transferuara me VKM, nga të cilat për 2,028 raste është miratuar lista përfundimtare, ndërkohë pjesa e mbetur janë në fazë paraprake. Nga Lista e aseteve të miratuara në mënyrë përfundimtare, rezulton se Bashkia Memaliaj ka bërë kërkesë për regjistrim pranë ZVRPP Tepelenë me shkresë nr. 468, datë 10.05.2016, vetëm për pasuritë nr. 5/288, 5/289, 5/285, 5/384 të cilat i korrespondojnë transferimeve sipas VKM nr. 974, datë 30.09.2009 dhe që i përkasin fushës së shëndetësisë. Për asetet e mbetura, Bashkia Memaliaj nuk kryen inventarizim periodik të tyre, duke mos patur informacion as për gjendjen e tyre, nëse janë ende ekzistente, të zaptuara, privatizuara, etj. Ndërkohë nuk rezulton të jenë marrë masa as për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor të tyre për të vijuar me procesin e aplikimit dhe regjistrimit të tyre. Për sa i takon aseteteve, në Bashkinë Memaliaj nuk rezulton të ketë as një strukturë më vete për mbajtjen e dokumentacionit, inventarëve, administrimin dhe menaxhimin e aseteve në pronësi. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" nenin 18, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", pikën 18, 22, me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", Kreu IV "Përditësimi, invenatrizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike" nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 "Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike" dhe VKM-së nr.669, datë 07.08.2013 "Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)". *(Më hollësisht*

*trajtuar në pikën III.1.4 në faqet 63-67 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

**5.1.Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Memaliaj të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e gjendjes dhe numrit të aseteve të cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të fillohet përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre për të vijuar me aplikimet përkatëse për pajisje me çertifikatë pronësie.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 në vlerën 0 lekë, ndërkohë që kjo llogari paraqitet me gjendje referuar analizës së debitorëve të paraqitur në Aneks. Në fakt gjendja e kësaj llogarije në mbyllje të 2023 paraqitet në gjendjen e llogarisë “411 “*Klientë dhe llogari të ngjashme*” në vlerën 39,991,494 lekë në aktiv të bilancit, dhe në pasiv të bilancit në gjrmdjen e llog. 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhur me to*”, veprim i gabuar kontabël, pasi llog. 411 “*Klientë dhe llogari të ngjashme*” është llogari që debitohet në kredi të llogarive 71 analizat përkatëse për të ardhurat nga shitja dhe gjendja e llog. 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhur me to*” paraqet detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Referuar analizës së debitorëve nuk janë evidentuar në llog. 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, në mënyrë të saktë debitorët për taksat dhe tarifatat vendore si dhe debitorët paraqiten në vlera të konsiderueshme të cilat duhet të ishinparaqitur edhe në llog. kundërparti 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*” në pasiv të bilancit të paraqitur gabim në vlerën prej 783,012 lekë. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar edhe gjendja e debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të lëna nga Audit i Prefekturës në vitet para vitit 2016 dhe KLSH në vite në vlerën 19,718,693 lekë, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” Kreu II pika 15 nënpika b, pika 4.2, pika 3.3, Aneksi 1. (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.3 në faqet 43-63 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

**6.1.Rekomandim:** Drejtori i Financës në Bashkinë Memaliaj në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2024 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

**Deri me datë 31.03.2025**

**7. Gjetje nga auditimi:** Në aktiv të Bilancit në klasën 3 të llogarive të arkëtueshme janë paraqitur me gjendje debitorë:

- Në mbyllje të vitit 2023 në aktiv llog.423,429 “*Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba*” në vlerën 8,481,276 lekë në kundërparti të llog.42 “*Detyrime ndaj personelit*” në pasiv, llog.431 “*Tatime e taksa*” në vlerën 459,023 lekë në aktiv në kundërparti të llog.431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa*” në pasiv dhe llog.436 “*Sigurime shëndetësore*” në vlerën 1,491.037 lekë në aktiv në kundërparti të llog. 435 “*Detyrime për sig. shoqërore*” në pasiv.

Llogaritë në aktiv të bilancit llog. 423, 429 “*Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba*”, llog.431 “*Tatime e taksa*”, llog.436” *Sigurime shëndetësore*” nuk duhet të paraqiteshin me gjendje, pasi vlerat e pasqyruara nuk janë të drejta të konstatuara, që ka shteti ndaj personelit, për paradhënie të pa derdhura nga personeli i Bashkisë apo tatime e kontribute të pa ndalura nga Bashkia punonjësve, por janë detyrime që ka Bashkia ndaj punonjësve për pagat e dhjetorit të vitit ushtrimor si dhe

detyrimet për tatimin e të ardhurave dhe kontributet e sigurimeve të ndalura të pa derdhura. Shuma e llogarive në vlerën prej 10,431,336 lekë në mbyllje të vitit 2023 duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, e cila është paraqitur në mënyrë të pasaktë në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 783,012 lekë, vlerë për të cilën nuk ka shpjegim se çfarë përfaqëson, pasi nuk psqyron detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, kur vlera e tyre në fakt në fund të vitit 2023 është 61,416,078 lekë.dhe në mosrakordim me gjendjen në llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, e cila paraqitet e pasaktë në vlerën prej 11,214,348 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 15/b,59 /a,Kreu III. pika 32, Aneksi 1 pika 3.3 nënpika 8 (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.3 në faqet 43-63 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

**7.1.Rekomandim:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Memaliaj në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2024 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar, që për vlerat e detyrimeve afatshkurtra në lidhje me pagat, tatimin mbi të ardhurat, kontributet shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor të vitit ushtrimor, të paraqitura gabimisht në llogaritë e arkëtueshme analoge në aktiv të bilancit, ti kontabilizojë në mënyrë të saktë në gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe në rakordim me gjendjen në llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, në Formatin e Performancës së PF.

**Deri me datë 31.03.2025**

**8. Gjetje nga auditimi:** Vlera e mbetur në fund të vitit 202 prej prej 3,911,473 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 20 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% të vlerës së mbetur. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika16/b.d, Kreu III. pika 36, Aneksi 1 pika 2 Klasa 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.3 në faqet 43-63 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

**8.1.Rekomandim:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime “dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

**Deri me datë 31.03.2025**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i PF konstatohet se dy llogari të aktiveve afatgjata materiale paraqiten me gjendje të pandryshuar në vite të shprehur me kosto historike përkatësisht:llog. 210“Toka, Troje, Terrene” në vlerën 119,998 lekë dhe llog. 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 277,000 lekë, gjendje të cilat nuk janë të analizuara me emërtesa se çfarë përfaqësojnë. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në

njësité e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësité e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30 (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.3 në faqet 43-63 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

**9.1.Rekomandim:**Kryetari i Bashkisë Memaliaj të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” dhe në llog. 211 “*Pyje, Plantacione*” dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**Deri me datë 31.03.2025**

**10. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llog. 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*” si në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 dhe 2023 paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që për zbatimin e kontratës prej 487,378,589 lekë për projektin e investimit me objekt: “Ndërtimi i Ujësjiellit Rajonal për fshatrat Vasjar, Iliras, Qësarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj” vazhdojnë punimet. Vlera pjesore e kësaj kontrate e financuar prej 174,224,553 lekë, duhet të ishte pjesë e gjendjes së llog. 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*” dhe jo pjesë e gjendjes së llog. “213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*” siç ka ndodhur në fakt, pasi ky aktiv nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësité e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 2 Klasa 2 si dhe kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32 (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.3 në faqet 43-63 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

**10.1.Rekomandim:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Memaliaj të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*” deri në vlerë të plotë, dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave ti kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**11.Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2023 niveli i realizimit të të ardhurave për taksa dhe tarifa vendore në Bashkinë Memaliaj rezulton 27,903 mijë lekë ose në masën 93% krahasuar me parashikimin 30,000 mijë lekë. Mos realizimi të ardhurave rezultoi në shumën 2,097 mijë lekë ose në masën 7%, duke sjellë diferencë ndërmjet treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta. Mos realizimi të ardhurave ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë. Këto veprime janë kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Memaliaj miratuar me VKB nr. 70, date 30.12.2022 “Për Miratimin e Taksave e Tarifave Vendore Bashkia memaliaj për vitin 2023. (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.2 në faqet 19-43 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

**11.1.Rekomandimi:** Sektori i Taksave Vendore në Bashkinë Memaliaj, të forcojë në nivelet më të larta marrjen e masave për mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, duke synuar realizimin e të ardhurave të veta si burim financimi për shpenzimet e planifikuara prej saj.



**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në lidhje me planifikimin dhe realizimin e taksës së tokës bujqësore, rezultoi se të dhënat dërgohen nga Njësitë Administrative sipas regjistrave të tokës me të dhënat mbi statusin e pronësisë për familjet fermere mbi sipërfaqet dhe cilësinë e tokave sipas kategorizimit bërë nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Të dhënat e regjistrit rezultojnë se nuk janë përditësuar për një periudhë tejet të gjatë, mbi 10 vjeçare, situatë e cila ndikon drejtpërdrejt në pasaktësinë e bazës së taksueshme dhe numrin e subjekteve objekt taksimi.

Për të dhënat e sakta mbi sipërfaqen e tokës së shpërndarë në disponim të fermerëve dhe të asaj në pronësi të Bashkisë, nuk ka korrespondencë zyrtare mes Bashkisë Memaliaj me Këshillit të Qarkut Gjirokastrë. Mbi bazën e të dhënave të disponueshme të sektorit të taksave vendore, për vitin 2023, taksa e tokës bujqësore për 4501 familje për 4,539 ha llogaritet 5,446 mijë lekë. Bashkia Memaliaj për vitin 2023 ka parashikuar 5,600 mijë lekë të ardhura ose 154 mijë lekë më shumë se vlera e llogaritur sipas fondit të tokës së ndarë. Arkëtimet nga taksa u realizuan 3,302 mijë lekë, duke rezultuar me mos realizim për 2,444 mijë lekë, e cila përben të ardhur të munguar të Bashkisë Memaliaj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.2 në faqet 19-43 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

**12.1.Rekomandimi:** Sektori Taksave Vendore, Administratorët e NJA-ve dhe Sektori i Bujqësisë, të nisë një kërkesë zyrtare ndaj Këshillit të Qarkut Gjirokastrë dhe në bashkëpunim të marrin masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore dhe të pataksuar, me qëllim planifikimin e saktë dhe arkëtimin e taksës së tokës bujqësore.

### Menjëherë dhe në vijimësi

**13. Gjetje nga auditimi:** Lidhur me taksën e ndërtesës për ndërtesat për banim, Sektori i Taksave Vendore dhe Sektori Financës në bashkinë Memaliaj nuk disponon regjistër të saktë dhe të përditësuar të familjeve me të dhëna për numrin e tyre dhe sipërfaqet e banimit për efekt të përcaktimit të bazës së taksës dhe llogaritjes së shumës së taksës për t’u paguar nga taksapaguesi, ndërkohë që rezultoi se për banorët e njësisë memaliaj-Qytet nuk faturohen për këtë lloj takse. Bazuar në të dhënat e regjistrit që disponon Sektori i të Ardhurave, debitorët “Familjar” që nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Memaliaj në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive janë 2,505 familje për vlerën 6,680,975 lekë, nga të cilat, për vitin 2023 janë 2,477 familje debitorë për vlerën 3,919,371 lekë. Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj nuk ka kryer verifikimeve në terren për ndërtesat e tjera, të cilat nuk shërbejnë për qëllime banimi, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës, veprime në kundërshtim VKM nr. 132 date 07.03.2018 “Për Metodologjinë e përcaktimit të vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa”, neni 2, pika 2.1 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.2 në faqet 19-43 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

**13.1.Rekomandimi:** Bashkia Memaliaj të marrë masa për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksën e ndërtesës, veçanërisht për ata të njësisë Memaliaj-Qytet, duke përditësuar regjistrin me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës progresive 6,680,975 lekë.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave të aseteve të bashkisë dhënë me qira, rezulton se Bashkia Memaliaj ka lidhur 3 kontrata për dhënien me qera të trojeve për ngritje antenash, në nenin 4, pika 4.2 të të cilave parashikohet se pagesa e qirasë do të jetë vjetore dhe do të bëhet brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës për llogari të institucionit. Nëse nga subjektet refuzohet pagesa po në zbatim të nenit 10, pika 10.1, nga bashkia zgjidhet kontrata për mospërmbushje të kushteve kontraktuale. Nga auditimi pagesave të detyrimeve kontraktore rezultoi se subjektet nuk kanë likuiduar detyrimin vjetor për tarifën për qiranë e truallin për vendosjen e antenave në shumën 980,000 lekë dhe pavarësisht kësaj, Bashkia nuk ka marrë masa as për ndjekien e të gjitha rrugëve për vjelien e kësaj vlere dhe as për ndërprerjen e kontratës sipas parashikimeve të nenit 4 të saj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.2 në faqet 19-43 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

**14.1 Rekomandimi:** Sektori i Taksave Vendore bashkia Memaliaj në bashkëpunim me Sektorin Ligjor, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve për arkëtimin e vlerës prej **980,000 lekë**, dhe në rast të mos reagimit prej tyre të nisë procedurat për ndërprerjen e kontratës deri në likuidimin e detyrimeve.

Menjëherë

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e hidrokarbureve në territorin e bashkisë Memaliaj, rezultoi se për vitin 2023 subjektet "R.shpk", dhe "L. shpk" nuk kanë aplikuar për rilicencim, duke vijuar ushtrimin e aktivitetit në mungesë të autorizimit përkatës dhe rrjedhimisht duke mos paguar detyrimet që burojnë nga licensimi në vlerën 400 mijë lekë, në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, germa b dhe pika.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.2 në faqet 19-43 Raportit përfundimtar të Auditimit).*

**15.1.Rekomandimi:** Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me sektorin Juridik dhe Policinë Bashkiake, të marrin masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve të pa licensuar, për dorëzimin e doku,entacionit të nevojshëm për pajisjen me licensë dhe arkëtimin e detyrimit përkatës për licensimin, duke vijuar edhe me bllokimin e aktivitetit në rast të mos përgjigjes brenda një afati të vendosur në njoftim.

Menjëherë

**16.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua mungesë e gjurmës së raportimit në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 "Auditimi i jashtëm", pika 5, ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, dërguar nga KLSH me shkresë nr. 428/10 prot, datë 09.10.2023, rezultoi se janë rekomanduar gjithsej **39 rekomandime**, të cilat janë pranuar **plotësisht** ose ne masën 100%. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezultoi se nga **39** masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht **8** prej tyre ose **20.51 %**, në proces zbatimi **5** masa ose **12.82%** dhe pa zbatuar rezultuan **26** masa ose **66.67 %**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit dërguar me shkresën nr. 872/8 prot., datë 30.12.2021, dhe protokolluar në Bashkinë Memaliaj me nr. 16 prot., datë 05.01.2022, janë ri-rekomanduar gjithsej **24 rekomandime**, të cilat janë pranuar **plotësisht** ose ne masën 100%. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezultoi se nga **24** masat e

rekomanduara dhe të pranuara janë zbatuar plotësisht **6** prej tyre ose **25.00 %**, në proces zbatimi **1** masë ose **4.17%** dhe pa zbatuar rezultuan **17** masa ose **70.83 %**

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.5 në faqet 67-81 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

**16.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Memaliaj të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH të pranuara prej tyre, duke marrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve ende të pa zbatuara ose zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e procedurave për rekomandimet në proces zbatimi

**Menjëherë**

## **B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga Taksat dhe Tarifate Vendore u konstatua se gjendja debitorë në fund të vitit 2022 ka qenë në vlerën 15,765,329 lekë. Gjatë vitit objekt auditimi janë shlyer detyrime në vlerën 1,455,263 lekë, ndërkohë që janë krijuar detyrime në vlerë 5,952,735 lekë. Në fund të vitit 2023 rezulton se gjendja debitorë progresive nga taksat dhe tarifate vendore është në vlerën 20,272,801 lekë, vlerë e cila është e kontabilizuar në pasqyrat financiare 2023, nga e cila debitorë abonentë familjarë për 486 familjare, 46 subjekte biznes i vogël dhe 10 subjekte biznes i madh. Nga auditimi nuk u konstatua në asnjë rast zbatimi i plotë i procedurave për arkëtimin e vlerave debitorë dhe as marrja e masave shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve të papaguara për taksa dhe tarifate vendore, në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.2 në faqet 19-43 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** Sektori Taksave Vendore bashkia Memaliaj të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat dhe tarifate për biznese, institucione dhe familjare prej 20,273 mijë lekë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE – TË ARDHURA TË MUNGUARA**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga Taksat dhe Tarifate Vendore u konstatua se në fund të vitit 2023 rezultojnë debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 125 mijë lekë dhe nga pajisja me autorizime të subjekteve që ushtrojnë tregëti në fushën e hidrkarbureve në vlerën 2,400 mijë lekë, vlera të cilat nuk janë kontabilizuar në llogaritë përkatëse me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë. Për këto raste nuk u konstatua ndjekia e plotë e procedurave për arkëtimin e vlerave debitorë dhe as marrja e masave shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve të papaguara për taksa dhe tarifate vendore, në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.1.2 në faqet 19-43 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Sektori Taksave Vendore bashkia Memaliaj të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 2,525 mijë lekë të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për Bashkinë Memaliaj.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **D. MASA DISIPLINORE**

Për të gjithë punonjësit trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i auditimit, lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.*

#### **IV. ANEKSE**

Realizmi i të ardhurave për taksat dhe tarifatat vendore 2023 (ne mijë leke)

N/Llogaria	EMËTIMI I TË ARDHURAVE	PLAN	REALIZIM	%
<b>A</b>	<b>TË ARDHURAT NGA TAKSAT</b>	<b>14,240</b>	<b>13,702</b>	<b>96.22%</b>
7002100	Takse biznesi	-	70	
7035025	Taksë pasuri e paluajtshme (Ndërtesa)	3,000	2,652	88.39%
7020100	Taksë mbi tokën bujqësore	5,600	3,002	53.60%
7020200	Taksë trualli	480	73	15.16%
7035002	Taksë tregu	480	205	42.78%
7035003	Taksë e ndikimit në infrastrukture dhe Takse nga ndërtimet e reja.	840	3,027	360.41%
7204101	Taksë rregjistrimi automjeti	3,000	4,439	147.98%
7002200	Tatim thjeshtuar mbi fitimin	180	109	60.61%
7035009	Taksë tabele	240	124	51.73%
7035001	Takse per regjistrim biznesi	-	-	
7029200	Taksa të kalimit të pronësisë	420	-	0.00%
<b>B</b>	<b>TË ARDHURAT NGA TARIFAT</b>	<b>11,310</b>	<b>8,331</b>	<b>73.66%</b>
7110501	Tarifë pastrimi	2,600	3,542	136.22%
7035013	Tarifë gjelbërimi	500	328	65.53%
7035023	Tarifë ndriçimi	500	1,070	214.03%
7110106	Tarifë leje transporti	213	111	52.16%
7111007	Tarifë parkimi	100	71	71.30%
7109100	Tarifë qira trualli për antenat	810	-	0.00%
7109600	Tarifë për objektet me qira	500	136	27.24%
7109200	Tarifë qira toka bujqësore	1,596	2,361	147.94%
7035003	Tarifë zënie hapësire publike	138	-	0.00%
7113099	Të tjera tarifa(nga shitje mallrash)	550	78	14.13%
7113011	Tarifa nga MZSH	-	5	

7110199	Të tjera të ardhura	176	145	82.39%
7035011	Tarifë për dru zjarri	1,530	312	20.36%
7109300	Tarifë për guoret	120	-	0.00%
7109100	Tarifa për kullotat	1,657	-	0.00%
7035033	Tarife për shtypshkrimet	320	38	11.74%
7035045	Tarifë shërbim varrimi	-	135	
	Detyrime të prapambetura	4,450	5,870	131.92%
7115001	Gjoha nga sistemi	-	152	
7207011	Sponsorizime	-	200	
7115500	Kamate vonesa	-	146	
7111001	Tarifë ushqimi nga Kopshtet	-	609	
7204102	Të tjera tatime mbi të ardhurat mbajtur në burim	-	4,563	
7035032	Tarifa vendore për shqyrtim leje zhvillimi	-	10	
7111099	Të tjera tarifa	-	190	
	TOTALI B	15,760	14,201	90.11%
	TOTALI A+B	30,000	27,903	93.01%

Anexi nr. 2 Arkëtime nga taksa e ndikimit në infrastrukture për ndërtime të reja (në lekë)

Emërtimi sipas llojit	Objekti	Dt	Aplikanti	Zhvilluesi	Njoftim fillim punimesh	Njoftim përfundim punimesh	Zbatuesi i punimeve	Sip (m2)	Vlera e preventivit	Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukture
L.nr 1, date 07.04.2023	Objekte +restorant për akomodime turistike	21.02.2023			07.04.2024	jo		382.20	48,310,803	996,216
L. Nr 3 Date 06.06.2023	Ambient Banimi 1 kat	29.03.2023				jo		110.00	3,934,600	78,692
L.Nr.2 date 25.05.2023	Rikonstruksion e shtese banese egzistuese	17.04.2023				jo		204.00	3,829,134	76,583
L.nr 4, date 13.06.2023	Bujtine Vila Sofia On Top	02.05.2023			10.10.2023	jo		567.00	39,292,395	785,848
L.nr 1 date 13..09.2023	Ndërtim Banese mbi objektin egzistues	18.07.2023						170.00	5,462,705	109,254
L. Nr 4, Date 12.10.2023	Objekt banimi dhe shërbime per akomodime turistike	18.07.2023						464.32	39,684,470	793,985
L Nr 6, date 12.10.2023	Shtese shkalle kati per banese	18.08.2023				jo		133.70	3,311,688	66,234
LNr 7, Date 01.12.2023	Shtese kati mbi objekt egzistues	20.09.2023				jo		170.90	1,555,452	31,109
L. nr 3, Date 03.10.2023	Rikonstruksion shtese shkalle e kati per banese	03.10. 2023				jo		189.00	2,768,523	55,370

L.Nr 1, Date 28.03.2024	Bujtine per zhvillimin Rural	10.12.2023				jo		249.40	14,538,874	436,1667
TOTALI										2,993,291

Anex nr. 3 Debitorë për taksa e tarifa me datë 31.12.2023 ( në mijë lekë)

Nr.	EMERTIMI	Subjekte	Shuma	Shtesat	Pikësimet	Gjendja 31.12.23	Njësite Administrative
1	Biznes i vogël	28	3,072	752	2,658	1,166	Bashkia Memaliaj
2	Biznes i vogël	2	7	4	0	12	Nj. Ad. Buz
3	Biznes i vogël	2	62	0	20	42	Nj. Ad. Memaliaj Fshat
4	Biznes i vogël	3	58	0	36	22	Nj. Ad. Luftinje
5	Biznes i vogël	8	130	4	0	134	Nj. Ad. Krahes
6	Biznes i vogël	3	60	0	0	60	Nj. Ad. Qesarat
	<b>Shuma</b>	<b>46</b>	<b>3,388</b>	<b>760</b>	<b>2,714</b>	<b>1,435</b>	
1	Biznes i madh	10	793	0	336	457	Bashkia Memaliaj
2	Biznes i madh		0	0	0	0	Nj. Ad. Krahes
	<b>Shuma</b>		<b>793</b>	<b>0</b>	<b>336</b>	<b>457</b>	
1	Toka me qera		264	483	0	747	Nj. Ad. Luftinje
2	Toka me qera		869	0	77	792	Nj. Ad. Qesarat
3	Toka me qera		189	1,532	0	1,721	Nj. Ad. Buz
4	Toka me qera		36	299	0	335	Nj. Ad. Mem.Fshat
5	Toka me qera		230	616	0	846	Nj. Ad. Krahes
6	Pyje kullota		288	0	288	0	Nj. Ad. Qesarat
7	Pyje kullota		194	0	194	0	Nj. Ad. Mem.Fshat
	<b>Shuma</b>		<b>2,071</b>	<b>2,930</b>	<b>560</b>	<b>4,441</b>	
1	Objekte me qera	3	280	0	0	280	Nj. Ad. Qesarat
	<b>Shuma</b>		<b>280</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>280</b>	
1	Takse ndërtese	445	929	78	0	1,008	Nj. Ad. Qesarat
2	Takse ndërtese	906	0	1,140	0	1,140	Nj. Ad. Krahes
3	Takse ndërtese	300	93	208	0	300	Nj. Ad. Buz
4	Takse ndërtese	310	164	201	0	365	Nj. Ad. Mem.Fshat
5	Takse trualli	445	0	123	0	123	Nj. Ad. Qesarat
6	Takse trualli	906	0	285	0	285	Nj. Ad. Krahes
7	Takse trualli	310	127	0	0	127	Nj. Ad. Mem.Fshat
	<b>Shuma</b>		<b>1,313</b>	<b>2,034</b>	<b>0</b>	<b>3,347</b>	
1	Toka bujqësore	906	468	2,106	434	2,140	Nj. Ad. Krahes
2	Toka bujqësore	445	5,841	198	0	6,039	Nj. Ad. Qesarat
3	Toka bujqësore	310	421	164	0	585	Nj. Ad. Mem.Fshat
4	Toka bujqësore	300	821	619	0	1,440	Nj. Ad. Buz
	<b>Shuma</b>		<b>7,552</b>	<b>3,086</b>	<b>434</b>	<b>10,204</b>	
1	Instucionet	5	348	0	238	110	Bashkia Memaliaj
2	Shërbimi Taksi viti 2021		21	0	21	0	Bashkia Memaliaj
	<b>S H U M A : I + II+3+4+5+6+7+8</b>		<b>15,765</b>	<b>8,811</b>	<b>7,040</b>	<b>20,272</b>	

Anex. 4 Detyrimet e prapambetura Bashkia Memaliaj, në lekë

Nr.	Përshkrim i veprimit	Nr. / Datë - Fature	Vlera e kredisë (detyrim) në 31.12.2022	Shtesa gjatë vitit 2023	Pakësime gjatë vitit 2023	Vlera e kredisë (detyrim) në 31.12.2023
1	Shërbim Postare		174,539	127,849	93,806	208,582

2	Ujë		127,104	1,049,328	1,176,432	-
3	Energji		8,393,535	-	1,569,582	6,823,953
4	Energji		100,676	1,791,258	1,891,934	-
5	Shërbim interneti		9,000	117,000	117,000	9,000
6	Shërbim interneti		-	130,000	130,000	-
7	Bonus karburanti		180,000		-	180,000
8	Studim Projektim		5,340		5,340	-
9	Vendim gjyqësor		150,407			150,407
10	Shërbimi pastrimit		1,213,662		-	1,213,662
11	Shërbimi pastrimit		399,628	6,628,572	6,539,383	488,817
12	Studim Projektim		27,360		27,360	-
13	Studim Projektim		14,400		14,400	-
14	Studim Projektim		27,600		27,600	-
15	Studim Projektim		12,000		12,000	-
16	Kolaudim		6,000		6,000	-
17	V gjyqësore	672, dt 10.11.16	31,828			31,828
18	naftë	596/22, dt 31.10.22	463,600	-	463,600	-
19	naftë	724/22, dt 31.12.22	156,815	-	156,815	-
20	Ndërtimi Ujësellsit	07, dt 31.10.2022	14,135,322	-	14,135,322	-
21	Mirmëbajtje sistemi	1753/2, dt 20.12.2022	5,000	-	5,000	-
22	Sig automjete	15920-15938, dt 23.1.23		145,887	145,887	-
23	Blerje Flamuj	24/23, dt 26.01.2023		99,840	99,840	-
24	Blerje kancelari	21, dt 02.03.23		772,800	772,800	-
25	Detergjent	18/23, dt 21.02.23		253,200	253,200	-
26	Sig automjete	31831, dt 13.02.23		43,006	43,006	-
27	Blerje ushqime për fëmijë	3/23, dt 26.04.23		649,900	649,900	-
28	Sig automjete	113131, dt 25.05.23		43,006	43,006	-
29	Sig dety. punonjës	8483, dt 23.06.23		350,000	350,000	-
30	Mbikëqyrje Pun. ujësjellës	21/23, dt 20.07.23		100,000	100,000	-
31	Mbikëqyrje Pun. ujësjellës	21/23		1,300,000	1,300,000	-
32	Shërbim automjete	33, datë 31.08.23		359,880	359,880	-
33	Blerje uniforma zjarrëfikës	45, datë 06.09.23		1,063,200	1,063,200	-
34	Shërbim automjete	3/23, datë 01.09.23		645,000	645,000	-
35	Shpenzime aktiviteti	227, datë 29.08.23		552,000	552,000	-
36	Transporti materiale	85, datë 06.10.23		78,000	78,000	-
37	Bashk.Finan keshill	84, datë 30.09.23		23,420	23,420	-
38	Shërbim	5, datë 09.10.23		100,000	100,000	-
39	Blerje shkurre dhe lule	2097, datë 01.11.23		834,000	834,000	-
40	Riparim formatim kompjuter	99, datë 02.11.23		117,600	117,600	-
41	Bashk. Finan. Këshill.	12/23, datë 30.11.23		540,000	540,000	-
42	Festa e Nëntorit	102/23, datë 03.11.23		119,000	119,000	-
43	Rimbushje fikse zjarri	88/23		178,800	-	178,800
44	Mbikëqyrje Rug të brend.	102/23, datë 29.12.23		119,726	-	119,726
45	Blerje Kartolina	5/23, datë 26.12.23		98,500	98,500	
46	Mbikëqyrje Rug Tosk Mart.	25, datë 29.12.23		30,217	30,217	
47	Kolaudim Rugë Tosk Mart	27, datë 29.12.23		4,270	4,270	

48	Koktejl festa e fund vitit	106, datë 29.12.23		119,950	119,950	
49	Ndërtimi Ujësjetllësit	6/23, datë 09.02.2023		21,202,983	21,202,983	-
50	Ndërtimi Ujësjetllësit	10, datë 01.11.23		55,554,499	55,554,499	-
51	Ndërtimi Ujësjetllësit	74, datë 01.11.23		83,331,748	44,107,195	39,224,553
52	Blerje naftë	me kontratë		3,800,400	2,550,442	1,249,958
53	Rikons. rrugë të brendsh	454/23, datë 28.12.23		5,397,557	5,397,557	
54	Përmir. banesave të kom.	131, datë 07.12.23		5,132,729	5,132,729	
55	Përmir. banesave të kom.	145, datë 28.12.23		1,853,620	1,853,620	
56	Blerje automjete	50, datë 22.12.23		9,180,000	9,180,000	
57	Rikons. rrugë Tosk -Mart.	83, datë 29.12.23		1,589,760	1,589,760	-
58	Blerje kontener	151/23, datë 01.12.23		1,776,000	1,776,000	-
59	Situacion punë ujësjetllësi			663,273		663,273
60	Situacion punë ujësjetllësi			442,183		442,183
			<b>25,633,816</b>	<b>208,509,961</b>	<b>183,159,035</b>	<b>50,984,742</b>

### AKTIVI I BILANCIT KONTABEL 2023 (Aparati i Bashkisë Memaliaj)

në lekë

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	A K T I V E T	1.068.967.498	981.098.969
2		I.Aktivet Afat shkurtra	176.416.362	144,771,323
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	67.577.140	64,050,954
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	52.437.297	38.371.312
7	50	Letra me vlere	610.860	972.000
8	532	Vlera te tjera mjete ne ruajtje	14.528.983	7.159.788
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	6.648.638	29.637.190
12	31	Materiale		
13	32	Inventar I imet	6.648.638	29.637.190
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari te Arketushme	51.205.842	48.440.377
22	411	Kliente e llogari te ngjashme	39.991.494	38.220.128
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	8.481.276	6.355.499
24	431	Tatim e Taksa	459.023	405.459
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetesore	1.491.037	2.173.028
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		



31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitorë te ndryshem		
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	783.012	1.286.263
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvlresim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	50.984.742	25.633.819
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	50.984.742	25.633.819
42		II.Aktivët Afat gjata	892.551.136	830.884.483
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	3.945.960	3.911.473
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	3.945.960	3.911.473
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	888.605.176	826.973.010
48	210	Toka, T,roje, Terene	119,998	119,998
49	211	Pyje, Plantacione	277,000	277,000
50	212	Ndertesë e Konstruksione	319.562.526	336.970.869
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	542.276.780	443.266.649
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	5.340.098	6.531.436
53	215	Mjete Transporti	6.774.529	13.903247
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	14.254.245	25.903.811
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		4.Investime	0	0
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale		0

## PASIVI I BILANCIT KONTABEL 2023

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	117.330.427	82.205.984
66		I.Pasivet Afat shkurtra	117.330.427	82.205.984
67		1. Llogari te Pagushme	117.330.427	82.205.984
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	39.991.494	38.220.128
69	42	Detyrime ndaj personelit	8.481.276	6.355.499
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	459.023	405.459
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	1.491.037	2.173.028
76	436	Sigurime Shendetsore		

77	437,438,	Organizma te tjere shtetore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere	610.860	972.000
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	14.528.983	7.159788
82	467	Kreditore te ndryshem	50.984.742	25.633.819
83	4341	Operacione me shtetin( detyrime	783.012	1.286.263
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	951.637.071	898.892.985
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	951.637.071	898.892.985
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	899.199.774	860.521.673
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	52.437.297	38.371.312
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme		
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	1.068.967.498	981.098.969

*Gjendja e llogarise 468 "Debitore te ndryshem" me date 31.12.2023*

Nr.	Debitore	Gjendje 31.12.2022	Pagesa gjate 2023	shtesat	Gjendje ne 31.12.2023	Nr.		Gjendje 31.12.2022	Pagesa gjate 2023	Gjendje ne 31.12.2023
1	Taksa+Tarif vendor	15765329	1445263	5952735	20,272,801	41		8,540		8,540
	Nr i bizneseve 1470					42		28,506		28,506
1	Firma " M. "	1,228,180			1,228,180	43		51,639		51,639
2	Firma "V."shpk	140,000			140,000	44		800		800
3	K. J.	21,509			21,509	45		60,700		60,700
4	E. N.	19,240			19,240	46		4,000		4,000
5	A. K.	12,880			12,880	47		28,613		28,613
6	A.B.	11,920			11,920	48		38,827		38,827
7	A. H.	11,800			11,800	49		20,003		20,003
8	V. G.	1,500			1,500	50		28,213		28,213
9	P. S.	11,959			11,959	51		65,024		65,024
10	A. M.	3,474			3,474	52		753,896		753,896

11	V. G.	33,287			33,287	53		13,701		13,701
12	S. L.	3,474			3,474	54		1,122,824		1,122,824
13	A. S.	3,474			3,474	55		26,000		26,000
14	V. D.	3,474			3,474	56		67,750		67,750
15	A. B.	1,197			1,197	57		41,750		41,750
16	P. B.	11,160			11,160	58		4,160		4,160
17	A. Zh.	100,000			100,000	59		146,250		146,250
18	L.G.	26,574			26,574	60		182,750		182,750
19	Th. C.	24,494			24,494	61		138,500		138,500
20	A. H.	49,405			49,405	62		138,500		138,500
21	E. C.	10,370			10,370	63		45,000		45,000
22	H.M.	11,094			11,094	64		228,000		228,000
23	L. T.	15,148			15,148	65		180,000		180,000
24	N. Zh.	28,356			28,356	66		135,000		135,000
25	A. B.	1,875			1,875	67		28,000		28,000
26	N. B.	2,250			2,250	68		28,000		28,000
27	B. Z.	7,800			7,800	69		1,258,872		1,258,872
28	H. D.	67,672			67,672	70		1,258,872		1,258,872
29	Firma " A. "	71,831			71,831	71		1,258,872		1,258,872
30	F. Sh.	2,925			2,925	72		300,000		300,000
31	A.Zh.	1,800			1,800		Shuma 2 Audit			12,319,319
32	I.M.	3,000			3,000		Audit NJA			7,399,374
33	F. Sh.	538,050			538,050		Totali			19,718,693
34	M. Xh.	672,199			672,199		Taksat Vendore			20,272,801
35	E. I.	90,000			90,000		Gjithsej			39,991,494
36	P.H.	17,000			17,000					
37	Z. Xh.	6,813			6,813					
38	E. A.	946			946					
39	M.R.	5,000			5,000					
40	Firma "K." shpk	1,354,627			1,354,627		<b>Totali</b>			<b>32,592,120</b>

*Debitorë të Njësive Administrative*

Nr.	Debitore	Gjendje 31.12.2022	Pagesa 2023	Gjendje 31.12.2023	Pagesa 2023	Shtesa gjatë 2023	Gjendja në 31.12.2023
1	Nga kontrolli	1.509.724	0	1.509724	89103		1.420.621
2	Nga kontrolli	354.059	0	354.059	12770		341289
3	Nga Kontrolli	1.317.020	0	1.317.020	116365		1.200.655
4	Nga Kontrolli	1.355.008	0	1.355.008	182975		1.172.033
5	Nga Kontrolli	3.707.533	0	3.707.533	442757		3.264.776
	Shuma 2	8.243.344	0	8.243.344	843970		7.399.374
	Shuma 1						32,592,120
	<b>Totali</b>	<b>38.220.128</b>		<b>39.389.128</b>			<b>39.991.494</b>

**Të dhëna mbi asetet e kaluara Bashkisë me VKM**

	VKM		Pronat sipas listës	Institucioni/Enti përdorues	Nga këto regjistruar
	Numër	Datë			
Bashkia Memaliaj	974	30.09.2009	1-7 Prona per programet arsimore	DREJTORIA ARSIMORE	Spitali Memaliaj

	VKM		Pronat sipas listës	Institucioni/Enti përdorues	Nga këto regjistruar
	Numër	Datë			
			<p>8-9 Prona per shendetin publik</p> <p>10-16 Spitali Minieres, Prona social-kulturore e sportive &amp; varrezat publike</p> <p>16 -169 dhe 199 -241 Prona te inventarizua</p> <p>243 – 263 Prona te inventarizuara</p>	<p>MINISTRIA E SHENDETESISE</p> <p>Bashkia MEMALIAJ</p> <p>Bashkia MEMALIAJ</p> <p>K.E.SH</p>	
Ish Komuna Qearat	417	09.06.2005	<p>1- 14 Prona per programe arsimore</p> <p>15 Prona per shendetin publik</p> <p>16-71 Prona social-kulturore e sportive &amp; varrezat publike &amp; Prona te inventarizuara</p> <p>157 – 171 Prona te inventarizuara (klasa ne teresi)</p> <p>172 – 353 Prona te inventarizuara (klasa ne teresi)</p>	<p>DREJTORIA ARSIMORE</p> <p>Njesi Administrative Qesarat</p> <p>D.R.U Gjirokaster</p>	
Ish Komuna Krahes	657	21.05.2008	<p>1 – 4 737 - 745 Prona per shendetin publik</p> <p>8 – 118 Prona varrezat publike &amp; Prona te inventarizuara</p> <p>404- 696 Infrastrukture</p> <p>697 – 726 Prone te inventarizuara 9 klasa ne teresi)</p> <p>727- 736 Prona te inventarizuara si prona ne teresi)</p> <p>737 – 745 Prona per programet arsimore</p>	<p>Njesi Administrative Krahes</p> <p>Komiteti Kombetar i ujit</p> <p>Njesi Administrative Krahes</p>	

	VKM		Pronat sipas listës	Institucioni/Enti përdorues	Nga këto regjistruar
	Numër	Datë			
Ish Komuna BUZ	663	28.09.2011	<p>94 -202 dhe 659 - 663 Prona te programit Arimor</p> <p>203 – 207dhe 664 -- 666 Qendra shendeteore</p> <p>208 -585 Prona te inventarizuara</p> <p>586 – 653 Prona te inventarizuara</p> <p>654 – 658 Prona te inventarizuara</p> <p>666/1 – 667 Prona te inventarizuara</p>	<p>Drejtoria Arsimore</p> <p>Ministria e Shendetesise</p> <p>Njesia adm Buz</p> <p>D.R.U Gjrokaster</p> <p>K.E.SH</p> <p>Rep Ushtarak Nr 5500 Gjrokaster</p>	
Ish Komuna Luftinje	790	16.11.2006	<p>1 -12 Prona te programit arsimor</p> <p>13 Pallat kulture (Izvor)</p> <p>14 – 22 Qendra Shendetesore</p> <p>23 -316 Prona te inventarizuara</p> <p>480 – 809 Prona te inventarizuara</p> <p>809 – 865 Prona te inventarizuara (klasa te vecanta)</p>	<p>Drejtoria Arsimore</p> <p>Njesi Administrative Luftinje</p> <p>Ministria e Shendetesise</p> <p>Njesi Administrative Luftinje</p> <p>Njesi Administrative Luftinje</p> <p>Komoteti Kombetar i ujrave</p>	
Ish Komuna Fshat Memaliaj	1239	10.09.2008	<p>1 – 9 Prona te programit Arsimor</p> <p>10- 13 Qendra Shendetesore</p> <p>14 -15 Qendra sportive</p> <p>16 – 24 Varreza publike</p> <p>25 – 92/ 158 – 360 Prona te inventarizuara</p> <p>361 – 400 Prona te inventarizuara (klasa ne teresi)</p>	<p>Drejtoria Arsimore</p> <p>Njesi Administrative Fshat Memaliaj</p>	

### Vlerësimi i riskut për 2023

Nr	Subjekte për tu audituar	Fusha për tu audituar	Vlerësimi i riskut		
			I lartë	I mesëm	I ulët
1	Bashkia Memaliaj	- Mbi vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e rregullshmërisë së aktivitetit të kësaj Bashkie, me kuadrin ligjor në fuqi, në drejtim të, aktivitetit ekonomik e financiar të Bashkisë, etj.	X		
		Vlerësimi i sistemit mbi detyrimet e prapambetura		X	
		Vlerësimi mbi zbatimin e rekomandimeve		X	
2	Ndërmarja e Shërbimeve Publike	Vlerësimi i sistemit mbi detyrimet e prapambetura		X	
		Vlerësimi mbi zbatimin e rekomandimeve		X	
3	Klubi Sportiv	Vlerësimi i sistemit mbi detyrimet e prapambetura	X		
		Vlerësimi mbi zbatimin e rekomandimeve		X	
4	Spektori MZSH-së	-Vlerësimi i sistemit mbi funksionimin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në Bashkinë Memaliaj, pasqyrimi i veprimtarisë së këtij shërbimi të MZSH-së.		X	

### Veprimtaria e Auditit të Brendshëm

Nr	Subjekte të Audituar sipas viteve		
	Planifikuar 2023	Realizuar 2023	Niveli i Riskut
1.	Bashkia Memaliaj	Bashkia Memaliaj	I lartë
2.	Ndërmarja e Shërbimeve Publike	Ndërmarja e Shërbimeve Publike	I mesëm
3.	Klubi Sportiv Memaliaj	Klubi Sportiv Memaliaj	I mesëm
4	Spektori MZSH-së	Spektori i MZSH-së	I mesëm

Nr	Periudha	Të dhëna sipas raportimit				Sipas Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
111	222023	23	7	6	10				
<b>TOTALI</b>		<b>23</b>	<b>7</b>	<b>6</b>	<b>10</b>				